

SISTEMI TATIMOR NË KOSOVË – REFORMIMI DHE PERSPEKTIVA

Remzi Smajli

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
ekonomike, me profil financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr, Flutura Kalemi

Numri i fjalëve: 58, 051

Vendi, muaj i viti i dorëzimit
Tiranë Tetor 2015

Deklarata e Autorësisë

Deklaroj se punimi im doktoral, i dorëzuar për vlerësim tek udhëheqësi shkencor dhe këshillin e profesorëve të UET, e kam shkruar në mënyrë të pavarur dhe se ai është tërësisht punimi im autorial. Gjithashtu deklaroj se punimi në fjalë nuk është i publikuar e as i përdorur për qëllime të kryerjes së obligimeve mësimore në këtë apo ndonjë institucion tjetër të shkollimit dhe se në bazë të tij nuk kam fituar ndonjë kredi tjetër akademike.

Më tutje deklaroj se në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike sipas udhëzimeve të parapara nga shkolla doktorale e Universitetit Evropian të Tiranës.

Tirane Tetor 2015

Mr.Sc Remzi Smajli

Abstrakti

Të hyrat publike dhe qeveritë e shtetit, me theks të veçantë buxhetet në shtete të ndryshme, vazhdimisht përballen me vështirësinë e mbledhjes së tatimeve. Ne përpjekjet për realizimin e planeve të tyre, në shumicën e rasteve aplikohen masa fiskale dhe reforma mjaft të ashpra për përmbushjen tatimore ndaj tatimpaguesve. Kjo problematikë është aktuale në vendin tone, Republikën e Kosovës dhe rajon.

Për më tepër, përveç autoritetit qendror, rajonal, komunal dhe qeverisë lokale, shumë institucione kanë ligjet e veta dhe rregulloret për të ndjekur objektivat e tyre, të cilat kanë për qëllim përmbushjet e tyre buxhetore.

Në kontest të vështirësive për pagesën e tatimeve, vullnetit për të paguar tatimet, në njërën anë dhe përmbushja e buxhetit të shteteve sipas nevojave të tyre, që gjithnjë janë në drejtime të ndryshme, ky studim tenton të jap përgjigje në pyetjet kërkimore dhe qëllimet e këtij punimi; Sa janë te përballueshme tatimet aktuale, niveli i realizimeve buxhetore, nevoja për reforma substanciale të sistemit tatimor dhe politikës fiskale? Sa ndikon stimulimi dhe pjesëmarrja e tatimpaguesve në rritjen e të ardhurave nga tatimet?

Në punimin e doktoratës kemi bërë përpjekje që të hulumtojmë, të trajtojmë në mënyrë shkencore mbi problematikën e sistemit dhe politikave tatimore, mbi zhvillimin dhe funksionimin e tyre në shtetet e ndryshme me theks të veçantë në Republikën e Kosovës duke i krahasuar me vendet e rajonit dhe rrethit global. Në kampionin e studimit janë përfshi 503 qytetare, 400 biznese dhe 126 zyrtarë të tatimeve, përmes pyetësorëve, në proporcione sipas gjinisë, moshës dhe nivelin e të ardhurave. Sipas hulumtimeve në literature, trendëve të përmbushjes dhe analizës nga të dhënat e mbledhura kemi nxjerrë disa nga rezultatet konkrete së ne çfarë drejtimi duhet të shkojë reforma tatimore. Ka rezultuar se reforma tatimore duhet të ndryshojë në drejtimin “poshtë-lartë” që nënkupton se përpos qeverisë, tatimpaguesit duhet të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejt në reformën tatimore dhe se stimulimi i tyre indirekt rritë të ardhurat nga tatimet. Sipas rezultateve të fituara, jemi njohur me problemet themelore dhe rrugën e drejtë për reforma fiskale të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e të hyrave publike, lehtësimin e përmbushjeve tatimore dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve. Ky studim ndihmon sa do pak gjeneratat e ardhshme për hulumtime më substanciale drejtë reformave fiskale në të ardhmen.

Abstract

Public revenues and state governments, budgets , with special emphasis in different countries, are constantly faced with the difficulty of collecting taxes. We efforts for the realization of their plans, in most cases fiscal measures and reforms applied quite tough for tax compliance for taxpayers. This current problem in my country is the Republic of Kosovo and the region.

Moreover, in addition to the central authority, regional, municipal and local government, many institutions have their own laws and regulations to pursue their objectives, which are intended to meet their budget.

In the context of difficulties for payment of taxes, the willingness to pay taxes on the one hand and the fulfillment of the budget of the states according to their needs, which are always in different directions, this study aims to answer to the research questions and goals this paper. How affordable are current taxes, the level of budgetary achievements, what we currently have fiscal policy, the need for substantial reform of the tax system and fiscal policy? How does the taxpayer stimulation and participation in the growth of revenues from taxes?

In a doctoral thesis we have tried to investigate, to deal in a scientific manner on the issue of system and tax policies on the development and functioning in various countries with emphasis on the Republic of Kosovo by comparison with countries in the region and Global district. We have included sample study of 503 citizens, 400 businesses and 126 tax offices, through questionnaires, proportions by gender, age and level of income. According to research in the literature, the performance trends and analysis of the data collected have produced some of the concrete results in what direction it should go to tax reform. It resulted that tax reform must change the direction of "bottom-up" which means that apart from the government, taxpayers should be direct participants in the tax reform and the stimulation of their indirect tax revenue increases. According to the results obtained, we are familiar with the basic problems and guidance on fiscal reform which directly affect the growth of public revenues, facilitating tax fulfillment and increasing the welfare of citizens. This study helps as little future generations will research the right substantive fiscal reforms in the future.

Dedikimi

“Këtë punim ju dedikoj, familjes, studentëve, dhe politikës fiskale të shtetit tonë”

FALENDERIME

Dëshiroj të falënderoj familjen time për përkrahjen, inkurajimin dhe durimin që kanë shprehur gjatë studimeve të mia doktorale.

Falënderim dhe respekt i shpreh të gjithë kolegëve dhe profesorëve, të cilët ishin shtytës që studimet tona të realizoheshin me sukses. Gjithashtu një falënderim dhe respekt i veçantë i takon edhe udhëheqëses time shkencore zonjës Flutura Kalemi, e cila gjatë tërë kohës tregoi gatishmëri të më ndihmoj dhe këshilloj rreth temës me udhëzime profesionale dhe shkencore, në mënyrë që kjo temë e diplomës doktorale të realizohet sa më mirë. Falënderimi ju takon edhe pjesës tjetër akademike që kanë qenë pjesë e këtij programi si dhe të gjithë atyre që më ndihmuan në mbledhjen dhe përpunimin e materialeve bazë për këtë punim.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Përmbajtja.....	1
Kapitulli I – Hyrje	10
II. Shtrimi i Problemit.....	14
III. Qëllimi dhe Rëndësia e Studimit.....	16
IV. Pyetje dhe Hipoteza.....	18
V. Metodologjia e Hulumtimit.....	20
VI. Kufizimet.....	22
VII. Burimet e referimit.....	23
Kapitulli II – Funkcionet Tatimore në Literaturën Bashkëkohore.....	26
2.1. Shkenca Bashkëkohore mbi Financat dhe Tatimet.....	32
2.2. Financat Publike në Funkcion të Tatimeve.....	36
2.3. Të Ardhurat Publike.....	38
2.4. Llojet e të Ardhurave Publike.....	41
2.5. Të Ardhurat nga Doganat e Kosovës.....	41
Taksat Doganore	42
Akciza.....	42
2.6. Tatimet dhe Taksat	43
2.7. Tranzicioni dhe Reformimi.....	45
2.8. Karakteristikat e Sistemit Tatimor Bashkëkohorë.....	50
2.9. Llojet e Tatimeve.....	52
2.10. Politika Fiskale në Evropë.....	56
2.11. Përmbledhja për kapitullin.....	57
Kapitulli III - Politikat Tatimore në Rajon - Krahasim me Kosovën.....	58
3.1. Dinamika e Politikës Fiskale në Shqipëri.....	63

Reformat në Sistemin Tatimorë.....	64
3.2. Politika Fiskale në Shqipëri.....	67
Legjislacioni tatimorë.....	67
3.3. Sistemit Tatimor në Kroaci.....	74
Llojet Kryesore te tatimeve	75
3.4. Sistemi Tatimor në Bullgari.....	89
Llojet e tatimeve.....	90
3.5. Politikat Tatimore Sipas Këndvështrimit Evropian.....	96
Strategjia e Politikës Tatimore ne BE.....	96
Sistemi Tatimor Evropian –Strukturimi.....	98
3.6. Organizata Ndër-Evropiane e Administratave Tatimore (IOTA).....	100
3.7. Përmbledhja për kapitullin.....	103
Kapitulli IV - Sistemi Tatimor në Kosovë.....	104
4.1. Karakteristikat Tatimore në Kosovë.....	104
4.2. Tatimet në Kosovë.....	105
4.3. Legjislacioni i Sistemit Tatimor.....	108
4.4. Sistemi Tatimor Kosovar përballë Sistemit Evropian.....	110
4.5. Synimet e Sistemit Tatimor në Kosovë.....	110
4.6. Kuptimi dhe Rëndësia Ekonomike e Tatimit.....	113
4.7. Llojet e Tatimit.....	115
Tatimi i Paragjykuar.....	115
Tatimi në të Ardhurat Personale	116
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave.....	120
Tatimi në Vlerën e Shtuar.....	125
4.8. Të Ardhurat Lokale - Komunale.....	135
4.9. Tatimi në Pronë.....	138

4.10. Taksat si Instrumente Fiskale.....	141
4.11. Zhvillimet Fiskale në Kosovë.....	143
4.12. Regjimi Tatimor në Kosovë deri në Dhjetor 2014.....	146
Ekonomija joformale.....	148
Tatimet e dyfishta dhe marrëveshjet e Kosovës për eliminimin e tyre.....	151
4.13. Përmbledhja për kapitullin.....	153
Kapitulli V – Trendet e të Hyrave Tatimore në Kosovë.....	154
5.1. Pjesëmarrja e Tatimeve në PBB dhe Buxhetin e Kosovës.....	154
5.2. Operativa dhe Kontrolllet.....	170
5.3. Aktivitetet Përbushëse të Administratës Tatimore.....	172
5.4. Aktivitetet Edukative dhe Administrative.....	175
5.5. Fiskalizimi.....	176
5.6. Borgji Tatimor.....	178
5.7. Rimbursimi dhe Kreditimi i TVSH-së.....	178
5.8. Ankesat.....	179
5.9. Përmbledhja për kapitullin.....	180
Kapitulli VI - Analiza dhe Përshkrimi i Rezultateve.....	182
6.1. Analizime - Pjesa e Përgjithshme.....	189
6.2. Përmbledhja për kapitullin.....	216
Kapitulli VII - Përfundimi dhe Rekomandime.....	217
7.1. Përfundimi.....	217
7.2. Rekomandimet Administrative, Legjislative dhe Strategjike.....	225
7.3. Referencat.....	229
Aneksë.....	238

Tabelat

Tabela nr.1. Pjesëmarrja e taksës në PBB 1970-2009.....	44
Tabela nr.2. Ndryshimet në normat e tatimeve periudha 1992-2009.....	61
Tabela nr.3. Tatimi i mbajtur në burim në R. Shqipërisë.....	70
Tabela nr.4. Të hyrat buxhetore në Republikën e Bullgarisë për vitet 2011 -2013.....	95
Tabela nr.5. Shkallët tatimore për TAP.....	118
Tabela nr.6. Formimi i vlerës së tregut të palujtshmerisë për për tatimin në pronë.....	140
Tabela nr.7. Dinamika e formimit të të ardhurave nga dogana 2005 -2014 (000 euro).....	144
Tabela nr.8. Ecuria e tatimeve dhe e llojeve të tatimit vendor për periudhën 2005-2014.....	145
Tabela nr.9. Kodi i Akcizës – DK.....	147
Tabela nr.10. Akciza në duhan, pije dhe vetura – DK.....	148
Tabela nr.11. Lista e marrëveshjeve për eliminim të tatimeve të dyfishta - Kosovë 2015.....	152
Tabela nr.12. Trendi i PBB në periudhën 2005-2014.....	155
Tabela nr.13. Qarkullimi vjetor sipas madhësisë së Ndërmarrjes dhe Pjesës së PBB...158	
Tabela nr.14. Trendi i të hyrave tatimore sipas llojeve të tatimit për periudhën 2005-2014.....	163
Tabela nr.15. Niveli i të hyrave për tri llojet kryesore të tatimeve 2005 – 2014.....	164
Tabela nr.16. Të hyrat e realizuara për tri vitet e fundit dhe pjesëmarrja e secilit regjion në krijimin e të hyrave tatimore.....	166
Tabela nr.17. Kostoja e mbledhjes së tatimeve.....	167
Tabela nr.18. Ecuria e kontrolleve dhe krahasimi në mes viteve 2012/2013.....	171
Tabela nr.19. Rezultatet nga kontrolli i zyrtarëve tatimor në teren.....	172

Tabela nr.20. Numri i vizitave, gjobave dhe efekteve në tatim shtesë.....	173
Tabela nr.21. Gjobat në vitin 2013 dhe 2012 në specifikime të veçanta.....	174
Tabela nr.22. Punë tjera administrative me tatimpaguesit.....	176
Tabela nr.23. Fiskalizimi në Kosovë deri në vitin 2013.....	177
Tabela nr.24. Borxhet dhe niveli i inkasimeve sipas regjioneve.....	178
Tabela nr.25. Numri i kërkesave dhe aprovimeve për Rimbursim të tatimeve.....	179
Tabela nr.26. Numri i ankesave dhe përgjigjeve prej departamentit të ankesave.....	180
Tabela nr.27. Rezultatet e ANOVA-se per Moshën, Punësimin dhe regjioneve.....	189
Tabela nr.28. Vlerësimi për funksionimin e administratës tatimore.....	191
Tabela nr.29. Klima e përgjithshme dhe parakushtet për reformën e administratëstatimore.....	192
Tabela nr.30. Disponimi i tatimpaguesve për pagesën e tatimit.....	195
Tabela nr.31. Për tatimet në përgjithësi, mendoni se janë.....	195
Tabela nr.32. Sa ka ndikuar politika fiskale në drejtim të rritjes ekonomike në përgjithësi.....	196
Tabela nr.33. Sa ka ndikuar politika fiskale në drejtim të rritjes së ambientit konkurrues për biznese.....	196
Tabela nr.34. Si e vlerësoni kontributin e tatimpaguesve.....	197
Tabela nr.35. Rritja e mundshme e taksave.....	197
Tabela nr.36. Sa mendoni se është korrekt dhe i përballueshëm sistemi tatimor në vend?.....	198
Tabela nr.37. Nevoja për ndryshimet në sistemin tatimor.....	199
Tabela nr.38. Cili nga pohimet është më i afërt me mendimin tuaj, kur është fjala për reformimin e sitemit tatimor?.....	200
Tabela nr.39. Matrica e Korelacionit.....	202
Tabela nr.40. Communalities.....	204

Tabela nr.41. Extraction Method: Alpha Factoring.....	204
Tabela nr.42. T-Testi / Paired Samples Test.....	206
Tabela nr.43. Analiza e regresionit të shumëfishtë në kërkesën: Sa mendoni se është korrekt dhe i përballueshëm sistemi tatimor në vend?.....	207
Tabela nr.44. ANOVA.....	207
Tabela nr.45. Koeficientët.....	207
Tabela nr.46. Independent sample T- Test i elementeve të promovimit / variablave të varura dhe rëndësisë së tyre.....	208
Tabela nr.47. Si duhet stimuluar bizneset për pagesën e tatimeve?.....	211
Tabela nr.48. Sa ka ndikuar politika fiskale në drejtim të rritjes së mirëqenies qytetare.....	211
Tabela nr.49. Sa ka ndikuar politika fiskale në drejtim të rritjes së mirëqenies qytetare.....	211
Tabela nr.50. Sa ka ndikuar politika fiskale në drejtim të rritjes së mirëqenies qytetare.....	211
Tabela nr.51. Sa ka ndikuar politika fiskale në drejtim të rritjes së mirëqenies qytetare.....	212
Tabela nr.52. Regresioni i shumëfishtë i komponentëve studimor.....	213
Tabela nr.53. Variabla e varur: Të hyrat tatimore.....	213
Tabela nr.54. ANOVA.....	214

Grafikonet

Grafiku nr.1. Të ardhurat nga tatimet dhe Doganat në Shqipëri 2000-2011.....	64
Grafiku nr.2. Ecuria e rritjes reale të ekonomisë në periudha 2004-2013.....	154
Grafiku nr.3. Lëvizja e PBB nëpër vite.....	155
Grafiku nr.4. PBB për kokë banori 2008 – 2014.....	156
Grafiku nr.5. Ecuria e tatimeve vendore në vitet 2015-2014 në euro.....	159
Grafiku nr.6. Të hyrat nga tatimet në krahasim me tatimin shtesë nga kontrolli.....	161
Grafiku nr.7. Pjesëmarrja e tri tatimeve kryesore në të hyrat tatimore vitet 2005-2014.....	164
Grafiku nr.8. Struktura e të hyrave nga tatimet dhe pensionet në vitin 2014.....	165
Grafiku nr.9. Raporti i Ankesave ndaj kontrollit.....	167
Grafiku nr.10. Shpenzimet publike në buxhetin e RK.....	168
Grafiku nr.11. Niveli i pengesave të bërit biznes 2010-2013.....	169
Grafiku nr.12. Vlera e borxheve sipas regjioneve 2014.....	178
Grafiku nr.13. Dimensionimi i bizneseve.....	188
Grafiku nr.14. ANOVA, testi ndërmjet gjinisë dhe punësimit.....	191
Grafiku nr.15. Niveli i pavarësisë së ATK-së.....	193
Grafiku nr.16. Pagat dhe Benifitet në ATK.....	194
Grafiku nr.17. Normalja përcaktuese P-P Plot, mbi mendimin e zyrtarëve tatimorë për informimin e zyrtarëve dhe tatimpaguesve, që janë të informuar me sistemin shtetëror të tatimeve.....	205
Grafiku nr.18. Ndikimi i pagesës së tatimeve në rritjen ekonomike familjare - Means Plots.....	212
Grafiku nr.19. Homoskedaciteti mbi format; Si duhet stimuluar bizneset për pagesën e tatimeve?.....	213

Lista e Shkurtimeve

AKP - Agjencioni Kosovar i Privatizimit
AQF - Autoriteti Qendror Fiskal
ARBK - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
BE - Bashkimi Evropian
BPV - Bruto Produkti Vendor (PBB)
BB – Banka botërore
BQK - Banka Qendrore e Kosovës
BRK - Buxheti i Republikës së Kosovës
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
CN - Kodi i nomenklaturës
DM - Marka Gjermane
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DVD - Video kasete digjitale
EDI - Deklarimi elektronik i tatimeve
EFSS - Stabiliteti Financiar Evropian
ESM - Mekanizmat e Stabilitetit Evropian
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar
G20 - Grupi i njëzetë shteteve më të zhvilluara
HRK - Monedha Kroate Kuna
IFN - Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IHD - Investimet e Huaja Direkte
KE - Komisioni Evropian
ILO - Organizata ndërkombëtare e punës
IOTA – Organizata Ndërkombëtare për bashkëpunim të Administratave Tatimor
KFOR - Kosovo Force
KMSH - Koston e mallrave të shitura
LMFPP - Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LL.B - Llogaritë Bankare

MF - Ministria e Financave
MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriu
NIPT - Numri i Identifikimit për Personin e Tatueshëm
NP - Ndërmarrjet Publike
NVM - Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
NJTM - Njësia e tatimpaguesve të mëdhenj
OECD - Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
PBB - Profukti i brendshëm bruto
R.SH - Republika e Shqiperisë
RB - Republika e Bullgarisë
SBA - Stand By Agreement
SNKSP – IPSAS - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
SPF-GFS - Statistikat e Përgjithshme Financiare
TAP - Tatimi I të Ardhurave Personale
SPSS - Paketa Statistikore për Shkenca Sociale
SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TAK - Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
TK - Tatimi në Korporata
TKP - Trusti i kursimeve pensionale
TMB - Tatimi i mbajtur në burim
TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA - Udhëzim Administrativ
UNDP - Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNMIK - Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VKME - Menaxhimi i aktiviteteve përmes modulit

Kapitulli I - HYRJE

Studimi im teorik është bazuar në metoda të karakterit të përgjithshëm dhe të veçantë në dy aspekte:

1. Aspekti i parë është që të përcaktohen karakteristikat e të ardhurave publike dhe sistemit tatimor, zhvillimit historik të tyre, mënyra e funksionimit dhe në veçanti roli i tatimeve në strukturën e përgjithshme të shtetit.

1. Aspekti i dytë është trajtimi i sistemit tatimor bashkëkohor, mendimet dhe reformat në vendet e rajonit dhe sistemi tatimor Evropian.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, vendet në tranzicion dhe ekonomitë e tyre, nga sistemi i planifikuar i ekonomisë, vazhduan reformat fiskale për t'u shndërruar në ekonomi të tregut. Me këtë rast na paraqitet një dukuri dhe rast i mirë studimi për krijimin e politikave të reja në sistemin tatimor dhe në përgjithësi politikën fiskale.

Kjo dukuri shfaqet veçanërisht në vendet e Evropës juglindore si Hungari, Çeki, Poloni, Bulgari e Slloveni. Në fillim të këtij transformimi, këto vende patën sfidë krijimin e institucioneve të reja fiskale dhe një treg me orientim të ri tatimor. Bernardi, Chandler and Gandullia (2005).

Në shkrimet aktuale të autorit prestigjioz për politikën tatimore Vito Tanzi gjejmë shumë qasje pragmatike të trajtimit të politikës fiskale. “të dhënat e fundit në dispozicion për vendet e OECD-së tregojnë se në dekadën e parë të këtij shekulli, raporti i taksave ndaj BPV është zvogëluar, duke vazhduar me konstatimin se është shumë më e vështirë të rriten taksat se-sa të reduktohen shpenzimet publike. Vancouver Seminar,(2009).

Në vështirësitë për ndërtimin e politikave fiskale, shumë vende kanë kërkuar forma të ndryshme të bashkëpunimit për të bashkërenditur politikat nën kushtet e globalizimit botëror. Vendet më të zhvilluara të G20 vazhdimisht janë takuar për t'u dakorduar dhe për të gjetur zgjidhje adekuate për mbulimin e deficitit fiskal. Në disa raste, vende të veçanta

kanë kërkuar që të koordinojnë politikat e tyre fiskale, për të ndihmuar në tërheqjen e ekonomive të botës nga recesioni. Tanzi, (2011).

Kosova e filloi më vonë këtë proces të reformës, si rezultat i statusit që e kishte deri pas luftës kur filloi procesin e tranzicionit, të shoqëruar me përkrahjen e shteteve mbështetëse të statusit të saj të ri. Një nga ndryshimet më të rëndësishme ishte reforma fiskale e pershkruar nga autoret, Pere & Hashorva (2010).

Në të gjitha shtetet e tranzicionit tani anëtare të BE-së, procesi i reformës tatimore është ndikuar ndjeshëm nga historitë e tyre. Në vend të kopjimit të modelit perëndimor të sistemeve tatimore, ata ndoqën një qasje revolucionare që i ka shoqëruar në hartimin e sistemeve tatimore, Bernardi, Chandler & Gandullia (2005:2). Kosova, duke qenë se pas luftës kaloi një periudhë të administrimit nga misioni i Kombeve të Bashkuara i njohur si UNMIK, nuk shpëtoi nga ndikimi i drejtpërdrejtë i preferencave dhe praktikave të vendeve prej nga vinin përfaqësuesit e këtij misioni, duke injoruar faktin që Kosova kishte tashmë një traditë tatimore. Mos marrja në konsideratë e përvojës tatimore shumëvjeçare, bazës sociale në hartimin e politikave tatimore, formave tatimore të aplikuara me herët në sistemin fiskal, mos konsultimi i mjaftueshëm me ekspertët vendorë, prodhoi efekte që do marrin kohë për t'u përmirësuar.

Disa shtete të Evropës juglindore aplikuan nivel të ulët të normave tatimore dhe mbi baza të ngushta tatimore krahasuar me standardet ndërkombëtare. Rasti më tipik është dhënë nga Estonia, ku tatimi i korporatave mbi fitimet e pashpërndara është hequr plotësisht. Kosova pas luftës, duke pasur komoditetin e përkrahjes nga donatorët e huaj dhe përqindjen e të hyrave nga doganat, duke përmbushur nevojat shtetërore i është shmangur aplikimit të taksave të reja në sistem po ashtu dhe nivelit më të lartë të normave tatimore.

Sistemet tatimore në fuqi gjatë ekonomisë së komanduar socialiste nuk ishin të krahasueshme me sistemet e stilit perëndimor; roli i tyre ishte rrënjësisht i ndryshëm dhe më i kufizuar Tanzi & Tsibouris (2000).

Të ardhurat tatimore kanë rrjedhur kryesisht nga tre burime kryesore (tatimet e kompanive, bizneseve, tatimi në qarkullim dhe tatimi në paga, ndërsa tatimet mbi të ardhurat personale llogariten për një pjesë shumë të vogël të të ardhurave totale Dabrowski & Tomczynska (2001)

Normat e taksave kanë qenë të shumta dhe jo-parametrike, strukturat tatimore ishin komplekse dhe normat e detyrimeve tatimore diskrete dhe të negociueshme. Fitimet e ndërmarrjeve shtetërore ishin burimi kryesor i financimit të shpenzimeve qeveritare. Në ekonomitë e centralizuara, taksat nuk janë mbledhur në bazë të ligjeve tatimore të kodifikuara, rregullat për përcaktimin e bazave tatimore dhe normat e aplikueshme tatimore. Ata ishin mbledhur kryesisht mbi bazën e negociatave mes qeverisë dhe subjekteve të tatuara , Bernardi, Chandler & Gandullia (2005:3).

Sistemet e vjetra tatimore, thjeshtë nuk mund të reformoheshin, por u bënë të nevojshme krejtësisht sisteme të reja tatimore. Ndikimi i tranzicionit në sistemin e financave publike ishte radikal duke sjellë qasje tjera në përcaktimin e formave tatimore, bazave tatimore, një unifikim të legjislacionit tatimor, gjë që nuk ishin karakterizuese në ekonomitë e planifikuara. Argumentet politike janë në qendër të debatit mbi procesin e tranzicionit nga sistemi ekonomike socialist drejt ekonomive të tregut që ndodhën në shumicën e vendeve në tranzicion. Ato janë përdorur për të shpjeguar ose justifikuar shumë aspekte të tranzicionit, që karakterizojnë performancaë të ndryshme në të gjitha vendet në tranzicion, dhe për të diskutuar strategjitë e reformave ekonomike. Bernardi, W.S.Chandler & Gandullia, 2005:4)

Nga gjithë këto që u thanë më lartë mund të rezultojë në atë se tranzicioni nënkupton një lëvizje nga një sistem ku qeveria vendos para se qytetarët kanë pasur qasje në burimet e ekonomisë, në një vend me një rol të reduktuar të sektorit publik, ku qeveria duhet të mbledhë të ardhurat para se t'i realizoj shpenzimet.

Kjo do të thotë se vendet që kanë kaluar apo janë në përfundim të tranzicionit u

paraqitet nevoja për të ndërtuar një sistem fiskal të bazuar në instrumente të reja dhe më efikase të tatimit.

II. Shtrimi i Problemit

Nuk ekzistojnë rregulla reale e assesi përfekte për nivelin optimal të një përmbushje tatimore me interesa reciproke ndërmjet dy palëve të interesit, qeverive dhe tatimpaguesve. Nuk ka rregulla unike të trajtimit të hyrave publike, tatimit-taksave dhe doganës duke mos mohuar përpjekjet e fundit të bashkimit Evropian për standardizimin e metodave të Tatimit të Vlerës së Shtuar përmes konventës së gjashtë Evropiane.

Nga ana tjetër, sistemi i ri, veçanërisht nën presionin e globalizimit, kërkon rregullat e lojës që për qëllim kanë krijimin e një fushë të barabartë për të gjitha qeveritë e që duhet të sigurojë pjesëmarrës të mjaftueshëm me kritere të barabarta.

Përderisa hapësira për sipërmarrësit që të angazhohen në aktivitete të ligjshme ekonomike është gjithnjë më e madhe, niveli i evazionit fiskal vazhdon të ketë pjesëmarrje të dukshme sidomos për vendet në tranzicion. Ky sistem duhet gjithashtu të sigurojë që; të drejtat e askujt nuk janë shkelur nga shteti e as nga sipërmarrësit. Në disa fusha të tilla si përmbushja tatimore, sipas vendeve me sisteme të ndryshme financiare është në nivele të ndryshme dhe me vetëdije në diferencë.

Shumë vende ende nuk kanë rregulla të mjaftueshme për të mbrojtur mjedisin e tyre fiskal ose interesat e tyre financiare ndaj aktiviteteve të paligjshme. Në fusha të tilla si tatimet, në anën tjetër, trashëgimia e sistemit çojnë në vendosjen e niveleve shumë të larta të tatimeve dhe kontributeve dhe mundësinë e komplikimit dhe rregullave të cilat vazhdimisht janë në ndryshim.

Burimet e përdorura për sigurimin e të hyrave publike shpesh ishin keqpërdorur për shkak të mungesës së një sistemi monitorimi të përshtatshëm dhe të rregullave të përshtatshme.

Politika fiskale në Kosovë është sektori i cili ka pasur stabilitet optimal pas luftës, ai vazhdimisht është rritur, ku buxheti fiskal në vitet e para të pasluftës është rritur me

1. Përmbushje – Nënkupton realizimi i parashikimeve për planet apo obligimet tatimore.

vlera pothuajse gjeometrike mirëpo pesë vitet e fundit ai ka një rritje më të vogël edhe pse nevojat buxhetore janë në rritje. Të njëjtat probleme i kanë edhe shtetet për rreth Kosovës dhe se problematika e një përmbushje tatimore në nivele optimale me nevojat e shpenzimeve publike dhe trajtimin e barabartë të tatimpaguesve është imediate.

Reformat fiskale pasojnë në çdo shtet, posaçërisht pas ndërrimit të pushteteve dhe qeverive, mirëpo një reformë përmbajtjesore me bazë shkencore është object i këtij hulumtimi, si shumë e nevojshme në shtetin tim dhe rajonin e Evropës juglindore.

III. Qëllimi dhe Rëndësia e Studimit

Duke qenë një studiues teorik dhe pragmatik në kontinuitet i fushës së tatimeve dhe konform me këtë edhe përballja permanente me dukurinë ekonomike të tatimeve, përmbushjen, mbledhjen, implikimet, më imponojnë, krahas me dëshirën, synimet e mia që përmes këtij studimi të gjejme metodën e rritjes së të ardhurave nga tatimet drejtë:

- Hulumtimin e dukurive të sistemit tatimor, fiskal.

- Metodë të re veprimi, që fillimisht do e quaja **ekuivalencë tatimore** që nënkupton metodë të re të hartimit të politikës fiskale me pjesëmarrje mbizotëruese të tatimpaguesve, që me ndihmën e mentorit dhe pedagogeve tjerë në shkollën doktrale t'a definoj deri në përfeksionim. Ky re-formatim i sistemit tatimor që nënkupton reformën tatimore **”posh-të-lartë”** prej tatimpaguesit në qeveri gjithnjë i ri në terminologji, me synim për aplikim praktik, në vendin tim dhe më gjerë, do jetë një sfidë e veçantë për mua dhe gjeneratat në vazhdim, me insistimin që të jetë një metodë e re e bashkimit të interesit të tatimpaguesit dhe qeverive, për një përmbushje të plotë tatimore me qëllim të rritjes së të hyrave nga tatimet dhe ngritjes së zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të mirëqenies sociale.

Ky qëllim i hulumtimit është të gjejë apo të ofrojë deri në maksimum interesin e tatimpaguesit që të paguajë detyrimin tatimor ligjor në vlerën e tatimit e cila është në proporcion të fuqisë së biznesit të tij në njërin dhe në dobi të buxhetit të shtetit. Hulumtimi, përveç një paraqitje të vlerave të Produktit të brendshme bruto PBB, të gjendjes buxhetore të shtetit nëpër vite, performancës së pagesës së tatimeve në njërin anë dhe fuqisë, vullnetit të tatimpaguesve për pagesën e tatimeve, do të fokusohet më shumë në lidhshmërinë e këtyre dy variablave të ekonomisë në Kosovë. Se sa plotëson ky sektor nevojat për financim të buxhetit të Kosovës në të ardhmen, si ndikon ky financim në zhvillimin e tyre etj. Kur bëjmë fjalë për politikën fiskale jemi të vetëdijshëm se është një variabël e gjerë, por në kontekstin e hulumtimit tonë më tepër do të bazohemi në sektorin e tatimeve pasi që ky variabël luan rolin më të madh në financimin e buxhetit të çdo shteti. Për më tepër

ky studim ka për qëllim zbulimin e metodologjisë më të mirë dhe më të lehtë të pagesës së tatimit, përmes përfshirjes së tatimpaguesit në reformën tatimore me kusht që te njejtë do t'i përballonin më lehtë pagesat e tatimit dhe në interesin e tyre.

Kosova është një vend i Evropës Juglindore që është duke kaluar nëpër procesin e tranzicionit, prandaj edhe mund të jetë një objekt hulumtimi i përshtatshëm për mënyrën e aplikimit të sistemit tatimor në adoptim të reformës evropiane. Mbi këtë objektiv ne mund të rishikojmë faktorët themelore dhe pengesat që ndikojnë në zhvillimet e sektorit fiskal, në veçanti të sistemit tatimor.

Pavarësisht nga fakti se është ndërtuar një infrastrukturë ligjore e sistemit tatimor, Kosova është larg objektivave dhe standardeve të vetëfinancimit, madje në koherencë me parimin e barabarësisë së tatimeve dhe nivelit të evazionit fiskal. Në këtë kontest puna serioze hulumtuese shkencore në këtë fushë ka qenë minimale apo pak e prekshme.

Objektivat e punimit janë gjetja e zgjidhjeve të cilat përcaktojnë treguesit dhe drejtimin e duhur për rritjen e të hyrave nga tatimet sipas metodave me bashkëkohore, krahas obligimeve legjislative, duke përdorur metoda krahasuese, variabël të varur dhe testimin e tyre me metodat me bashkëkohore.

Ky model dhe hipotezat e ngritura në vazhdim do na shërbejnë për të identifikuar faktorët me relevancë që ndikojnë në: Analizën me detale të qëndrueshmërisë së sistemit tatimor me qasjen kritike të funksionimit.

B. Identifikimi i qartë i secilit variabël dhe lidhjet shkakësore të elementeve ndërlidhëse
C. Inkurajimin e tatimpaguesve për pagesën e tatimit dhe rritjen e të hyrave nga tatimet
D. Propozime edhe rekomandime që do të jenë të dobishme për institucionet vendime marrëse të Kosovës e më gjerë për sektorin e makroekonomisë, Administratës Tatimore të Kosovës, Agjencitë dhe organizatat që merren me mbështetjen e politikës fiskale dhe për vetë ndërmarrjet e vogla, të mesme e kompanitë e mëdha etj.

E. Rëndësi shkencore dhe praktike për dizajnin e politikave më efektive të menax-

limit të sistemit fiskal me qëllim të parandalimit të politikave të gabuara fiskale të cilat do të kishin implikime buxhetore “veç paguaj”.

F. Studimi do të ofrojë analizë për sistemin tatimor në Kosovë dhe vende të tjera, metodat më bashkëkohore të menaxhimit, qëndrimin e përbashkët për një politikë fiskale, model në rajon e më gjerë.

G. Si konkluzione, pas shumë vlerësimeve të praktikave nga më të ndryshmet, materialet e ofruara nga ky studim do të mund të përdoren nga politik bërësit gjatë vendimmarrjes por edhe nga menaxherët e institucioneve financiare.

H. Në fund, puna ime hulumtuese do të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime që do të jenë të dobishme për studentët për shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi për aplikimin e sistemit të ri tatimor, me interesa reciproke tatimpagues-qeveri.

IV. Pyetje dhe Hipoteza

Ndikimet e politikës fiskale në buxhetet e shteteve dhe në zhvillimin e ekonomisë, me theks të posaçëm tek bizneset por edhe në faktorë të tjerë ekonomikë, deri te niveli i PBB-së, kanë nxitur studiuesit si në fushën akademike ashtu edhe në atë institucionale.

Janë bërë përpjekje për të kuptuar se cili ka qenë ndikimi i politikës fiskale në drejtim të zhvillimit ekonomik, rritjes së bizneseve dhe tërheqjes së investimeve të huaja. Për të ardhur deri te realizimi i të ardhurës më të lartë buxhetore në njërin anë dhe rritjen ekonomike në anën tjetër, Kosova dhe vendet ballkanike duhet të kenë kushte stimuluese për tatimpaguesit dhe ekonominë, që si vende në prag të BE-së, të kenë aftësi për përmbushje të kënaqshme të buxheteve të tyre .

Pyetjet hulumtuese janë të lidhura kryesisht me temën dhe objektivin, në përputhje me paraqitjen e hipotezave, të cilat na mundësojnë arritjen e qëllimeve (objektivave) kryesore të temës. Pyetjet kanë karakter zbulues, përshkrues dhe vlerësues, si më poshtë:

1. A janë përfshirë tatimpaguesit në hartimin e reformës tatimore dhe cili ka qenë niveli i përfshirjes së tyre?
2. Si stimulohen tatimpaguesit për të kryer pagesën e detyrimeve tatimore?
3. Cilët janë faktorët e mos realizimit të tatimeve?
4. Sa ka ndikuar niveli i evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale në mos realizimin e tatimeve?
5. Cilat elementë të reformës tatimore nxisin zgjerimin e bazës së tatimpaguesve?

Ballafaqimi me problematikën e tatimeve, bazuar në përvojën, studimi i kësaj fushe gjatë hulumtimeve të mia si dhe në teoritë e autorëve të shumtë të këtij drejtimi, me nxitën të ndërmarr këtë studim të cilin mendoj ta finalizoj me një rezultat konkret, për t'u përdorur gjerësisht nga të interesuarit e fushës.

Nevoja për një rritje ekonomike po ashtu edhe të ardhurat publike më të larta, kanë nxitur shumë studiues, të cilët kanë zhvilluar teoritë dhe kanë ngritur shumë çështje që kanë të bëjnë me perfeksionimin e politikave fiskale, menaxhimin e tyre dhe shpenzimeve.

Hulumtimet praktike tregojnë se politika fiskale të studiuara mirë dhe të përmbajtura kanë dhënë rezultate. Në hulumtimin tonë janë shqyrtuar marrëdhëniet e ndryshimeve në reformën tatimore dhe nivelit të rritjes së të hyrës nga tatimi, pjesëmarrjen e tatimpaguesve në reformën tatimore dhe stimulimi i tyre. Të gjitha elementet e përfshira në këtë studim janë në lidhshmëri me njëra tjetrën dhe shërbejnë që ky studim t'a marrë formën e duhur. Me të dhënat dhe faktet e përdorura vazhdimisht do bëjmë testimin e projektit në mënyre që të dëshmohet se në çfarë relacioni do të krijohen interesi i tatimpaguesit dhe nevojat e qeverive për buxhet. Sipas studimit të bërë, brenda FMN-së ristrukturimi i ekonomisë me politika fiskale shpesh na shpien në stimulimin e sektorëve të shërbimeve duke destimuluar sektorin e bujqësisë apo atë të prodhimit. Kjo politikë që favorizon mbushjen e buxhetit vetëm sot për sot (brenda vitit), pa planifikuar për afat

më të gjatë kohorë. Në këtë kontest do kemi analiza në mënyrë që politika fiskale mos të krijoj disfavor të zhvillimit në sektorë të caktuar të cilët kishin më pas ndikim në një afat më të gjatë kohor.

Hipoteza kryesore

1. *Stimulimi i tatimpaguesve të rregullt dhe pjesëmarrja e tyre në ndërtimin e politikës fiskale rrit përmbushjen tatimore.*

dhe nën hipotezat

- a. Metoda e re e ndërtimit të politikës fiskale “Poshtë-Lart” rrit përmbushjen buxhetore nga tatimet.
- b. Ndryshimi i normave tatimore dhe zgjerimi i bazës të tatimpaguesve rrisin të ardhurën tatimore.

V. Metodologjia e hulumtimit

Për të sqaruar pyetjet kerkimore të parashtruara është e nevojshme shqyrtimi i disa burimeve informacione, relevante me parashtrimin e problemit “Nevoja për reformimin e sistemit tatimor”

Ky hulumtim shfrytëzon literaturën e pakufishme shkencore dhe institucionale nga bibliotekat dhe interneti në lidhje me tatimet dhe reformat fiskale, në fokus të debatit kritik dhe analizës së arritjeve. Për qëllimet e hulumtimit tonë, ky punim bazohet në përdorimin e të dhënave primare dhe sekondare, mbi bazën e një lidhje të mundshme shkak-pasojë apo modelit të një hulumtimi përfaqësues. Të dhënat primare janë mbledhë përmes pyetësoreve enkas për këtë qëllim studimi (nga bizneset, qytetarët dhe zyrtarët tatimorë).

Gjatë përpunimit kemi ndërtuar dy baza të dhënave: Baza e parë është me pyetësorët nga Zyrtarët e Administratës tatimore (pozitat e mesme) gjithsej 126 dhe tatimpagues 524 me përfshirje të 379 ndërmarrje të mesme, 126 ndërmarrje të vogla dhe 19 ndërmarrje të mëdha, të shpërndara nëpër qendrat kryesore urbane në Kosovë) ndërsa baza e dytë ka

të bëjë me pyetëtorët nga qytetaret që përbëjnë 503 qytetarë të kategorizuar sipas moshës, gjinise dhe punesimit, me përfshirje në gjithë Kosovën.

Të dhënat sekondare janë marrë nga raportet origjinale të institucioneve relevante kombëtare e ndërkombëtare që kanë të bëjnë me tatimet dhe politikën fiskale. Janë përzgjedhur burime të rëndësishme në raporte me periudha deri dhjetë vjeqare nga institucionet për menaxhimin dhe mbledhjen e tatimeve, administratës tatimore të Kosovës – ATK, Doganë, Agjensionin e statistikave të Kosovës, BQK, FMN, BB e tjera.

Pjesë e veçantë e punimit është analiza e të dhënave përmes; metodës së analizës apo qasja që nënkupton procesin e përpunimit, interpretimin, vlerësimin dhe shpjegimin e të dhënave të mbledhura dhe karakteristikave të tyre, gjithnjë mbi bazën e pyetjeve kërkimore dhe hipotezës së hulumtimit si dhe metoda krahasuese statistikore që nënkupton teknikat e analizës statistikore për përpunimin e të dhënave të mbledhura dhe krahasimin e informacioneve. Përmes analizës statistikore kemi përfituar përshkrimin e të dhënave, tiparet e tyre dhe testimin e marrëdhënjëve midis grupit të të dhënave. Gjatë realizimit të këtij punimi shkencor janë përdorur të dhëna empirike mbi ecuritë tatimore, përshtypjet dhe sjelljet e tatimpaguesve, të ardhurat publike dhe karakteristikat e tyre në periudha të ndryshme historike sipas rajoneve dhe në botë.

Kemi bërë trajtim analitik të përmbushjeve tatimore në dhjetëvjeçarin e fundit në Evropë e posaçërisht në Kosovë si dhe të shmangies nga tatimi dhe evazioni tatimor, duke u munduar të njihemi nga afër me problematikën në fjalë, me qëllim pasqyrimin e gjendjes reale de lege lata dhe paraqitjes së alternativave de lege ferenda.

Si variabël e varur është “Të ardhurat tatimore në Kosovë” e cila varet nga disa variabla të pavarura si :

1. Stimulimi i tatimpaguesve të rregullt përmes rimbursimit në fund të periudhës tatimore.
2. Përparësia në kushtet e furnizimeve publike dhe kreditimet financiare për tatim-

paguesit e rregullt.

3. Pjesëmarrje e tatimpaguesve në krijimin e politikës fiskale

Pyetësorët janë të strukturuar mirë dhe përshtatur për tri kategori të popullatës; bizneset e vogla të mesme, të mëdha, zyrtarët tatimorë të cilët merren me administrimin e tatimeve dhe qytetarët lidhur me ndikimin e tatimeve në mirëqenien dhe zhvillim. Të dhënat nga pyetësorët do të përpunohen në programin SPSS për të na shërbyer më tej për përllogaritje të rezultateve ekonometrike.

Teknikat e ekonometrisë do të përdoren për të bërë analizën e variablave të pavarura dhe ndikimet e tyre në variablën e varur. Kjo metodë e bazuar në modele të njohura më parë si nga Hughes etj identifikonë lidhjet ndërmjet sektorit fiskal dhe tatimpaguesit, zhvillimin e sektorit tatimor, ndikimin e variablave të pavarura në rritjen e të ardhurës tatimore dhe zhvillimin ekonomik të bizneseve, ndikimin e këtyre në zhvillimin e ekonomik të vendit e posaçërisht, vullnetin, formën dhe fuqinë e tatimpaguesve për pagesën e tatimeve. Për të identifikuar këto ndërlidhje do të përdoren një numër i indikatorëve makroekonomikë. Krejt në fund përmes analizës përshkruese dhe regresionit janë bërë analiza e rezultateve dhe testimi i hipotezave të parashtruara.

VI. Kufizimet

Punimi im doktoral bazohet në të dhënat, informacionet dhe burimet autentike të sigurta. Përpjekjet e mia do jenë që gjatë punimit të kem kujdes në ruajtjen e qëllimit dhe objektivit të përcaktuar, duke shtjelluar problemin brenda kornizave vëllimore të strukturës së projektit. Orientimi për një punim cilësor i kufizuar në qëllimin final duke përdorur variabla të mundshme. Punimi do këtë zgjedhje kuantitative, të sakta për të gjetur zgjidhje në testimin e variablave. Përpjekja do përqendrohet në shtjellimin e problemit që do japë rezultate praktike të parashikuara në këtë punim. “Kufizimi” si shprehje, në ekonomi ka një përkufizim të ndryshëm nga shkencat e tjera, sepse shumë terma kanë kuptime të ndryshme në ekonomi.

Gjatë hulumtimit kemi shkuar në analizë të problemit deri në mundësi, që pastaj kuptimi i temës të ketë kufizime, por që nuk e dëmton shpjegimin e temës që:

- Mbledhja e informacioneve në kohë më të shpejtë.
- Preciziteti në matjen e variablave të krahasuara
- Përqendrimi në problemin e temës
- Punimi i disertacionit sa më i kompletuar
- Realizimi i rezultateve më të mira me kosto rentabile.

Megjithatë duke qenë një punim personal , ky hulumtim është përcjellë me kufizime kohore dhe financiare, në pamundësinë e shqyrtimit të të gjitha dukurive që lidhen me sistemin tatimor. Një kufizim tjetër ishin ndryshimet e shpeshta tek terminologjia bashkëkohore ekonomike e tatimeve dhe e fundit shumësia e autorëve teorikë dhe praktikë që janë marrë me problematikën e tatimeve.

VII. Burimet e Referimit

Duke pasur parasysh se për temën e tatimeve diskutohet çdo ditë, madje jo vetëm në rradhët e qeverisë, në tryezat dhe konferencat ndërkombëtare por edhe në tavolinat e familjeve tona, nuk është shumë e vështirë të gjejmë burime referimi për këtë temë. Mirëpo si çdo vend që ka specifikat e veta, edhe Kosova e Ballkani në përgjithësi sidomos vendet në tranzicion, kanë specifikat e veta. Në aspektin teorik do të shfrytëzojmë mendimet dhe literaturën e autorëve të ndryshëm evropianë e botërorë, literaturën bazë të studimeve të mia nga punimi i magjistraturës, publikimet shkencore dhe pjesëmarrjen në konferenca.

Përmbledhje për kapitull

Kapitulli i parë shtjellon qëllimin dhe rëndësinë e hulumtimit në punimin doktoral, duke parashtruar qartë nevojën për reforma tatimore në drejtim të rritjes së të ardhurave nga tatimi, shtimin e efikasitetit të sistemit tatimor dhe zhvillimit ekonomik. Në këtë ka-

pitull po ashtu janë parashtruar hipotezat dhe metodologjia që përdorët gjatë këtij punimi. Burime preliminare të të dhënave për këtë temë do të jenë ecuria e praktikave të përmbushjeve tatimore në Kosovë dhe regjionin ballkanik me theks të veçantë Shqipëri Kroaci dhe Bullgari, duke studiuar nivelin e përmbushjes vullnetare të tatimeve e duke u shoqëruar me përdorimin e literaturës ekonomike të mundshme në botë. Të dhënat për qëllime hulumtuese do të mblidhen nga burime të ndryshme dhe kryesisht nga burimet autentike të buxheteve të shteteve përkatëse. Duke përdorur të dhëna autentike studimi do të na mundësojë vëzhgimin e fenomeneve të shumta gjatë periudhave kohore për vende të ndryshme. Do të shfrytëzohen të dhëna autentike nga përmbushjet tatimore në Kosovë në dhjetëvjeçarin e fundit si dhe informatat nga buletinet e buxhetit të shteteve tjera në rajon e më gjerë. (të dhënat sekondare).

Të dhënat parësore janë objekt i hulumtimit në teren dhe ato përbëhen nga pyetësorët për tri kategori respondentesh, tatimpaguesit, zyrtarë të tatimeve dhe qytetarë, me mendimet e të cilëve do përcaktojnë lidhshmërinë e variablave.

Disa nga problemet kyçe të mospagimit të tatimeve nëpër disa shtete si dhe politikat fiskale të tyre, shkallët tatimore, lirimet si dhe metodat e mbledhjes së tyre janë objekt i hulumtimit në këtë punim. Nivelin e përmbushjeve vullnetare dhe ato me mbledhje të detyrueshme. Puna shkencore do të bazohet në të dhënat e përgjithshme që do të shpjegohen duke përdorur metoda empirike dhe statistikore. Në këtë kontest, kemi të bëjmë me të dhënat e regjistruara në baza të rregullta, si nga niveli i të ardhurave publike po ashtu edhe nivelin PBB. Përveç kësaj, të dhënat do të merren nga FMN, BB, OECD, EUROSTAT, zyrat e statistikave dhe nga studimet tjera, që konsistojnë në politika fiskale. Megjithatë gjatë kërkimit shkencor do të zgjerohet lista preliminare. Vend të veçantë do të ketë literatura shkencore e deritanishme e shtjellimit të problematikave tatimore, që do të thotë se do të analizohen shumë teori të deritanishme lidhur me të ardhurat publike dhe

definicionet e tatimeve. Me këtë dhe me ndihmën e mentorit tim shpresoj të kompletjmë këtë studim që gjithnjë mendoj të jetë i zbatueshëm në praktikat e ardhshme.

Kapitulli II - Funkcioni Tatimorë në Literaturën Bashkëkohore

*Në këtë jetë asgjë nuk është e sigurt
Përveç tatimit dhe vdekjes.
Benxhamin Frenklin*

Njohja me mënyrën e funksionimit të sistemit tatimor, në përgjithësi, kushtëzon që duhet kuptuar mirë sistemin financiar të vendit ku jetoni , rajonit dhe më gjerë, trajtimin e kësaj teme të ndjeshme me studim retrospektiv të sistemit tatimor në Kosovë, është e pamundur pa inkorporuar mendimet e teoricientëve klasike dhe bashkëkohor për zhvillimet e financave publike:

Njëri ndër njohesit me të mirë të financave publike në Kosovë, profesor shumëvjeçar i fushës së financave në vitet ‘80 Sabahidin Komoni ka theksuar se *“Tatimet janë burimi kryesor i mbledhjes së të ardhurave publike me të cilat shteti bashkëkohor i plotëson shpenzimet publike, sipas rregullave dhe kompetencës së tij, pa marrë parasysh se a janë shtete të zhvilluara apo shtete në zhvillim, Komoni (2008).*

Problem evident ka qene emertimi i tatimeve si nocion me te cilen autoret jane marre ne te gjitha periudhat e zhvillimit shoqeror ekonomik. *Në shkencën mbi financat ekzistojnë shpjegime të ndryshme mbi nocionin e tatimit, sepse tatimet, si kategori historike, janë ndërruar sipas rrethanave ekonomike, politike, sociale e të tjera në sistemet shoqërore e ekonomike Dautbashiq (2004).*

Natyrisht nuk mund të bëjmë një hulumtim pa shfletuar punën e autorëve tjerë kushtuar financave publike, në veçanti rolin dhe rëndësinë që ata i kanë dhënë shkencës ekonomike si në zhvillimin e saj po ashtu edhe të rezultateve për qeverinë dhe shtetin. Njëkohësisht, kontributet e mendimtarëve rreth financave publike janë aktuale edhe në kohën e sotme edhe pse janë bërë reforma në sistemin ekonomik e politik. Mendimet e teoricienëve klasikë rreth problematikës së zhvillimit të financave, përveç

në aspektin teorik, në të shumtën e rasteve gjejnë mbështetje dhe janë aktuale edhe në aspektin praktik edhe sot e kësaj dite.

Paraqitja e tatimit si kategori ekonomike bëhet që nga shfaqja e pronës private, grupeve, klasave dhe shteteve. Prej bashkësisë me primitive skllave-pronare, sistemi feudal, kapitalist dhe socialist, tatimet kanë karakteristikat e shenjave klasore, që do të thotë se me tatime janë ngarkuar vetëm kategori të caktuara të popullsisë – shtresat e ulëta. Nga kjo nënkuptojmë se nocioni i tatimit lidhet me një detyrim në para që si qytetar duhet paguar shtetit tuaj. Nocione tjera që lidhen me tatimin janë edhe taksa, tagra, detyrimi financiar etj.

Definicione të tatimit sot ka pothuajse po aq sa ka autorë që merren me studimin e këtij instrumenti financiar. Ja disa definicione të autorëve të ndryshëm:

Tatimi është pjesë që çdo qytetar ia jep shtetit nga pasuria e tij, në mënyrë që shteti t’ia mbrojë pjesën tjetër të pasurisë (Monteskie); Njëherë ky autore ka mbrojtur teorinë e arsyeshmërisë se tatimit, i cili thotë se “tatimi është çmimi i shërbimeve të kryera nga organet publike- juridike...” gjithnjë duke i dhene rendesine e funksionit te shtetit dhe nevojën për pagesën e tatimeve.

Tatimi është çmimi që ia paguajnë shtetit qytetarët, në mënyrë që do t’u kompensohet me shfrytëzimin e shërbimeve publike (De Viti de Marko);

Tatimi është dhënia e parave që i mbledh shteti nga individët, në bazë të sovranitetit të vet, pa kundër shpërblim direkt, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve publike (Gaston Jeze).

Ne kuptimin e tatimeve si pagese e detyrueshme janë dhene mendime të ndryshme por edhe definicione; Tatimet janë dhënie të dhunshme të cilat i marrin trupat publike-juridike nga subjektet afariste private, për të cilat nuk japin kundër-shpërblim direkt (Vilhelm Gerhoff);

Pagesa e tatimit paraqitet si kryerje e obligimeve nacionale, që shtrohet para secilit indi-

vid, i cili paguan pjesën e vet, nga mjetet e veta, për shpenzimet e bashkësisë shoqërore (Laufenburger);

Parimet bazë të financës si shkencë ekonomike u zhvilluan në fillim të shekullit XIX, më vonë u paraqiten edhe teoritë mbi definicionin e termit “financë” duke mos ndalur së studiuar nga autorët me bashkëkohore të kësaj fushe. Kontributi i këtyre autorëve është i jashtëzakonshëm sa që edhe sot na shërben për të vazhduar më tej avancimin e kësaj shkençe me rendësi të veçantë për shoqërinë.

Trajtimi i financave publike kërkon aspektin makroekonomike, bazuar në rëndësinë që ka kjo fushe për ekonominë dhe buxhetin e shtetit në përgjithësi.

Në këtë kontest ne duhet përdorim analiza ekonomike sipas parimeve standarde për të përcaktuar qartë objektivat e caktuara p.sh për Prodhimin Bruto të një vendi, nivelin e të ardhurave publike, shpenzimet publike etj.

Financa publike si shkencë por edhe në praktikë përdor teori dhe metoda të ndryshme me qëllim që të japë përgjigje në planet e programet e qeverive, politikat që zbatohen dhe problemet që mund të rrjedhin gjatë mbledhjes së të hyrave publike.

Fillimi i qasjes në këtë aspekt, shkenca i gjen tek krijuesit e ekonomisë klasike si modele statistikore të ngjarjeve ekonomike për zhvillimin e financave publike. Veçanërisht studimet dhe analizat e politikave makroekonomike dhe studimi i tyre janë bërë të rëndësishme në SHBA dhe vendet tjera të botës së zhvilluar. Henderson (2007).

Financat publike kanë qenë si objekt studimi nga autorët anglezë prej shekullit XVI deri në shekullin XIX sidomos Loku, Hobsi, Hjumi David Rikoardo Milli etj.Bozhidar (1985).

Xhon Loku paraqiste përparësinë e tatimeve direkte në bujqësi, pronë të paluajtshme, ndërsa Tomas Hobs shpjegonte se ngarkesa më e lehtë tatimore do të ishte përmes tatimeve indirekte, me mendimin se përmes konsumit pasqyrohet forca ekonomike e popullatës – qytetarit. Për dallim prej këtyre Dejvid Hjumi është marrë me tepër me

huanë publike si ngarkesë për qytetarin duke konstatuar se “Nëse Shteti nuk e heq huanë shtetërore, atëherë huaja shtetërore do t’a zhduk shtetin”. Filipovic (1976).

Një pikëpamje interesante që paraqiste Hjum, një përafrim me hipotezën e ngritur me këtë punim ishte se ai, përkrahte pikëpamjen për ngarkesën tatimore varësisht prej përfitimeve që obliguesi tatimor i ka nga shteti. Derisa Adam Smith në pikëpamje të tatimeve është marrë kryesisht me parimet tatimore dhe bartjen e tatimit.

Mendimtari tjetër James Steuart përkundrazi përkrah borxhet shtetërore dhe është i njohur për sistemin e borxheve rentierë. Filiopovic (1976:2).

Në fund shekullin e XVIII kemi lulëzimin e shkencës kameraliste në Gjermani e cila ekonominë e vështron nga aspekti i nevojave financiare të shtetit . Autorë të njohur të kësaj pikëpamje janë Justi dhe Sonnenfels. Të njëjtit kanë studiuar financat publike në raport me fuqinë ekonomike të popullatës dhe pronës, duke konstatuar se shpenzimet publike nuk mund të rriten pa rritjen e bruto të ardhurave të popullatës që sot nënkupton PBB.

Në Angli kemi zhvillime të bujshme të trajtimit të financave publike, në fund të shekullit XVIII me forcimin e prodhimit manifakturës – mëngjesin e prodhimit industrial. Kjo është koha e lindjes së shkollës klasike të ekonomisë politike, në bazë të së cilës është ndërtuar edhe shkenca mbi financat. Përfaqësuesit kryesor të saj ishin Adam, Smith, David Riardo dhe J.St. Mill.

Smith tatimet i ka klasifikuar në bazë të burimeve natyrore të tokës, kapitalit dhe punës, konsumuese dhe kapitale. Derisa J.St.Mill ka përpunuar principin e barabarësisë së tatimeve. Siç shihet është karakteristikë që qysh në atë kohë janë identifikuar fushat kryesore të burimit të tatimeve që edhe në ditët e sotme janë aktuale dhe të zbatueshme. Në shekullin e XIX me lindjen e ekonomisë së mirëfilltë kapitaliste çështjet e tatimeve dhe financat janë zhvilluar më së shumti në Gjermani ku u shfaqen shumë ekonomistë për të trajtuar këto dukuri. Maltus dhe K.H. Rause janë autorët më të njohur të kësaj fushe në

këtë periudhë. Është e njohur ndarja e tatimeve si Subjektive (personale) dhe objektive (reale) nga Maltus 1830 derisa K.H. Rause ka përpunuar teorinë e taksave në vitin 1832.

Ekonomia dhe shkenca mbi financat është zhvilluar gjatë shekullit 19 me autorët F. Seligman dhe Adams të cilët janë kufizuar me tepër në ngarkesën tatimore dhe borxhet publike.

Shekulli i 20 paraqet një zhvillim të madh të ekonomisë kapitaliste dhe me vet këtë edhe pikëpamje e probleme të ndryshme të financave publike. Autorë me të dalluar nga italianët ishin: Eiandin, Nitin prej anglezeve H. Dalton, M. E. Robinson, prej Francezëve Nogarin, Lauffeubugerin etj, Filipovic (1976).

Ndër autorët më të njohur që merret me qështjen e tatimeve dhe taksave ishte edhe John Mynard Keynes i cili mbronte idenë e rolit mbizotërues të shtetit në zhvillimin ekonomik dhe tatimeve si kategori e domosdoshme e imponuar nga shteti. Ai mendonte se shteti përmes ndërhyrjes së tij dhe shpenzimeve publike do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e krizës ekonomike.

“A nuk duhet argument i çuditshëm që tatimet mund të jenë aq të larta sa ta mposhtin qëllimin e tij, reduktimi i tatimit do të na jap një rast më të mirë se sa një rritje e buxhetit të konsoliduar” Thomas (2012).

Përndryshe John lock është edhe me pesimist në përpjekjet për reformat tatimore “përpiquni dhe sajoni çfarë të dëshironi, vendosni tatimet e juaja si t’ju pëlqejë, por si do që të jetë, tregtarët do t’i heqin ato nga fitimet e tyre, John Locke.

Lidhur me rolin dhe ndikimin e shpenzimeve publike, përkatësisht të intervenimit të shtetit në ekonomi është i njohur mendimtari Jon Mynard Kejnsi. Sipas tij, shteti përmes ndërhyrjes në ekonomi, financave publike, shpenzimeve publike, ndikon në zhvillimin ekonomik, ku si objektiv dhe qëllim ka zbutjen e problemeve ekonomike, uljen e papunësisë apo edhe mënjanimin e krizës ekonomike. Kjo teori ose pikëpamje në fushën e financave publike dhe shumë çështje të tjera edhe sot e kësaj dite përkrahet dhe

aplikohet në shumë vende të botës përkundër faktit se shumë nga teoricienët e ndryshëm e kanë kundërshtuar. Teoria e tij për tatimet vazhdon me tej me thënien se “Sa më shumë që paguan diçka aq më pak ju mbetet në portofolin tuaj Thomas (2012). Apo po aty se “Normat tatimore do shërbejnë për rritjen e ekonomisë apo deficitit buxhetor”.

Ndër kundërshtarët e Kejnstit në këtë çështje ishin veçanërisht mendimtarët si Friedman dhe Meiselman, të cilët e përkrahën politikën monetare, krahasuar me ndikimin e politikës tatimore të stabilizimit “kensian”, Njëherit Hamilton Friedman si themelues i neoliberalizmit dhe tregut të lirë thotë se shteti nuk duhet të ndërhyjë në ekonominë e tregut. Ai ishte i mendimit se makro-politika shtetërore duhet të ketë stabilizim dhe ulje të deficitit me uljen e shpenzimeve publike e jo me rritjen e taksave. Në bazë të kësaj, mund të konkludojmë se pikëpamjet dhe mendimet që i shtroi Keynsi për financat janë përhapur shumë dhe sot e kësaj dite janë aktuale, si për dalje nga kriza, ashtu edhe në zhvillimin ekonomik, JELÇIÇ (2001).

Në politikat fiskale tej oqeanike – SHBA kemi tri drejtime tjera të reformave fiskale dhe ato fokusohen në:

1. Ulje e taksave për klasat e mesme
2. Rikthimi i taksës së investimeve si kredi dhe
3. Rritja e normës në ofertën e parasë dhe zvogëlimi në normën e çmimit

Bazuar në faktorët e lartpërmendur për politikat ekonomike, shtetet e ndryshme mund të hartonin programet e tyre qeveritare në ekonomi për të orientuar politikat zhvillimore sipas shpenzimeve, duke u angazhuar në zhvillimin e investimeve dhe punësimit.

Për më tej historikisht, është hulumtuar në aplikimin e reformave fiskale në shtresat dhe klasa të ndryshme të popullsisë. Disa autorë dhe qeveri kanë insistuar që vazhdimisht barra tatimore të bie tek të pasurit. Mirëpo qëndrueshmëria fiskale nuk ka mbështetur gjithnjë këtë ide.

2.1. Shkenca Bashkëkohore mbi Financat dhe Tatimet

Shekulli në të cilin jetojmë sjell po ashtu jo vetëm mendim të avancuar për financat publike dhe tatimet por edhe zgjidhje pragmatike të problemeve tashmë në rritje lidhur me të hyrat publike. Shtimi i produktit brendshëm bruto dhe avancimet në infrastrukturë dhe teknologji kanë rritur në anën tjetër nevojën e shpenzimeve publike e bashkë me këtë edhe problemin e të hyrës publike, tatimin dhe taksat.

Tani po bëjmë një udhëtim në auto udhën bashkëkohore të politikës fiskale në vend dhe botën e zhvilluar me ekonomistët më të njohur që u morën me këtë fushë:

Në procesin e tranzicionit të shteteve të Evropës Juglindore ishte e nevojshme reforma radikale e politikës fiskale dhe sistemit tatimor. Prandaj në këtë kohë shumë autorë bashkëkohorë u morën me këtë temë; Richard M. Bird, Robert D. Ebel and Christine I. Wallich, (1998).

Ndër autorët shqiptarë që u morën me financat publike dhe taksat ishin përqendruar kryesisht në përkufizimin dhe përcaktimin e produktit dhe shpenzimeve publike për të avancuar në propozimin e zgjedhjeve më të mira në fushën e financimit publik. Karakteristikë e parë e produkteve publike qofshin mallra apo shërbime, janë se të mirat të cilat përfitohen në mënyrë integrale nga të gjithë anëtarët e shoqërisë. Këto janë të mirat publike dhe shpërndahen e përfitohen në mënyrë publike, (Bundo 2007).

Në literaturën jo edhe aq voluminoze të hulumtimeve, autorët tanë, duke analizuar rrjedhat e dukurive ekonomike në vend, shkojnë më tej për të krahasuar dhe pasqyruar përvoja të ekonomisë evropiane në fushën e politikës fiskale.

Për këtë hulumtim jemi shërbyer me të dhëna mbi reformat tatimore në vendet ballkanike sipas raporteve statistikore të FMN-së BB, dhe autore si Mitra, Pradeep dhe Nicholas Stern, Tax Systems in Transition, World Bank Policy Research Working Paper 2947, Janar 2003 të cituar nga Grabowski & Tomalak (2004).

Me rastin e krizës fiskale dhe borxhit publik në Britani, viti 1694, “Qeveria angleze

gjeti si rrugë financimi të shpenzimeve marramendëse të saj, rritjen e taksave dhe aplikimin e një politike fiskale mjaftë agresive, Civici (2011). Klasat e mesme kanë qenë gjithmonë i vetmi burim i besueshëm për taksat. Në kerkim te shtresave te populates per zgjerimin e bazes tatimore autore tjere konstatuan se “Në qoftë se një qeveri me të vërtetë dëshiron të ardhura të mjaftueshme për buxhet, atëherë klasa e mesme është vendi ku ata duhet të orientohen, Adams (2004).

Çdo reformë që rrit tatimet për të gjitha kategoritë, që si rezultat ka vetëm rritjen e të ardhurës së qeverisë, duhet hedhur poshtë, Ryan McMaken (2006).

Në mesin e autorëve alternativ për ndikim në të hyrat apo shpenzime është dhe Harry Browne i cili rezymenë se “ Pa një reduktim të shpenzimeve, tatimet - taksat janë vetëm barrë e madhe e qeverisë (për çdo prerje të taksave që nuk ka të bëjë me një reduktim në shpenzimet) dhe kështu është një humbje e plotë e kohës sonë dhe përpjekje në qoftë se ne e mbështesim atë, Harry Browne (2005).

Konflikti i teorive shkon gjithnjë e më shumë se rritja ekonomike dhe efikasiteti i financave publike është rezultat i rritjes së normave tatimore apo uljes së shpenzimeve publike. Këto dy variabla janë gjithnjë më shumë të varura me njëra tjetrën.

Qeveritë e vendeve të ndryshme, në përpjekjet për stabilitetin fiskal, kanë bërë ndryshime në normat tatimore me qëllim të rritjes së të hyrave tatimore por që kanë pasuar me rritjen e çmimeve në treg, me q’rast kanë ndikuar drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kërkesës e me këtë edhe uljen e të ardhurave për bizneset dhe qytetarët.

Në shkrimet aktuale të autorit prestigjioz për politikën tatimore Vito Tanzi gjejmë shumë qasje pragmatike të trajtimit të politikës fiskale si: “të dhënat e fundit në dispozicion për vendet e OECD-së tregojnë se në dekadën e parë të këtij shekulli, raporti i taksave ndaj BPV-së është zvogëluar,” duke vazhduar me konstatimin se “është shumë më e vështirë të rriten taksat se sa reduktimi i shpenzimeve publike”, Vancouver Seminar (2010).

Në vështirësitë për ndërtimin e politikave fiskale shumë vende kanë kërkuar forma të ndryshme të bashkëpunimit për të bashkë-renditur politikat nën kushtet e globalizimit botëror. Vendet me të zhvilluara të G20 vazhdimisht janë takuar për t'u akorduar dhe për të gjetur zgjidhje adekuate për mbulimin e deficitit fiskal. Në disa raste vende të

veçanta kanë kërkuar që të koordinojnë politikat e tyre fiskale, duke ndihmuar për të tërhequr ekonominë e botës nga recesioni. Tanzi (2011).

Respektimi i rregullave dhe ligjeve tatimore ndër shtete dhe popuj është i ndryshëm. Në aktualitet Tanzi na pasqyron një ndryshim radikal të sjelljes së taksapaguesve në SHBA dhe Itali ku thotë se:

“Si udhëheqës i departamentit fiskal në Fondin Monetar ndërkombëtar shpesh dëgjoi popullin të thotë se më mirë është të punohet e jetohet në Itali, sepse atje “askush nuk paguan taksa” se sa në Amerikë ku tatimet paguhen plotësisht. Tanzi (2011)

Asnjë vend nuk duhet të shpenzojë më shumë se 30% të Produktit të brendshme Bruto GDP, Tanzi & Schuknecht (2005).

Apo kur i njëjti propozon ide për zgjedhjen e problemeve financiare për vendet në zhvillim Ekziston parimi “Orientohuni në më pak shpenzime publike dhe më shumë besim në zgjedhjet e ekonomisë së tregut Tanzi (2005).

Në kontekst të aplikimit të tatimeve në qarkullim apo tatimit mbi kapital kemi mendime të ndryshme, posaçërisht në kohën e ekonomisë globale. Njëkohësisht aplikimi i normave të ulëta apo të larta tatimore në reformat tatimore shtron dilema specifike në fushën e financave publike. Normat e ulëta tatimore mund të mbajnë vetëm përkohësisht lartë të ardhurat e tatueshme, Swank & Steinmo (2002).

Në përgjithësi “politika e re ekonomike për tatimet’ mund të karakterizohet si një mjedis ku politik - bërësit janë përballur me tri kufizime të ndërlidhura, ndërkombëtarizimi, krizat e brendshme ekonomike dhe shpejtësia buxhetore

Qarkullimi i pakufizuar i kapitalit nuk ka gjasë të na shpie në heqjen e problemit të

zhvillimit kombëtar me ngritjen e të ardhurave.

Qeveritë e ndryshme po bëjnë përpjekje për zbutjen e qetësisë sociale duke vënë mallrat publike në dispozicion posaçërisht në fushata elektorale .

Sot qeveritë e vendeve të zhvilluara dhe ato në zhvillim po përballen me sfidën e globalizimit apo ndërkombëtarizimit të ekonomisë për ka po kontribuojnë në ndryshimin e paradigmës në politikën e taksave të ngjashme me reduktimin e tatimeve specifike

Në të njëjtën kohe problemet e brendshme ekonomike imponojnë nevojën e reduktimit të shkallëve të tatimeve. Tatimet mbi kapitalin dhe punën i shtyjnë këto vende që të konkurrojnë me faktorin ndërkombëtar (konkurrencën) në aksionet e tyre për reduktimin e tatimeve. Por nuk janë, gjithnjë, konkurrenca e jashtme që determinon në tërësi politikën fiskale, janë dinamika e buxhetit kombëtar dhe numri i popullatës si faktor kyç i tatimeve të inkasuara.

Në përgjithësi hartuesit e politikës fiskale në botën bashkëkohore kanë presion të shtuar në ballafaqimin për të reformuar politikën tatimore.

Politika fiskale dhe sistemi tatimor në vazhdimësi përballen edhe me evazionin fiskal si një gangrenë e pashërueshme për shumicën e vendeve në zhvillim.

Teorikisht çështja evazionit fiskal është e pazgjidhur nëse nuk ka një marrëdhënie zëvendësues apo plotësues në planet e qeverive Bruno, Frey & Schneider (2003). Edhe pse, kryesisht, tatimet duhet të jetë neutrale në efektet e saj në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, qeveritë i përdorin atë për të inkurajuar ose dekurajuar vendime të caktuara ekonomike Irjan Hoshi (2009).

Mjetet me të cilat qeveritë financojnë shpenzimet e tyre, duke vendosur tarifatat për qytetarët dhe entitetet ndërmarrëse, u takojnë tatimeve dhe taksave të cilat mblidhen nga popullata.

Koha e globalizimit na shfaq një trajtë shqetësuese të politikës fiskale dhe fi-

nancave publike.

Me faktin se pasuritë botërore po përqendrohen në individë dhe numri i të varfërve po rritet sidomos në vendet e zhvilluara ku SHBA-të sot kanë mbi 60 milion të varfër, BE rreth 50 milion të varfër ky është fenomeni me spektakular i globalizimit. Këtë qëndrim e shpreh z Martin Wolf në kritikën që jap ndaj shkrimtarit Ramonet në “Le monde” cituar. “Progresi i shpejtë i globalizimit dhe neo-liberalizmit është shoqëruar me një rritje shpërthyes të pabarazive dhe një kthim në varfëri dhe pabarazi masive që është e kundërt me pritjet e sistemit të shtetit dhe qytetarisë modern, Calame (2009).

Lidhur me efektet e tatimeve dhe politikës së financave publike në prizin e globalizimit është marrë edhe Vito Tanzi i cili në publikimin:

“Publik spending in the 20th century” pasqyron analizën e Martin Wolf-it lidhur me nivelin e mbledhjes së taksave në krahasim me PBB në vendet e zhvilluara ku konstaton se: *“derisa niveli i taksave në pjesëmarrje të PBB-së në SHBA ishte 17 % në Francë ishte 7.5 % që për një periudhë 1913-1996 kjo diferencë u zvogëlua në më pak se 7% .vijmë në përfundimin se a) në asnjë vend nuk është ulur niveli i mbledhjes së taksës dhe se b) grumbullimet e taksave nuk përbejnë vetëm barrë për ndërmarrjet por krijimin e kuadrit të përgjithshëm dhe kapitalit social të nevojshëm për një ekonomi moderne. Calame (2009).*

2.2. Financat Publike në Funkcion të Tatimeve

Funksionet Bazike të Financave Publike:

Funksionimi i shoqërisë dhe shtetit kërkon mjete buxhetore për të mbuluar nevojat e domosdoshme dhe ato investive gjatë periudhës fiskale. Këto nevoja shtrihen në vepërimtari si siguria e vendit, rendi juridik, arsimi, shkenca kultura, administrata qendrore e lokale, investimet kapitale, shërbimet sociale etj. Në përgjithësi këto janë të mira publike të cilat i shfrytëzojnë qeveria përmes buxhetit të saj, në të mirë të popullatës dhe institucioneve të shtetit. Megjithatë sigurimi i mjeteve të buxhetit është një sfidë e të

gjitha shteteve sepse të njëjtat duhet të mbledhen nga popullata në forma të ndryshme, në bazë të pronës, kapitalit dhe aktiviteteve ekonomike të tyre.

Forma e krijimit të buxhetit të shteteve, shikuar historikisht varej nga formacionet ekonomike shoqërore dhe sistemi i organizuar. Në vendet me sistem socio-komuniste mbledhja e të hyrave publike dhe shpërndarja e tyre ka qenë kryesisht detyruese dhe e planifikuar derisa në sistemin e ekonomisë së tregut kemi një formë tjetër më të avancuar të mbledhjes dhe shpërndarjes së mjeteve buxhetore.

Të ardhurat publike sigurohen nga burime të ndryshme të të ardhurave por tatimet në të ardhurat nga aktiviteti ekonomik përbënë bazën themelore të vlerës së tatimeve të mbledhura.

Tregu është indikator themelor në shpërndarjen e të ardhurave, duke krijuar shtresa të pasura dhe të varfër të popullsisë në drejtim të krijimit të distancave në shpërndarjen e të ardhurave, duke krijuar shtresa shumë të pasura dhe të varfër. Në këtë kontekst mekanizmat e shtetit janë ata që mundohen të bëjnë ekuilibrimin e këtyre dallimeve, sidomos në masën e tatimit proporcional me të ardhurat e tyre.

Ky mekanizëm funksionon përmes ligjeve, në drejtim të sigurimit të akteve juridike në mes partnerëve afarist, kreditorëve tjerë, në fusha të ndryshme operimi.

Përveç kësaj mekanizmat e shteti kryen edhe funksionet klasike të saj siç janë: mbrojtja, ruajtja e rendit publik, qetësisë dhe sigurisë publike, mbrojtja e interesave nacionale, ndërtimi i objekteve të infrastrukturës etj.

Funksionet bazike të financave publike janë:

- a) Funksioni i nevojave të shtetit dhe qeverisë b) Investimet kapitale dhe
- c) Mirëqenia e popullatës – aspekti social d) Funksioni i ndërhyrjes.

a. Mjete të shumta financiare do t'i duhen shtetit për kryerjen e detyrave të përditshme përgjatë tërë periudhës fiskale e cila varësisht nga mandati i qeverisë projektohet në plane afatshkurtër njëvjeçarë apo ato strategjikë për më shumë vjet.

Këto mjete shfrytëzohen kryesisht për mallra e shërbime, paga e shpenzime të ndryshme për institucionet relevante të shtetit.

b. Investimet kapitale nënkuptojmë ngritjen e infrastrukturës rrugore, shkollat hekurudhat dhe objekte tjera me rëndësi vitale për institucionet dhe shtetin.

c. Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve nga buxheti do të shpërndahet për nevojat e shtresave jashtë aktivitetit ekonomik që nënkupton , pensionistët , shtresat sociale, studentët dhe pjesën tjetër të shoqërisë pa të ardhura.

d. Një pjesë e veçantë në planifikimet buxhetor është edhe nevojat urgjente respektivisht fondet rezervë në rastet e krizave ekonomike politike dhe situatave të jashtëzakonshme të emergjencës që eventualisht ndodhin.

2.3. Të Ardhurat Publike

Të ardhurat publike janë të ardhurat shtetërore, të nevojshme për plotësimin e detyrave dhe funksioneve të përditshme të cilat shtetit i mbledhë, inkason në bazë të kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Me zhvillimin historik shtetet kanë pësuar ndryshime si në strukturë po ashtu edhe në organizimin e tyre dhe me gjithë këtë edhe obligimet ndaj popullatës dhe institucioneve përkatëse janë rritur.

Sistemi i të ardhurave publike në shtetin bashkëkohorë ndryshon prej sistemit të shteteve skllavopronare dhe feudale. Sistemi i sotëm i të ardhurave shtetërore, përveç që ka ngjashmëri, kanë edhe ndryshime brenda të njëjtit formacion ekonomiko-shoqërorë. Ndryshime më të mëdha ose më të vogla në sistemin e të hyrave shtetërore i gjejmë te shtetet e njëjta në periudha të ndryshme si dhe te shtetet e ndryshme. Andaj, sot në botë nuk mund të hasim dy shtete të cilat e kanë sistemin e të hyrave plotësisht të njëjtë.

Kjo është e arsyeshme pasi që në formimin e sistemit financiar shtetëror , ndikojnë një mori faktorësh siç janë rregullimi politik shtetëror, sistemi juridik, ekonomik, struktura ekonomike, numri i banorëve, relacionet ndërkombëtare etj. Faktor determinues në botën e sotme bashkëkohorë është edhe dukuria e globalizimit dhe beteja që të jesh apo

jo në këtë rreth, determinon në masë të madhe fuqinë ekonomike të shteteve dhe ekonomisë së një vendi.

Mirëpo, pa marrë parasysh këto rrethana të hyrat e shteteve bashkëkohore i kanë këto karakteristika të përbashkëta:

- a) të hyrat publike inkasohen dhe shprehen në para. b) të ardhurat publike janë periodike dhe njëvjeçare.
- c) të hyrat publike mbledhen për të plotësuar nevojat publike dhe kanë karakter publik.
- d) Të ardhurat publike kanë bazë mbi fitimet e krijuar nga aktiviteti ekonomik, kapitalin dhe shërbimet që ofron shteti.

Nëpër periudha të ndryshme historike të hyrat publike janë paraqitur në forma të ndryshme si për nga struktura vëllimi dhe origjina;

Në sistemin skllavopronar burim i të hyrave publike ishin mbledhja e tatimit prej njerëzve të nënshtruar, (robërive) sepse për popujt e nënshtruar ishte normale që t'u paguajnë pushtuesve, derisa tatimet e mbledhur nga shtresa e lartë ishte shumë e vogël. Në sistemin feudal burim i të hyrave shtetërore ishin kryesisht nga kapitali i feudaleve, kurse kohë pas kohe janë grumbulluar të hyra nga klasat e nënshtruara,

Sistemi kapitalist sjell një transformim të thellë të sistemit të mbledhjes dhe inkasimit të hyrave publike dhe karakterizohet me ndryshime të vazhdueshme gjenerate pas gjenerate. Të ardhurat publike në këtë sistem kanë burim pasurinë, fitimin nga aktiviteti ekonomik e sidomos tatimin nga konsumatori.

Shteti kapitalist dhe ekonomia e tregut përjetoi zhvillim të hovshëm, sidomos shtresa e pronarëve të kapitalit me ç'rast fitimet nga të ardhurat dhe kapitali u rriten dukshëm në krahasim me të ardhurat e shtresave të mesme dhe të ulëta. Përveç këtyre në funksionimin e shoqërisë kemi shumë veprimtari të cilat funksionojnë por nuk prodhojnë të ardhura direkt, si arsimi, shëndetësia, kultura sporti etj. Prandaj shikuar në këtë aspekt

roli i rishpërndarjes së fitimeve , përmes tatimeve dhe kontributeve shoqërore është shumë i rëndësishëm dhe këtë mund rregullojë vetëm mekanizmi i shtetit përmes sistemit tatimor dhe taksave.

Ky mekanizëm bëhet me anë të të ardhurave publike, në mënyrë indirekte me zbatimin e instrumenteve të politikës financiare. Me anë të të hyrave publike krijohen mjetet financiare të cilat nëpërmes shpenzimeve publike do të nxisin ndarjen e faktorëve ekonomike në ato veprimtari ekonomike, regjione, në atë vëllim dhe strukturë të investimeve sipas politikës financiare dhe ekonomike të shtetit.

Përmes të ardhurave publike shumë qeveri do të tentonin të ndikohet në rregullimin e dukurive të ndryshme ekonomike si inflacionin, masën monetare madje edhe zbutjen e shqetësimeve sociale.

Financa publike bashkëkohore ka një rol me rëndësi sidomos në krijimin e kushteve për funksionimin e ekonomisë, biznesit dhe infrastrukturës.

Të ardhurat publike mund të ndikojnë në shumë mënyra në zhvillimin ekonomik dhe atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë e nxisin zhvillimin ekonomik me anë të akumulimit të të ardhurave publike të caktuara në fonde, të cilat e kanë funksionin për financimin e programit të caktuar të zhvillimit ekonomik, duke i nxitur ato subjekte ekonomike të cilat janë më me rëndësi për zhvillimin ekonomik. Kështu, me anë të zvogëlimit të përfshirjes së mjeteve dhe të strukturës së të ardhurave publike mund të nxitet ngritja e objekteve të reja në degë dhe regjione të caktuara, varësisht prej qëllimeve dhe metodave të politikës ekonomike dhe financiare.

Gjithashtu, me anë të politikës fiskale dhe masave mbrojtëse të caktuara mund të nxitet eksporti ose importi sipas degëve dhe lëmenjve ekonomike.

2.4. Llojet e të Ardhurave Publike

Të ardhurat publike sipas karakteristikave të tyre janë të shumta dhe paraqiten në forma të ndryshme. Prandaj, për studimin e tyre është më se i domosdoshëm klasifikimi (ndarja) i të ardhurave publike. Në teorinë dhe literaturën financiare hasim në ndarje të ndryshme të të ardhurave publike sipas kriterëve të ndryshme. Ndarja e të ardhurave publike ka rëndësi praktike dhe pedagogjike me qëllim të aplikimit sa më adekuat të sistemit të të ardhurave publike (shtetërore) dhe për realizimin e qëllimeve financiare e tjera të shtetit.

Sipas kriterëve të ndryshme, të ardhurat publike i ndajmë në:

1. të rregullta dhe të jashtëzakonshme,
2. origjinale dhe derivate,
3. juridiko-publike dhe juridiko-private,
4. të ardhura nga ekonomia dhe të hyra nga popullsia.,
5. fiskale dhe jo fiskale,
6. të ardhurat qendrore dhe lokale (komunale)
7. të ardhura të destinuara dhe të hyra të pa destinuara,
8. të ardhura në para dhe në natyrë.

Sabahudin Komoni “Financat Publike 2008

Karakteristikat e këtyre të ardhurave janë të njohura tani me për ekonomistët dhe studiuesit.

2.5. Të ardhurat nga Doganat e Kosovës

Doganat - janë instrumente fiskale të cilat shteti arkëton mjete financiare në momentin e importimit të mallrave të ndryshme, me rastin e kalimit të mallit nga një shteti në shtetin tjetër në pikat kufitare.

Dogana është një autoritet ose agjenci qeveritare e një vendi që ka për detyrë mbledhjen e detyrimeve të importit si dhe kontrollin e mjeteve e të mallrave të cilat hyjnë dhe

dalën nga territori doganor i atij vendi. Doganat janë instrumente të rëndësishme fiskale të cilat kanë rol shumë të rëndësishëm në formimin e të ardhurave publike. Doganat si instrumente fiskale kanë ngjashmëri dhe dallime me tatimet, taksat dhe kontributet. Ngjashmëritë vërehen sidomos në aspektin e formimit të të ardhurave publike. Në shkencën ekonomike dhe të financave doganat janë një lloj i tatimit.

Dallimet në mes të doganave dhe tatimeve, taksave dhe kontributeve janë se doganat vlejnë në kufi të shtetit, ndërsa instrumentet e tjera inkasohen brenda territorit të shtetit. Me zhvillimin dhe funksionimin e doganave si instrumente fiskale në mënyra të ndryshme ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Ndër refleksionet dhe ndikimet e doganave në zhvillimin ekonomik, në rritjen, zhvillimin dhe përmirësimin e strukturës së ekonomisë, ndërsa funksioni kryesor i tyre është në mbrojtjen e ekonomisë së vendit nga produkte të ndryshme, që të mos importohen me cilësi dhe çmime të njëjta nga konkurrenca e jashtme, si dhe të ndikimeve të tjera në ekonomi në krahasim me instrumentet e tjera fiskale.

Taksa Doganore

Buxheti i Kosovës përbëhet nga të ardhurat e mbledhura nga doganat e Kosovës dhe tatimet vendore. Të hyrat nga doganat ende përbëjnë pjesën kryesore të të hyrave buxhetore. Ky tregues paraqitet për shkak se, në kufi përpos taksës doganore dhe akcizës në mallrat ekskluzive mblidhet edhe tatimi i vlerës së shtuar. Ecuria e mbledhjes së të hyrave nga dogana ka pas trend dominues në buxhetin e Kosovës gjatë tërë periudhës së pasluftës me tendencë të zvogëlimit të proporcionit me tatimet vendore.

Akcizat

Akcizat - janë lloj i posaçëm i tatim qarkullimit të llojeve të caktuara të produkteve që janë përkufizuar në ligjin përkatës. Numri dhe llojet e produkteve të përfshira për pagimin e akcizave ndryshon, këto janë produkte me karakteristika të caktuara, si për shembull: prodhimi dhe qarkullimi i tyre janë të rregulluar nga autoritetet e pushtetit,

çmimet e tyre nuk janë elastike dhe se ngritja e çmimit të produktit nuk ndikon shumë në rënien e konsumit. Detyrimi për përlogaritjen dhe pagimin e akcizave është vendosur për konsumin e produkteve të veçanta, të pijeve alkoolike, produktet e duhanit dhe për lëndët djegëse motorike, si dhe për produkte të caktuara të përcaktuara si produkte luksoze. Detyrues të akcizës janë prodhuesi, importuesi apo çdo pjesëmarrës në qarkullimin e mallrave akcize, varësisht nga grupet e produkteve. Personat juridikë dhe fizikë që prodhojnë apo qarkullojnë mallra akcize kanë për detyrë t'i paraqesin kërkesë organit për të ardhurat publike për t'u regjistruar në regjistrin e detyruesve të akcizave. Bazë për pagimin e akcizës është çmimi i shitjes në të cilin llogaritet akciza. Gjatë importit të mallit në bazën e pagimit të akcizës përfshihen taksat doganore dhe shpenzimet e tjera të importit. Detyrimi për pagimin e akcizës lind në çastin e paraqitjes së detyrimit të pagimit të taksës doganore dhe të shpenzimeve të tjera të importit. Detyruesit e akcizës në qarkullimin e nënprodukteve të duhanit dhe të pijeve alkoolike akcizën e paguajnë me rastin e blerjes së pullave ose banderolave të kontrollit. Për eksportin e kryer prodhuesi, përkatësisht importuesi i produkteve akcize ka të drejtën e kthimit të akcizës së paguar, përkatësisht të drejtën e lirimit nga akciza. Shkallët e akcizave pasqyrohen në përqindje, në shuma absolute dhe sipas njësisë së masës dhe llojeve të veçanta të produkteve.

2.6. Tatimet dhe Taksat

Rritja ekonomike mund të ndikohet nga efekti që kanë tatimet në vendimarrjen ekonomike. Taksat bëjnë shpërndarjen e burimeve nga sektori privat drejt atij publik.

Një rritje në normat tatimore redukton kthimin nga investimet si në kapitalin fizik ashtu edhe atë human, gjithashtu redukton edhe kthimin nga shpenzimet e kërkim zhvillimit. Këto norma të ulëta kthimi nënkuptojnë edhe një reduktim të akumulimit të kapitalit dhe inovacionit, pra një rritje ekonomike më të ulët. Në një ekonomi globalisht normat e larta tatimore ndikojnë në uljen e rritjes ekonomike të një vendi edhe për shkak të zhvendosjes së kapitalit jashtë shtetit, në shtete me norma tatimore më të përshtatshme.

Në shumicën e vendeve të zhvilluara niveli i taksimit është rritur gjatë shek. të XX. Një rritje nga 5 – 10 për qind e produktit të brendshëm bruto në fillim të tij deri në 30 – 40 përqindje në vitet e fundit të këtij shekulli Tanzi & Schuknecht (1997).

Të ardhurat nga taksat si përqindje e GDP, 1970 – 2009 për vendet kryesore të BE-së, SHBA-në dhe Japoni.

Tabela nr.1

Pjesëmarrja e taksës në PBB 1970-2009

Shteti	1970	1980	1985	1990	1995	2000	2004	2009	Ndryshimi në pikë përqindje 1970 – 2009
Austri	39.8	48.2	50.7	48.8	50.2	50.1	49.3	48.7	6.9
Belgjikë	38.4	45.1	48.1	45.3	47.2	48.5	48.1	47.4	9.0
Danimarkë	39.9	43.0	45.5	45.3	47.3	46.9	47.9	55.7	16.8
Finlandë		43.9	49.7	53.4	55.1	54.8	51.7	52.9	9.0
Francë	31.4	45.6	48.7	47.0	48.9	49.8	49.0	48.3	16.9
Gjermani	33.5	35.4	38.6	43.1	44.6	46.0	42.9	44.5	11.0
Itali	25.5	33.6	37.2	41.2	44.3	44.9	43.3	45.6	20.1
Hollandë	41.5	51.0	53.4	49.3	46.9	45.7	45.8	45.6	3.9
Spanjë	15.7	19.0	25.3	31.9	336.6	37.6	37.7	34.7	19.0
Suedi		43.8	46.0	48.8	57.5	58.5	54.5	53.4	10.4
Britani e M	30.6	29.2	30.5	39.0	37.7	40.1	41.1	39.9	9.3
SHBA	22.4	21.2	19.7	20.2	20.7	22.6	18.3		
Japoni	15.2	18.1	19.6	21.3	17.5	17.1	15.6		

Burimi - Economic and financial Affairs 2014

Një rritje e tillë u pasua nga pyetja: cili është efekti që ka tatimi mbi rritjen ekonomike? Taksat, pavarësisht sa të domosdoshme janë, ndrydhn vendimë marrjen private, krijojnë një alokim të shtrembëruar të burimeve dhe krijojnë barrë të tepërt tatimore. Shpeshherë mendohet se këto ndrydhje të shkaktuara nga taksimi reflektohen në performancën ekonomike dhe mund të ngadalësojnë rritjen ekonomike. Sistemet tatimore mund të shtrembërojnë vendimarrjen private për dy arsye, Arnold (2008).

Së pari mund të marrë më shumë burime nga sektori privat (normat tatimore), dhe

së dyti mund të sigurojë të ardhura në një mënyrë më pak efëcente (struktura tatimore). Shpesh herë efekti (bilanci) negativ i tatimeve mund të rrjedhë nga ajo çfarë qeveria vendos të taksojë. Niveli i përgjithshëm i tatimeve reflekton zgjedhjen e shoqërisë ndaj madhësisë së sektorit publik, kurse struktura e tatimeve përfaqëson më së shumti një instrument për të realizuar këtë zgjedhje. Qeveritë mund të konsiderojnë ndryshimin e strukturës tatimore për të minimizuar efektet negative në rritjen ekonomike, duke mbajtur të pandryshuar nivelin e të mirave dhe shërbimeve publike.

Teorikisht efekti i tatimeve në rritjen ekonomike varet nga modelet e rritjes ekonomike. Duke i klasifikuar agjentët ekonomikë në firma dhe individë disa nga mënyrat se si tatimet ndikojnë në vendimmarrjen e tyre janë: Vendimmarrja individuale dhe vendimmarrja e korporatave Myles&Gareth,(2009).

2.7. Tranzicioni dhe Reformimi

Një aspekt i tranzicionit në të cilin duhet pas kujdes është krijimi i një strukture institucionale sa më afër me atë të tregut të lirë. Në shumë prej ekonomive në tranzicion këto struktura nuk kanë qenë të pranishme, ose kanë qenë pjesërisht duke shkaktuar mangësi në drejtim të ecurisë së reformave Tanzi (1999).

Implementimi i politikave për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe krijimin e bizneseve të reja është një sfidë për shtetin. Zvogëlimi i ngadaltë i sektorit shtetëror në termat e ndërmarrjeve shtetërore dhe inkurajimi i bizneseve të reja duhet të bëhet me kujdes duke shmangur mungesën likuiditete. Gjithashtu ristrukturimi i ndërmarrjeve shtetërore duhet të bëhet në një moment, në të cilin ai nuk pengon absorbimin e burimeve që do të përdoren nga firmat e reja dhe sipas një legjislacioni të caktuar.

Pra reformat duhet të vënë në fokus a) jo vetëm inkurajimin e bizneseve të reja por edhe b) mënyrën sesi ndërmarrjet shtetërore do të ristrukturohen. Faktet kanë treguar se nëse njëri prej këtyre dy elementëve nuk merret parasysh suksesi i reformave vihet në diskutim. P.sh nëse nuk ka një politikë inkurajuese për bizneset nga ana e qeverisë,

kostoja sociale e ristrukturimit të ndërmarrjeve publike rritet. Ose në çoftë se qeveria u jep përparësi lobeve të caktuara në privatizimin e ndërmarrjeve publike kjo do të prekte inkurajimin e bizneseve të reja.

Në suksesin e këtyre reformave rol të rëndësishëm luajnë subjektet e prekura drejtpërdrejt dhe sidomos shteti.

Tre janë grupet që fitojnë ose humbasin nga reformat në këtë rast World Bank (2002).

- Punonjësit e sektorit publik të cilët përballen me fenomenin e ngushtimit dhe vështirësitë për të hyrë në sektorin privat për shkak të aftësive.

- Firmat e reja sipërmarrëse të cilat kanë aftësitë e duhura për të qenë konkurruese në treg

- Oligarkët të cilët hyjnë në procesin e tranzicionit me një kontroll të caktuar mbi asetet shtetërore, ose me kontakte të forta me elitën e politikës të trashëguar që nga sistemi i kaluar.

Kombinime të ndryshme të reformave do të krijojnë kombinime të ndryshme të humbësve dhe fituesve prej tyre. Prandaj dy janë sfidat kryesore politike në promovimin e reformave ekonomike:

Së pari mbështetjen për bizneset e reja në reforma gjithëpërfshirëse derisa të sigurohet një rritje e efiqences në shkallë të gjerë, dhe Së dyti të mos lejojë që përfituesit e fazës së parë nga liberalizimi dhe privatizimi të vendosin rregullat e lojës për bizneset e reja që do të hyjnë në treg.

Për të përmbushur këto dy sfida qeveritë duhet të duken të besueshme, për sipërmarrësit e rinj, në të gjitha veprimet që shoqërojnë procesin e reformës ekonomike. Si edhe të mos lejojnë oligarkët të përdorin avantazhet që mund të kenë për të ndryshuar drejtimin e reformave ekonomike larg një tregu konkurrent. Në mjaft vende në tranzicion këtyre dy sfidave nuk u është kushtuar vëmendja e duhur duke bërë që shteti të kapet nga

interesa të ngushta private. Madje në shumë raste ata kanë humbur kredibilitetin për të ndërtuar dhe mbështetur reforma me një bazë të gjerë sociale.

Në kuadrin e reformave për strukturimin e sektorit publik, reforma e sistemit tatimor është një reformë mjaft e rëndësishme. Kjo reformë duhej të ndërmerrej që në hapat e parë të tranzicionit. Çështja themelore e kësaj reforme ishte se çfarë strukture tatimore duhet të aplikohet që të jetë më e përshtatshme për ekonominë.

Dy ishin zgjedhjet bazë për këtë strukturë: së pari implementimi i një sistemi tatimor sipas modeleve të vendeve me ekonomi tregu dhe së dyti përdorimin e një sistemi sa më të përshtatshëm për ekonomitë në tranzicion në përputhje me kufizimet institucionale dhe administrative Martinez & McNab (1997).

Kjo zgjedhje në pamje të parë si e lehtë, bartë me vete risqe të ndryshme si p.sh diferenca në strukturat tatimore të ekonomive të tregut (jo të gjitha shtetet perëndimore kanë sisteme tatimore të përshtatshme), hendekun e madh që mund të ekzistojë midis vendeve në tranzicion dhe atyre me ekonomi tregu në pikëpamjen e institucioneve dhe administrimit të tatimeve, etj. Midis vendeve në tranzicion gjithashtu ekzistojnë diferenca, prandaj agjenda e reformës tatimore në ekonomitë në tranzicion, është mjaft e gjerë. Parimi udhëzues i bazuar në teori dhe praktikë, është se sistemi tatimor i cili gjeneron të ardhura për qeverinë duhet të ketë një kosto të qëndrueshme për ekonominë, pra një bazë të gjerë tatimore dhe norma të ulëta tatimi.

Reforma tatimore në vija të përgjithshme mund të përmbledhet në këto elementë:

a. Procesi i reformës – përveç mangësive të trashëguara nga periudha komuniste, ka pasur vështirësi në fillimet e tij, pasi prania e tatimeve ka qenë e fshehur gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar dhe publiku megjithëse paguante tatime nuk ishte në dijeni të tyre. Ka qenë e vështirë që politikanët të siguronin mbështetje në publik për zbatimin e reformës tatimore, pasi tatimet e vendosura do të ndikonin në zgjedhjen e tyre.

b. Tatimet direkte – tatimi mbi fitimin e korporatave, tatimi mbi të ardhurat perso-

nale, kontributi mbi sigurimet shoqëror janë 3 shtyllat e tatimeve direkte.

Reformimi i tatimit mbi fitimin e korporatave u bë për herë të parë në Poloni dhe Hungari.

Kjo reformë ka qenë relativisht e ngadalshme dhe ka nxjerrë në pah probleme dhe çështje të cilat nuk mund të kenë përgjigje standarde. Normat e tatimit kanë qenë më të ulëta në krahasim me vendet e industrializuara dhe kanë ardhur në ulje në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore për të ulur evazionin dhe për të stimuluar investimet.

Tatimi mbi të ardhurat personale në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore është një formë hibride midis tatimit mbi të ardhurat dhe atij mbi konsumin. Të gjitha llojet e të ardhurave, përveç pensione ve dhe me disa përjashtime të vogla për dividendët dhe interesat bankare në disa shtete, janë subjekt i këtij tatimi. Ky tatim është progresiv, por normat e tij kanë variancë të gjerë midis shteteve. Vështirësitë që shkakton llogaritja e normave progresive dhe mangësitë në sistemin e administrimit, bënë që ky tatim të zëvendësohej me tatimin e sheshtë me normë fikse në pjesën e dytë të tranzicionit. Ky tatim u aplikua së pari në Rusi dhe më pas në Republikat e Baltikut dhe më vonë në pothuajse të gjitha vendet e tjera, por me norma të ndryshme.

Kontributet e sigurimeve shoqërore kanë vlera të larta në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, prandaj objektivi i kësaj reforme ka qenë ulja e normave për të rritur numrin e kontribuuesve.

c. Tatimet indirekte – tatimi mbi vlerën e shtuar, akciza, taksat doganore. Tatimi mbi vlerën e shtuar zëvendësoi tatimin mbi qarkullimin. Ky tatim përbëhej nga një normë e vetme, por që në vende të ndryshme kishte norma të ndryshme, të cilat në përgjithësi qenë më të larta se ato të vendeve të industrializuara. Akciza ishte një model tatimi i marrë nga vendet perëndimore, për të tatuar një grup mallrash të caktuara si duhani, alkooli, kafeja, hidrokarburet etj., të quajtura ndryshe si mallra luksi. Taksat doganore pothuajse

nuk ekzistonin në ekonominë e centralizuar dhe u bënë të domosdoshme në fillim të tranzicionit kur u bë edhe liberalizimi i tregtisë.

d. Modernizimi dhe reformimi i sistemit të administrimit – shumë vende në tranzicion kanë zbatua struktura tatimore duke u bazuar në vendet e zhvilluara, por sistemet e tyre nuk kanë pas një performancë të kënaqshme në mbledhjen e të ardhurave për shkak të mangësive në administrim. Këto mangësi vinin kryesisht nga mungesa e kapaciteteve, stafi jo i kualifikuar, ryshfetet dhe korrupsioni në radhët e tatimorëve, informacioni dhe shërbimet pothuajse inekzistente ndaj taksapaguesve, etj.

Prandaj krahas përmirësimit të strukturës tatimore i rëndësishëm është edhe reformimi i sistemit të administrimit, duke reduktuar koston në mbledhjen e të ardhurave tatimore. Ecuria e reformës nuk ka qenë e njëjtë në të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore si edhe në ish-Bashkimin Sovjetik. Vasquez (2001) zhvilluan një indeks për të vlerësuar ecurinë e reformës tatimore për dhjetë vitet e para të tranzicionit. Ky indeks përfshinte gjashtë elementë ku secili prej tyre merr vlera nga 0 në 3. Performanca më e mirë ka vlerën 0, kurse ajo më e ulët vlerën 3. Indeksi quhet “indeksi kumulativ i reformës” (CRI) dhe jepet nga shuma e rezultateve të secilit element: Koha e reformës – momenti në të cilin filloi implementimi i reformës duke përfshirë edhe vendosjen e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Përgatitja për reformën

- periudha e nevojshme për hartimin e legjislacionit tatimor dhe
- përgatitjet për zbatimin e reformës - Stabiliteti i sistemit tatimor
- frekuenca e ndryshimit të normave tatimore që prej fillimit të reformës
(normat e larta tatimore)
- devijimi pozitiv i normave tatimore maksimale nga mesatarja maksimale e vendeve, - përhapja e tatimeve speciale
- forma të tatimeve të cilat trajtojnë ndryshe kategori të caktuara, ose ndërmarrje

të caktuara.

Faza e parë e implementimit të reformës tatimore ka qenë si një laborator për hartimin dhe zbatimin e politikave tatimore. Meqenëse vendet kanë shumë diferenca midis tyre në shumë aspekte nuk mund të bëhen përgjithësime dhe nxjerrja e konkluzioneve të përgjithshme është e vështirë.

2.8. Karakteristikat e Sistemit Tatimor Bashkëkohorë

Teoria bashkëkohore mbi tatimet, politikën dhe sistemin tatimorë me përkushtim studion tatimin jo vetëm si burim kryesor i mjeteve të shtetit dhe organizatave juridiko- publike por edhe për vet faktin se tatimi është instrument më i ndërlikuar në financat publike.

Rëndësia e tatimit është rritur përherë gjatë zhvillimit historik të tyre, e që është shprehur me zgjerimin e përhershëm të detyruesve tatimorë, të numrit të llojeve të tatimit dhe të rritjes të ngarkesës tatimore Komoni (2008).

Mendoj se secila tentativë për të ndërhyrë apo lëvizur në politikën tatimore, në njëfarë mënyre, në shkallë të caktuar na shpie një hap drejt së panjohurës. E gjithë kjo për shkak se a) sistemi tatimor është mjaft i ndërlikuar dhe jetik për funksionimin apo më saktë mirë-funksionimin e shtetit dhe organizatave buxhetore. b) Ndikimi në të ardhurat e biznesit në anën tjetër dhe si e tillë duhet në masën që të mos e dëmtojë biznesin.

Kjo nënkupton se çështje të tilla si debati për alternativat tatimore, tatimin progresiv apo të sheshtë, veçanërisht për biznesin e vogël, duhet analizuar me shumë kujdes duke e vendosë në qendër të interesit sipërmarrjen dhe sipërmarrësin, që hapin vende pune. Tatimet si kategori ekonomike datojnë që nga krijimi i raporteve pronësore dhe mbi të ardhurat. Në fillim tatimet janë përdorë si e ardhur e shteteve por edhe sunduesve për të mbuluar shpenzimet e luftërave të zhvilluara, mbrojtjen dhe funksionimin e sektorëve tjerë të shtetit. Weisman (2002).

Sot, tatimet përdorën për të ngritur infrastrukturën publike, arsimin, shëndetësinë

por gjithashtu edhe për sigurinë publike. Një pjesë e konsiderueshme e tatimeve, në rolin e shpërndarjes së të ardhurave shkon edhe për mirëqenie sociale për shtresat pa të ardhura etj.

Shumë autorë shkencorë, me punimet dhe paraqitjet e tyre kanë pasqyruar efektet e masave tatimore dhe kanë propozuar zgjidhje që duhen ndërmarrë për të përshtat re-formën tatimore komfor sistemit dhe kushteve në shtetet e tyre dhe me gjerë. Për shem-bull ekonomistët e teorisë neo klasike mendojnë se tatimet janë ç'rregullues të ekono-misë së tregut, krijojnë jo efqiience në ekonomi. Ne këtë kontekst zhvillohet edhe lufta e mendimit për gjetjen e formave më adekuate për korrigjimin e këtyre çrregullimeve dhe jo efikasiteti. Kjo do të thotë se duhet vazhduar përpjekjet për gjetjen e llojeve të tatimeve adekuate për përmirësimin e kësaj gjendje.

Shtete të ndryshme përdorin reforma të llojllojshme duke ndërruar normat tatimore dhe llojet e tatimeve por gjithnjë mbi barrën e biznesit dhe të ardhurat tyre. Historikisht ka rezultuar se barra tatimore bie si qëllimë për shtresën e varfër duke ditur se të ardhurat krijohen nga shtresat e pasura dhe të mesme që merren me aktivitet ekonomik dhe janë më afër qeverisë dhe shtetit.

Më herët kemi thënë se shtresat e mesme janë sfera më interesante dhe e për-shtatshme për mbledhjen e tatimeve, një argument më shumë se të pasurit dhe pasuria e tyre gjithnjë shikohet me rezervë nga prizmi i qeverisë por edhe reformatorëve ekon-omistë. Sistemi tatimor i një shteti sot është një pasqyrë më reale e pushtetit dhe shtetit, situatën ekonomike dhe vlerat e qeverisë aktuale.

Funksionimi i sistemit tatimor do të thotë aftësia e shtetit në krijimin e të ardhurave dhe shpërndarjen e tyre në mënyrë proporcionale me nevojat publike dhe ato të qytet-arëve, të atyre që paguajnë dhe të atyre që nuk paguajnë.

Për ushtrimin e funksionit themelor fiskal të shtetit, është i nevojshëm të for-mojë sistemin tatimor dhe rregullat e funksionimit të tij. Varësisht prej sistemeve politike dhe ekonomike sistemi tatimore vlerësohet si sistem i drejtë apo jo i drejtë, efikas dhe i

dështuar, sundues apo në funksion të rritjes së mirëqenies qytetare.

Në rrugën e krijimit të ardhurave publike ka sfida të mëdha me faktin se tatimi është një pjesë e të ardhurës që duhet vjelë nga e ardhura e biznesit, punëtorit apo pasuria e qytetarit. Pjesa e të ardhurave që duhet të tatimohet konsiderohet një e ardhur tepërcë e qytetarëve apo edhe detyrim mbi pjesën e pasurisë së qytetarëve për funksionimin e organeve shtetërore dhe pjesës së popullatës pa të ardhura të mjaftueshme për jetesë. Tatimet, zakonisht janë të detyrueshme dhe të pavullnetshme dhe pikërisht për këtë fakt ekziston vështirësia permanente e sigurimit të hyrave publike dhe buxhetit të shteteve. Qeveritë përcaktojnë rregullat dhe ligjet e tyre mbi normat dhe bazën tatimore duke obliguar tatimpaguesit, bizneset që t'i deklarojnë dhe paguajnë tatimet e tyre sipas këtyre rregullave.

Kjo rrugë kërkon resurse humane (njerëz të përgatitur), kohë dhe shpenzime shtesë për aparatin shtetërorë përkundër përfitimeve nga këto angazhime.

Gjithashtu bizneset, tatimpaguesit e rregullt mbledhës (ndërmjetësues) të tatimeve indirekte janë një faktor mjaft domethënës në krijimin e të hyrave publike. Këto biznese gjatë mbledhjes së tatimit në burim dhe tatimeve në konsum (TVSH, tatimin në qarkullim, tatimin mbi qiratë etj) krijojnë shpenzime dhe angazhime shtesë si kontribute për shoqërinë dhe qeverinë. Njëkohësisht në këtë rrugë kemi edhe fshehje të tatimit dhe vonesë pagese të tatimit të mbajtur në burim. Prandaj orientimi i qeverisë në aplikimin e tatimeve të drejtpërdrejta apo indirekte është sfidë dhe problem permanent. Tatimet direkte si tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në fitim i korporatave mbledhen me lehtësi dhe me përlllogaritje më të lehtë. Aplikimi i akcizës mbi produktet specifike po ashtu krijon vështirësi në mbledhjen dhe inkasimin nga tatimpaguesit e veçantë deri në dështime nga qeveria.

2.9. Llojet e Tatimeve

Në botën bashkëkohore kemi disa llojet e tatimeve dhe taksave në aplikim. Regji-

one dhe organizata të ndryshme nëpër kontinente janë grupuar për të përshtatur dhe harmonizuar sistemet e tyre tatimore, me qëllim të standardizimit dhe shmangies së tatimeve të dyfishta për bizneset e tyre.

1. Tatimi në të ardhurat Personale

Është tatim i drejtpërdrejtë mbi të ardhurat e personave dhe bizneseve, zakonisht mbi fitimet neto dhe ka karakter kohor periodik vjetor.

Baza e përlllogaritjes përcaktohet nga të ardhurat të zbritura me shpenzimet e biznesit dhe kostot e mallrave apo shërbimeve të realizuara. Ky lloj tatimi funksionon përmes aplikimit të normave tatimore që varet nga sistemi politik dhe sistemi tatimor i shtetit. Baze themelore e përlllogaritjes së tatimit janë juridiksioni dhe rregullat e standardet

përgjithshme të përlllogaritjeve kontabël. Në shume prej shteteve aplikohet sistemi i pagesave paradhënie të tatimit në të ardhurat personale për të bërë përlllogaritjet (korrigjimet) përfundimtare në fund të vitit. Nga këto përlllogaritje rezulton pjesa e paguar me pak dhe quhet tatim për pagesë apo pjesa e paguar tepër që përcaktohet si pjesë për Rimburism (kthim) . rezultati negativ apo pjesa e paguar me tepër, rrjedh si rezultat negativ i fitimit neto apo humbjet vjetore të biznesit.

2. Tatimi mbi kapitalin

Tatimi mbi kapitalin apo ndryshe quhen fitimet kapitale kanë të bëjnë me vendosjen e tatimit mbi fitimet mbi diferencën gjatë shitjes së pasurisë kapitale të aseteve apo mjeteve tjera të cilat nuk janë të kategorizuara si kosto apo të hyra operative. Të ardhurat kapitale fitohen në rastet e shitjes së aseteve dhe diferenca e çmimit të tyre (që në disa raste mund të jetë edhe më e ulët apo negative që prodhon humbje kapitale) duke llogaritur tatimin mbi bazë të kësaj diferencë. Normat tatimore vendosen me ligj dhe varen nga sistemet tatimore të shteteve përkatës dhe anëtarësimit të tyre në organizata ndërkombëtare.

Disa prej shteteve normat tatimore i kanë vendosur varësisht prej vlerës së kapitalit,

disa tjera varësisht nga kohëzgjatja e kapitalit dhe ndryshimi i vlerës. Meqë vlerat e pasurisë kapitale kanë vlera të larta zakonisht normat tatimore janë më të ulëta. Një dileme të rëndësishme paraqet përkufizimi dhe përllogaritja e saktë e vlerës së kapitaleve , revalorizimi i tyre si kusht i eliminimit të dallimeve në vlerësime unike.

Për shkak të kategorive të ndryshme të kapitalit, toka ndërtesa dhe mjete me vlera me të ulëta standardet e kontabilitetit kanë mundësuar ndarjen në tri kategori të asteve që do të tatoheshin me norma të ndryshme zhvlerësimi.

3. Tatimi në Korporata

Tatimi në fitimin e Korporatave është thjesht një ngarkesë tatimore në bazë të rezultateve përfundimtare të suksesit të korporatave që është i ngjashëm me tatimin në të ardhurat personale por ka disa dallime. Dallimi themelor qëndron në statusin e biznesit dhe përgjegjësinë juridike të korporatës si biznes, mandej formës dhe madhësisë së biznesit.

Një korporate karakterizohet si person juridik , ndryshe nga personat fizik dhe bizneset individuale, pronarët apo aksionarët, me kapital të ndarë në numër dhe vlerë të specifikuar të aksioneve apo një ndërmarrje publike në pronësi të shtetit. Korporata mund të jetë e organizuar në mes aksionarëve dhe si entitet juridik . Korporata ka përgjegjësinë juridike dhe pronarët përgjigjen vetëm me kapitalin e investuar në korporatë. Prandaj edhe përgjegjësia për tatimet bie mbi rezultatet, fitimin dhe kapitalin e korporatës.

Bazë e tatimit në fitim të korporatave janë të ardhurat e tatueshme nga ushtrimi i afarizmit, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së paluajtshme² dhe të luajtshme , interesat , dividendat³ dhe fitimet kapitale të korporatës në periudhën njëvjeçare.

4. Tatimi mbi pagat e punëtorëve

Është po ashtu një lloj tatimi ekuivalent me tatimin në të ardhurat personale, i cili

2. Pasuri e paluajtshme -nënkupton për qëllime tatimore, e tërë toka dhe ndërtesat apo strukturat nën dhe mbi sipërfaqen tokësore dhe të lidhura me tokën, përfshirë pasurinë që është shtesë (ndihmëse) në pasurinë e paluajtshme;

3. "Dividentën" si shpërndarje të bërë nga kompania për aksionarët.

vendoset mbi të ardhurat në paga për të punësuarit në sektorin publik dhe privat. Tatimi në paga i punëtorëve ndryshe quhet “Tatimi i Mbajtur në Burim, (TMB) që nënkupton se është obligim dhe e drejtë e punëdhënësit të, mbajë tatimin nga të ardhurat (paga) e punëtorëve sipas ligjeve në fuqi për të paguar pastaj shtetit . Shkallët tatimore përcaktohen nga ligjet në fuqi dhe në shumicën e shteteve ato janë të ngjashme me shkallët tatimore të tatimit në të ardhurat personale. Normat tatimore për tatimin në paga zakonisht janë në shkallë proporcionale me të ardhurat, sipas rregullit shkallë më të vogla për të ardhurat me të vogla dhe shkallë më të larta tatimore për të ardhurat më të larta.

5. Tatimi në Pronë

Tatimi në pronë është një taksë që vendoset mbi pasurinë që pronari i pasurisë duhet të paguajë shtetit përkatës. Llojet e pasurisë (pronës) mund të ndahen në disa, por tri janë më kryesore “Toka, ndërtesat (pasuria e përpunuar apo korrigjuar) dhe pasuria e luajtshme. Tatimi në pronë zakonisht vendoset në vlerën e pasurisë, të përcaktuar nga autoritetet lokale apo e vlerësuar nga ekspertet e fushës dhe ka karakter periodik zakonisht në periudhë njëvjeçare. Tatimi në pronë paguhet edhe sipas kësteve periodike tremujore. Tatimi në pronë aplikohet edhe për transferim apo shitblerjen e pronës si dhe në rastet e përfitimeve me trashëgimi. Lloj i veçantë i tatimit në pronë janë pozita e pronës apo ekskluziviteti i pronës.

Tatimi në pasuritë e luajtshme apo të lëvizshme aplikohet në një gamë të gjerë produktesh dhe është pjesë shumë e rëndësishme për buxhetin e shtetit. Kjo pasuri nënkupton të gjitha pasuritë tjera si veturat , inventarët etj. që janë në përdorim të pronarit, janë në qarkullim dhe shërbejnë për qëllime ekonomike.

Me kalimin e kohës financat publike janë zhvilluar dhe reformuar sipas rrjedhave politike dhe ekonomike të kohës moderne. Ndryshimi rrënjësor qëndron se financat publike tani kanë karakterin e menaxhimit të mjeteve publike dhe karakterin publiko- juridik, gjë që nuk ishte në të kaluarën.

Zhvillimi bashkëkohorë i financave publike mbështet në praktikën :

- Përpjekjet për ndryshime të normave tatimore (zakonisht zvogëlimin e normave
- Rritjen e obliguesve tatimore që duhet të paguajnë tatime dhe taksa.
- Rritjen e bazës tatimore në vend të normave tatimore
- Rritjen e llojeve të taksave etj.
- Taksimi i kapitalit
- Taksimi i punës.

Në vendet e zhvilluara kemi tri lloje kryesore të hyrave publike :

1. Tatimi në të ardhurat personale dhe
2. Tatimi në fitim i korporatave
3. Tatimi i vlerës së shtuar

Derisa Harvey Rosen thotë se “Politika e qeverisë me mënyra e të tatuarit dhe shpenzimeve quhet financë publike” (Harvey, R. :2003).

2.10. Politika Fiskale në Evropë

Në mes viteve 1980 dhe 1990 shtetet e zhvilluara demokratike në mënyrë sistematike kanë ulur normat tatimore mbi të ardhurat personale dhe të ardhurat e korporatave, duke eliminuar lirimet dhe përjashtimet nga ngarkesat tatimore. Shqetësimet për efikasitetin e mbledhjes së taksave sa vijnë e shtohen dhe forma e shpenzimeve publike po përshkallëzohet.

Këto dukuri janë si rezultat i globalizimit dhe eliminimit të taksave doganore, lirisë së qarkullimit të mallrave dhe konkurrenca mbarë botërore pa kufij ekonomikë.

Ndërkombëtarizimi ka një rendësi të madhe por si duket është me kompleks sesa teoria e globalizimit sugjeron.

Reformat në politikat tatimore në mënyrë sistematike ndërtohen mbi bazën e qarkullimit

– lëvizjes së kapitalit ndërkombëtar dhe hapjes së tregtisë kombëtare, rritjen e kap-

italit aksionar dhe zvogëlimet e kostos tatimore për punën.

Në të njëjtën kohë kemi shkurtime të orientuara në normat efektive të taksimit të kapitalit dhe punës si kompensim për të mbuluar borxhin publik të stërngarkuara.

2.11. Përmbledhja për kapitullin

Është karakteristike se fusha e studimit të politikës fiskale dhe tatimeve është mjaft e gjere, për vetë faktin se prek drejtpërdrejtë shtresat e gjera popullore, ekonominë, popullatën si konsumatorë dhe mirëqenien e tyre. Me këtë sferë interesi gjithëpërfshirëse, tatimet, janë marre mendimtarë, ekonomistë, filozofë por edhe qeveritare të ndryshëm me interesa për ndryshime në favor të buxhetit të shtetit apo zhvillimit ekonomik.

Megjithatë në gjithë hulumtimin kemi konstatuar disa prej trajtimeve kryesore:

Së pari në trendet e reformës kanë rëndësi kushtet dhe historiku i tatimeve në ekonominë socio-komuniste.

Së dyti tatimet, janë kthyes, sa edhe detyrimi për t'i paguar ato. Këtu kemi parasysh se të gjitha tatimet paguhen për tu kthyer me vone tek popullata dhe funksionimi i shtetit. Se treti sistemin tatimor e paraqet puna e kryer nga administrata tatimore dhe kontributi e kultura e tatimpaguesve.

Në përgjithësi në vitet e para të reformës shtetet u fokusuan më tepër tek strukturat tatimore sesa te ndërtimi i kapaciteteve dhe modernizimi i administrimit. Ato duhet të

kishin ecur paralelisht për të evituar ngadalësimin e reformës. Së katërti reformat në sistemin tatimor duhet të jënë me fleksibile në raport me tjerat në ekonomi.

Nxjerrja e shpejtë e ligjeve dhe rregullave efektive do të qëndronte në fuqi për një kohë të mjaftueshme për të mos krijuar konfuzion në ekonomi.

Kapitulli III - Politikat Tatimore në Rajon - Krahësim me Kosovën

Republika e Kosovës e cila shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008 si shtet i ri nuk ka një histori të gjatë të politikës fiskale. Megjithatë dhjetëvjetëshi i parë i shekullit 21

Kosovën e sfidon krijimi i institucioneve publike e po ashtu edhe financiare, me theks të veçantë sistemin e politikës fiskale. Që nga viti 2000 në Kosovë filloi të formohet sistemi tatimor i ri me të gjithë strukturën e kuadrove, logjistike e legislative, të ndryshme nga ajo që kishte deri më tani. Sigurimi i të ardhurave publike në një shtet të shkatërruar politik dhe ekonomik ishte problem i jashtëzakonshëm. Kosova arriti që këtë një buxhet të konsoliduar me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare dhe shteteve në rajon.

Ekzistenca e sistemit tatimor ka lindur si një domosdoshmëri e shtetit për të financuar të mirat dhe shërbimet publike që ky sistem i ofron shtetasve të tij. Të ardhurat e siguruar nga sistemi tatimor përbëjnë edhe potencialin kryesor të të ardhurave buxhetore për shumicën e shteteve. Megjithatë vendosja e një sistemi eficient dhe të ndershëm tatimor është shumë larg e të qenit e thjeshtë veçanërisht në vende si Kosova, me përpjekjet dhe dëshirën për t'u integruar në ekonominë botërore. Prania e sistemit tatimor në ekonomi është më komplekse sesa thjesht realizimi i të hyrave qeveritare. Meqenëse tatimet më së shumti mbliidhen nga ekonomitë (bizneset) dhe nga individët, pagesa e tyre ndikon në fuqinë ekonomike e më këtë do të ndikojnë edhe në vendimmarrjen e tyre për investimet në vijim. Sistemi tatimor mund të prekë sjelljen e konsumatorëve duke ndryshuar nxitjet e tyre për të punuar, për të kursyer, për t'u arsimuar, për të investuar, mund të ndryshojë ekspozimin e tyre ndaj riskut, etj. Sistemi tatimor ka edhe efekte të tjera financiare siç mund të jetë ndryshimi i strukturës financiare të firmave, ndryshimi i strukturës organizative që mund të vë përballë korporatat dhe format e jo korporatave, ose bankat kundrejt ndërmjetësve të tjerë financiarë si shoqëritë e sigurimit, etj.

Reformat dhe dizajnimi i tyre në shtetet ballkanike në tere procesin e transformimit

ka qene nje proces i gjate dhe i ndërlikuar, përcjellë me problem e paqartësi. Kjo për arsye se te gjitha shtetet e pas sistemit Socialist-komunist kishin sisteme tatimore, bazuar ne ekonominë e planit dhe ishte jo adekuate me ekonominë e tregut.(Rigger Nord,2005:8) Shtetet ballkanike për ndryshim nga shtetet e tjera evropiane, tranzicionin ekonomik, përfshirë këtu edhe reformat tatimore i kanë bërë nën ndikimin e faktorëve dhe rrethanave politike mjaft specifike. (Peci, B. 2009: 27).

Qëllimi i mbledhjes së tatimeve është të financojnë shpenzimet qeveritare për prodhimin dhe ofrimin e të mirave publike si edhe të shërbimeve sociale bazë. Në këtë kontekst ndryshimi i strukturës tatimore do të ndikonte edhe në shpenzimet qeveritare. Reformat strukturore në sistemin e taksave, që në fillim të tranzicionit, kanë synuar në aftësimin e këtij sistemi për t’iu përshtatur ndryshimeve të ekonomisë dhe sektorit privat në rritje. Një parim mjaft i rëndësishëm që duhet të kuptohet drejt edhe nga ana e qeverive, në ekonominë e tregut është se sistemi i taksave duhet të jetë një instrument me qëllim të vetëm: të rrisë të ardhurat në mënyrë sa më efëcente dhe të drejtë.

Disa nga elementët e përbashkët të sistemeve tatimore në ekonomitë në tranzicion

- Të ardhurat tatimore si përqindje e PBB janë reduktuar nga 24 në 22 për qind në ish Republikat Sovjetike dhe nga 35 në 33 për qind në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Për periudhën 1990 – 2000, të ardhurat tatimore të mbledhura nga vendet në tranzicion të Evropës qëndrojnë shumë poshtë nga mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian që është 37 përqind PBB mbështetur në : Eurostat (2010).

Të ardhurat nga tatimet direkte (tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve sociale) si përqindje ndaj totalit të të ardhurave janë reduktuar në 54 përqind të PBB në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në 43 përqind në shtetet e tjera. Këto vlera qëndrojnë larg mesatares së vendeve të industrializuara që është 65 përqindje të PBB. Kjo rënie i atribuohet kryesisht rënies së tatimit mbi fitimin.

- Efekt të kundërt ka pas pjesa e tatimeve indirekte e cila është rritur nga 38 deri në

44 përqindje të PBB dhe ka ardhur kryesisht nga prezantimi i tatimit mbi vlerën e shtuar.

- Në të gjitha vendet në tranzicion ekziston një kulturë e mosbesimit dypalësh midis tatimpaguesve dhe autoriteteve tatimore dhe mungesë të traditave në lidhje me pranimin vullnetar të legjislacionit tatimor - Nuk ka tradita të apelimit në gjykata në lidhje me vendimet e autoriteteve tatimore, për të rritur besueshmërinë në organet tatimore dhe përforcuar bashkëpunimin. - Nuk ekziston vetë – vlerësimi i bizneseve i cili do të zhvendoste koston e vlerësimit drejt sektorit privat duke reduktuar koston administrative.

Reforma tatimore e vendeve ballkanike ka evoluar me ndryshimin e kohëpas-kohshëm të normave tatimore si masë e vetme inkurajuese për biznesin.

Disa nga ndryshimet ne normat tatimore neper vite po pasqyrojmë ne tabelën ne vazhdim.

Tabela nr.2

Ndryshimet në normat e tatimeve periudha 1992-2009

Vendi	Tatimi në të	Tatimi në të ardhura	Tatimi mbi vlerën e
	ardhura personale	të korporatës	shtuar
Shqipëria	Paraprakisht 6	Paraprakisht ishte	1996: norma 20% dhe
	norma - nga 5% deri në 30%. Nga 1 korriku 2007 norma është 10%,	30% pastaj 20%, ndërsa nga 1 janari 2008 norma 10%,	0%
Bullgaria	1992: 6 norma 20%,	2000: 25% norma,	1994: norma 22%, 1999:
	24%, 28%, 32%, 36%	20% për bizneset e	e ulur në 20%,
	dhe 40% 4 norma nga 20% ne 40%	vogla 2002: norma	përrjashtimet
	2002: norma nga 0%	23.5% pastaj ishte	
		10%	
Kroacia	1994:00:00 2001: 3	1994: norma 20%	1998: norma 22%, 0% në
	norma nga 15%,		libra, ushqime
	25%,35% 2003:		themelore, medikamente, shërbime komunale dhe
	norma shtesë 45%		shërbime financiare të
			përrjashtuara
Maqedonia	2 norma: 15% dhe	Më parë 30%; pastaj	2000: norma 19%,
	18% (më parë: 3	15%; në vitin 2007 u	norma e ulur 5% në
	norma nga 23% në 35%) 2002; normat nga 0% deri 38%; pastaj ishin normat progresive	zvogëlua në 12%; në vitin 2008 u zvogëlua në 10% sa është momentalisht	produkte ushqimore
	15%,18% dhe 24%; nga 1 janari 2007 deri më 1 janar 2008 ishte 12%, ndërsa nga 1 janari 2008 është 10%		për qëllime humanitare, mjete dhe mekanizma bujqësore, libra
Rumania	2003: 5 norma: 18%,	2003: norma 25%	1993: norma 22 % dhe
	23%, 28%, 34% dhe 40 % tani është 16 %	(më parë 38%) tani është 16%	11% norma e ulur; 2003: norma 19% dhe 9% norma e ulur, përrjashtimet: shërbimet financiare dhe shërbimet publike

Sistemi Tatimor në Kosovë – Reformimi dhe Perspektiva

Serbia	Paraprakisht 14 %	Paraprakisht normat:	Paraprakisht tatimi në
	normë fikse në të ardhurat nga puna; nga të ardhurat tjera norma e 10%, 15% dhe 20%; tani 10%	20% - 30%; 2003: 14%; tani 12% për paga që vije duke u reduktuar deri në 10%, ndërsa për të ardhurat nga interesat, loja e fatit dhe qiraja maksima- lisht deri 20%	shitje me norma 20%, përjashtimet: shërbimet publike dhe disa produkte ushqimore: nga 2005 aplikohet TVSH-ja sipas 3 normave 18%, 8% dhe
			0% për barna, libra
Mali i Zi	Paraprakisht 14 %	Paraprakisht	Paraprakisht tatimi në
	normë fikse në të ardhurat nga puna; nga të ardhurat tjera norma e 10%, 15% dhe 20%	normat: 20% - 30%2003: 14% tani 10%	shitje me norma 20%, përjashtimet: shërbimet publike dhe disa produkte ushqimore:
Kosova	Paraprakisht nga	Paraprakisht nga	2001: 15% dhe 0%, disa
	2002: 4 norma 0%,	2002: 20% norma për kompanitë e mëdha dhe natyrisht për bizneset e vogla; nga	përjashtime; 2002-ujë për regjistrime në qarkullimin mbi
	5%,10% dhe 20%; nga 1 janari 2009 katër norma	1 janari 2009 norma 10 %	50.2000 euro; nga 1 janari 2009 norma 16% dhe 0%
	0%,4%,8% dhe 10%		

Burimi: Peci, B 2009.


3.1. Dinamika e Politikës Fiskale në Shqipëri

Për ndryshimet e reja në ekonominë e Shqipërisë, ishin të domosdoshme një sërë reformash, për të mbështetur dhe vazhduar rrugën drejt ekonomisë së tregut. Reformat kishin karakter stabilizues, duke u bazuar në paketën standarde që konsiston në liberalizimin e plotë të çmimeve, uljen dhe kontrollin e deficitit buxhetor në politikën monetare shtrënguese nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare dhe liberalizimit të tregtisë së jashtme. Paralelisht me reformat stabilizuese u ndërmorën dhe reforma strukturore. Qëllimi i reformave strukturore ishte reformimi i sistemit të tatim – taksave, sistemit financiar dhe atij bankar, modifikimi i strukturave institucionale për të rregulluar dhe kontrolluar aktivitetet ekonomike, për të lejuar ushtrimin e veprimtarive private, për të lehtësuar shkëputjen financiare të ndërmarrjeve nga buxheti i shtetit, për të siguruar një mbështetje financiare, ndonëse të kufizuar, për sektorin privat në zhvillim si dhe të ndihmonte në realizimin e reformave stabilizuese. Reformat fiskale janë pjesë e këtyre reformave të nevojshme për të menaxhuar periudhën e tranzicionit. Ekzistenca e një sistemi fiskal të konsoliduar në një ekonomi në tranzicion është një faktor i rëndësishëm për stabilizimin e variablave makroekonomike dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Të ardhurat tatimore dhe doganore në Shqipëri ku mblidhen disa lloje të tatimeve dhe taksave të zbatuara sipas ligjit në fuqi. Aktualisht janë gjashtë kategori kryesore si: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatimi mbi fitimin, Akciza, Tatimi mbi të ardhurat Personale, taksat doganore dhe taksat vendore etj.

Mirëpo të ardhurat nga tatimet dhe taksat doganore përbëjnë vlerën kryesore në zërat e bilancit buxhetor të të hyrave publike. Për çdo vit vërehet një sukses më i mirë në rritjen e të ardhurave nga këto dy kategori e të ardhurave dhe një performancë pozitive, që mundëson edhe ngritjen e investimeve publike dhe mirëqenies së qytetareve. Në periudhën 2000 deri 2005 ka pasur rritje prej 11 %, në periudhën 2006 deri 2008 një rritje

mesatare 14 % për tu zvogëluar në vitin 2009 pas krizës globale në shkallën 7% . Kategoria kryesore e të ardhurave edhe më tej mbetet tatimi i vlerës së shtuar cili merr pjesë me mbi 50 %, pastaj vjen akciza, tatimi në të ardhurat personale etj.



Grafiku nr.1 - Të ardhurat nga tatimet dhe Doganat në Shqipëri 2000-2011

Reformat në sistemin tatimor

Ekonomia dhe sistemi politik në Shqipëri vendosi përcaktimin e vet për një ekonomi të tregut, që do të thotë një politikë e cila të shpie drejtë mbledhjes së taksave në bazë të fuqisë së shoqërisë tregtare dhe individëve mbi pasuritë e tyre në mënyrë të barabartë dhe transparente.

Gjatë 10 vjetorit të parë janë ndërmarrë reforma fiskale si në drejtim të politikës së tatimeve ashtu edhe në drejtim të administrimit të tyre. Këto reforma kanë qenë thelbësore për ndërtimin e një sistemi tatimor optimal, pasi nga e kaluara nuk ishte trashëguar asnjë element i tij.

Sistemi tatimor u vendos në varësi të ekonomisë dhe sektorit privat në rritje, nëpërmjet prezantimit të tatimeve dhe taksave të reja, tatimit të shërbimeve dhe transaksioneve të cilat më parë nuk janë tatuar, krijimit të kapaciteteve për të mbledhur dhe administruar këto tatime, etj.

Disa nga reformat kryesore në politikën tatimore janë:

- a. Tatimin mbi qarkullimin e zëvendëson Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSH dhe konsiderohet si reforma më e rëndësishme, pasi ky tatim është edhe burimi kryesor i të ardhurave tatimore. Ai ngarkon konsumin e mallrave dhe shërbimeve në masën 20%. Debatet dhe konfliktet në lidhje me normën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe produktet e përfshira në këtë lloj tatimi vazhdojnë edhe sot në lidhje me përjashtimin, ose reduktimin për kategori të caktuara nga ky tatim. Shpeshherë është kërkuar nga bizneset të përdoren norma të përshkallëzuar, por kjo nuk është pranuar nga qeveria për shkak të problemeve të administrimit dhe edukatës së ulët tatimore të tatimpaguesve. Vitet e fundit si subjekt i TVSH-së u përfshinë edhe librat shkollore kurse në 2011 hyri në fuqi pagesa e tatimit edhe mbi medikamentet mjekësore.
- b. Reforma mbi akcizat është i thjeshtë dhe sipas standardeve ndërkombëtare për aplikimin e akcizës. Të ardhurat e siguruara nga akciza kanë pësuar rritje gjatë periudhës së tre vjetëve të fundit. Gjithashtu është rritur edhe kontributi i saj në të ardhurat tatimore dhe totale (Ministria e Financave (2009) Treguesit e Buxhetit të Konsoliduar). Kjo rritje ka ardhur kryesisht, pasi normat e saj kanë ndryshuar edhe në vitet në vazhdim për t'u përafëruar me ato të Bashkimit Evropian. Rritja e tyre është bërë edhe për të mbuluar uljen e të ardhurave nga taksat doganore, nivelin e zhdoganimeve, korrupsionin, etj.
- c. Reforma e tarifave në linjë me agjendën e liberalizimit të tregtisë në kuadrin e respektimit të marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë dhe angazhimeve me Organizatën Botërore të Tregtisë është bërë reduktimi gradual i tarifave doganore, duke i unifikuar ato edhe me vendet me të cilat janë lidhur marrëveshje. Tarifat doganore kanë ardhur duke u reduktuar nga 35 për qind që kanë qenë në vitin 1997.
- d. Zhvillimi i taksave të përshtatshme të qeverisë vendore në kuadrin e reformës

së decentralizimit, shumë taksa të reja dhe ekzistuese i kaluan për administrim pushtetit lokal, pasi për nga rëndësia në mbledhjen e të ardhurave ishin shumë pak indikativë për pushtetin qendror, kurse për atë lokal një burim i rëndësishëm. Për vitin 2010 të ardhurat nga pushteti vendor përbëjnë vetëm 5 përqind të të ardhurave tatimore. Në vitin

2009 edhe taksa mbi biznesin e vogël u kalua në administrim të pushtetit lokal.

e. Thjeshtëzimi i sistemit tatimor. Reforma në lidhje me normat tatimore janë bërë vazhdimisht për të ulur barrën fiskale dhe për të rritur efikasitetin e sistemit tatimor. Në këtë këndvështrim normat e tatimit mbi fitimin u reduktuan nga 25 përqindja që ishin në

1993 në 10 përqindje në vitin 2008. Gjithashtu tatimi mbi të ardhurat personale i cili ishte progresiv me nivel maksimal 25 përqind në 1993 erdhi duke u reduktuar deri në tatim të sheshtë 10 përqind në 2007. Ndryshimet e bëra në normat tatimore kanë ndikuar në rishpërndarjen e të ardhurave midis grupeve dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë.

f. Implementimi i taksës së sheshtë. Një nga reformat më të diskutuara këto vitet e fundit është vendosja e taksës së sheshtë Hall & Rabushka (1983, 1985)). Qëllimi i kësaj reforme ishte të gjeneronte të ardhura në buxhet nëpërmjet rritjes së bazës së tatueshme, uljes së normës së tatimit, uljen e evazionit dhe lehtësimeve administrative nga pikëpamja e llogaritjes dhe mbledhjes së të ardhurave.

Tatimi i sheshtë zëvendësoi normat progresive të tatimit mbi të ardhurat personale dhe reduktoi në 10 përqind tatimin mbi të ardhurat dhe tatimin mbi fitimin.

Disa nga arsyet pse në vendin tonë u aplikua kjo taksë e sheshtë janë (Keen Michael, Kim Yitae, Varsano Ricardo (2006), The “Flat Tax(es)”: Principles and Evidence, IMF Working Paper, WP/06/218, September):

1. Aplikimi i taksës së sheshtë nga qeveri të reja (rasti i vendit tonë) është përdorur

si një sinjal drejt kalimit në një regjim tatimor më pranë politikave të tregut. Në mjaft raste ky sinjal është pritur mirë.

2. Probleme të mëdha të administrimit, evazionit të lartë dhe korrupsionit kanë ndikuar në vendosjen e taksës së sheshtë, e cila përbën një thjeshtësim duke eliminuar disa forma të arbitrazhit, ose trajtimit të veçantë të kategorive të caktuara. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që pas vendosjes së kësaj takse, sistemi tatimor nuk është më kompleks.
3. Ekzistenca e një strukture tatimore të shkallëzuar dhe me norma të larta tatimore e cila mund të ketë ndikuar më negativisht në administrimin e dobët.

3.2. Politika Fiskale në Shqipëri

Legjislacioni tatimor

Sistemi tatimor në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga një paketë ligjesh, direktivash, udhëzimesh, rregulloresh, marrëveshesh tatimore me vendet e tjera, të cilat paraqesin një përmbledhje të plotë të të gjitha llojeve, niveleve, llogaritjeve, procedurave, si dhe metodave dhe formave të kontrollit tatimor për taksat, tarifatat dhe tatimet që përfshin sistemi tatimor shqiptar.

Legjislacioni tatimor u nënshtrohet mendimeve dhe ndryshimeve të vazhdueshme, për shkak të zhvillimeve të shpejta të ekonomisë.

Llojet e Tatimit

1. Tatimi mbi fitim

Të gjitha kompanitë (të huaja ose jo), që janë të regjistruara në regjistrin tregtar dhe paguajnë TVSH, janë subjekt i tatimit mbi fitimin.

Tatimpaguesit rezidentë i nënshtrohen tatimit vetëm për të ardhurat e gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Një person juridik konsiderohet rezident në Shqipëri, nëse:

1. Ai ka një vendbanim të përhershëm (zyrat qendrore) në Republikën e Shqipërisë;

2. Ai ka një qendër efektive të menaxhimit të biznesit në Republikën e Shqipërisë

Norma e tatimit mbi fitimin është 10 %.

Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe shtojcave të tij, të cilat duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.

Në mënyrë që të përcaktohet fitimi i tatueshëm në Republikën e Shqipërisë, konsiderohen si shpenzime të gjitha shpenzimet e kryera për të planifikuar, mbajtur dhe siguruar fitim, në rastin kur këto shpenzime janë të dokumentuara nga tatimpaguesi, si dhe kur ato u nënshtrohen kufizimeve të specifikuara nga ky ligj.

Dokumentet bazë që përdoren për të justifikuar shpenzimet për efekt tatimor janë: fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe lëshuar në përputhje me udhëzimet e ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor. Norma e tatimit për korporatat do të rritet pak në vitin 2014 krahasuar me normën aktuale.

2. Tatimi mbi vlerën e shtuar në R.SH.

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet:

a) për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të realizuara kundrejt pagesës nga personi i tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) për të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pragu i TVSH-së për regjistrim është 5 milionë lekë (për vitin kalendarik) për xhiron vjetore të biznesit.

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në aktivitetet e eksportit apo importit, janë të detyruar të regjistrohen, në mënyrë që të paguajnë TVSH-në. Çdo subjekt tjetër i tillë si: individët, njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat shoqërore, politike dhe ndërkombëtare, misionet diplomatike etj., të cilat kryejnë

veprimtari import-eksporti, pavarësisht nga xhiroja, janë gjithashtu të detyruara të regjistrohen. Për çdo subjekt që ushtron veprimtarinë e import-eksportit, operacionet doganore do të vazhdojnë pasi ai të dorëzojë origjinalin ose kopje të noterizuar të Certifikatës së Numrit të Identifikimit për Personin e Tatueshëm (NIPT).

Xhiroja e përgjithshme vjetore llogaritet në bazë të çmimit total të paguar nga blerësi dhe përfshin edhe taksat, edhe gjobat.

Deklarimi i TVSH-së dhe formulari i pagesës plotësohen në dy kopje dhe personi i tatueshëm e paraqet atë në bankën përkatëse me të cilën Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka një marrëveshje në lidhje me pranimin e pagesave të TVSH-së, brenda 14 ditëve pas përfundimit të periudhës tatimore.

TVSH-ja zbatohet në masën 20%, me përjashtim të furnizimit të barnave dhe shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, të cilat tatohen me një normë prej 10 për qind.

Veprimet e mëposhtme përjashtohen nga pagesa e TVSH-së:

1. Furnizimi me shërbime financiare;
2. Furnizimi me ari, kartëmonedha apo monedha të Bankës së Shqipërisë;
3. Furnizimi me pulla postare, të cilat përdoren për shërbimin e postës ose pulla të ngjashme;
4. Furnizimi me kusht nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt një pagese të reduktuar konsiderohet një furnizim i përjashtuar në kushtet e përcaktuara në nenin 24;
5. Furnizimi i tokës dhe marrja me qira e saj është furnizim i përjashtuar, përveçse kur toka përdoret për parkim apo si garazh për automjetet dhe mjetet e tjera të lëvizshme;
6. Furnizimi i ndërtesave, përveç procesit të ndërtimit;
7. Dhënia me qira e ndërtesave është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve:

- a) kur periudha e qiradhënies nuk i kalon dy muaj;
- b) të strehimit në hotele ose vende pushimi;
8. Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet e arsimit publik dhe privat, në bazë të rregulloreve të veçanta;
9. Ministri i Financave përcakton udhëzimet për përjashtimin e furnizimit të misionëve diplomatike dhe konsullore dhe personelit të tyre mbi bazën e reciprocitetit dhe përjashtimin e furnizimit të organizatave ndërkombëtare mbi bazën e marrëveshjeve. Vlera e tatueshme e furnizimit është shuma totale e paguar për atë furnizim, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe nga ligji nr. 7928, datë 1995/04/24.(Ligji nr. 7928, :1995)

Tatimi i mbajtur në burim në Republikën e Shqipërisë

Të gjithë rezidentët në Republikën e Shqipërisë, njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10% nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, të gjeneruara nga një burim në Republikën e Shqipërisë.

Tabela nr.3

Tatimi i mbajtur në burim në R. Shqipërisë

Interesat	10%
Pjesa e fitimit	10%
Tarifa për shërbimet teknike, të menaxhimit dhe ato financiare etj.	10%
Tarifa për qira	10%
Dividend	10%
Pagesa për të drejtën e Autorit	10%

Burimi: Drejtoria e Tatimeve Tirane

A. Baza e tatueshme

Të ardhurat e tatueshme janë të fiksuara në bazë të bilancit dhe shtojcave të tij, të cilat duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave. Fitimet ose të ardhurat e tjera neto janë të barabarta me diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të

zbritshme. Viti tatimor përkon me vitin kalendarik dhe fillon që nga data 1 janar e përfundon më 31 dhjetor.

B. Shpenzimet e Zbritshme

Ashtu si në vendet e tjera të rajonit, shpenzimet që zbriten nga taksat, janë ato që prodhojnë të ardhura, që sigurojnë dhe ruajnë të ardhurat e tatueshme. Shpenzimet janë të zbritshëm, në qoftë se:

- Rezultojnë nga aktivitetet ekonomike që prodhojnë të ardhura, ose në qoftë se ato janë të lidhura me menaxhimin e zakonshëm të aktivitetit të biznesit të tatimpaguesit;
- Ofrohen dokumente të mjaftueshme, të cilat konfirmojnë destinacionin e këtyre shpenzimeve;
- Pasqyrohen në librin e llogarive duke ulur asetet neto.

3. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të gjithë individët rezidentë në Shqipëri u nënshtrohen tatimeve për të gjitha të ardhurat e prodhuara kudo në botë, ndërsa jo-rezidentët janë subjekt i tatimeve vetëm për të ardhurat e prodhuara brenda kufijve të territorit shqiptar.

Reformimi i këtij lloj tatimi që konsiston me tatimin e paragjykuar apo edhe tatimin mbi të ardhurat personale në kufijtë e të ardhurave të përcaktuara për biznesin e vogël, na dërgon në tri drejtime:

- a) inkurajimin i formalizimit
- b) rritjen ekonomike të biznesit të vogël;
- c) lehtësirat tatimore

Megjithatë, reformimi i sistemit tatimor për bizneset e vogla është i komplikuar dhe ende nuk ka ndonjë praktike që njihet si më e mira dhe që i ka zgjidhur të gjitha çështjet dhe zbatimin i një sistemi tatimor të thjeshtë, të administrueshëm dhe me trajtim të paanshëm të tatimpaguesve.

Kur merret në konsideratë tatimi mbi biznesin e vogël për vendet në tranzicion vetëm nga perspektiva e të ardhurave, shpesh, potenciali i tij shihet në kuadër të përfitimit të një baze më të gjerë tatimore, e cila në një periudhë afatmesme deri afatgjatë, nuk mund të ketë të ngjarë të kompensojë kostot e larta të administrimit të tatimpaguesve të biznesit të vogël. Një sistem i mirë tatimor për biznesin e vogël është mjeti kyç i politikës tatimore për t'i hapur rrugën daljes nga "kurthi i in formalitetit" dhe rritjes së ulët ekonomike, së drejtës së kufizuar të hyrjes në tregje dhe përjashtimit nga shërbimet financiare. Sektori formal i biznesit të vogël çon përpara marrëdhëniet reciproke ndërmjet shtetit dhe pjesës më të madhe të qytetarëve të tij, të përfshirë në veprimtari ekonomike të shkallës së vogël.

Prandaj, kur bëhet fjalë për zgjedhjen ndërmjet sistemit tatimor progresiv dhe atij të thjeshtë, ekspertët argumentojnë me fakte se të tatuarit progresiv, në mënyrë të natyrshme, i dekurajon njerëzit nga të punuarit më fort dhe nga të qenit më të suksesshëm, për arsye se me anë të shkallëzimit progresiv të tatimit, përfitimet monetare shtesë do të pakësohen nga një barrë tatimore më e lartë dhe në njëfarë pike njerëzit vijnë në përfundimin se të bësh më shumë para nuk ka vlerë për arsye të përqindjeve më të larta tatimore.

Të Ardhurat e Tatueshme për TVSH-në

Kushtet e reformës tatimore dhe niveli i avansimit të sistemit tatimor, respektivisht organit tatimor imponojnë edhe mundësinë e administrimit të plotë dhe efektiv të të gjitha të ardhurave tatimore. Në këto kushte në Shqipëri dhe rajon ende nuk ekzistojnë të gjitha kapacitetet për administrimin efikas të të gjitha të ardhurave për qëllime të Tatimit mbi vlerën e shtuar që është një tatim indirekt dhe i llogaritshëm në konsum.

Prandaj politika fiskale dhe organet tatimore janë orientuar në vendosjen e kushteve nën të cilat një biznes do jetë subjekt i tatimit për qëllim të TVSH-së . Kjo do të thotë se ekziston një nivel i të ardhurave mbi të cilën biznesi arrin pragun për tu tatuar me Tatimin e vlerës së shtuar. Këto janë vendime të politikës fiskale dhe administrative për

menaxhimin më të lehtë të këtij lloj tatimi. Megjithatë është e njohur se edhe bizneset e vogla të cilat drejtë për së drejti do ta paguajnë këtë lloj tatimi do jenë të ngarkuara me shpenzime indirekte për zbatimin e kësaj rregulle. Kjo krijon një shpenzim shtesë deri te humbjet eventuale për bizneset e vogla . Humbja e të ardhurave si pasojë e mbledhjes së TVSH-së, ashtu sikundër raportohet nga studimet e FMN-së, në pjesën më të madhe të vendeve, ka qenë jo domethënëse që nga ajo kohë që tatimpaguesit e vegjël kanë kontribuar minimalisht për sistemin e TVSH-së; thjeshtëzimi i taksës për biznesin e vogël dhe sistemit të TVSH-së, do të gjeneronin të ardhura shtesë për qeverinë, që nga ajo kohë që, historikisht, do të rritej zbatimi i legjislacionit tatimor.

Ekonomia jo formale dhe evazoni janë ende prezente dhe kërkojnë zgjidhje.

Ekonomia në hije, vë në dukje profesor Friedrich Schneider i Universitetit të Linz-it në Austri, po rritet në mënyrë dramatike në të gjitha vendet e Evropës (përfshirë këtu faktin që kjo dukuri shihet edhe në vendet e OECD-së), prandaj për të kuptuar këtë prirje, është e domosdoshme të shihen ndërlikimet e saj shoqërore dhe politike; një dukuri e tillë simbolizon revoltën e njerëzve kundrejt ndërhyrjes së qeverisë në jetët e tyre, gjë që, në pjesën më të madhe, bazohet në barrën e madhe tatimore që është vendosur mbi shpatullat e tyre, e cila gjatë viteve është bërë kaq e rëndë sa që njerëzit gjithnjë e më shumë kanë ndjenjën reale të të qenët të rënduar dhe kufizuar. Kjo dukuri të çon në një rreth vicioz, për arsye se baza për një vlerësim të vërtetë të kontributeve tatimore të individëve fillon të rëndohet gjithnjë e më shumë për aq sa njerëzit e fitojnë jetesën e tyre në ekonominë në hije.

Si rezultat, tatimet rriten për ata që mbeten në sistem, me qëllim që të balancojnë humbjen e të ardhurave, për arsye se këto shëtitje tatimore ndezin madje një tërheqje të mëtejshme drejt ekonomisë në hije dhe, në një skenar ekstrem, ky proces grumbullues mund të çojë në krizë akute qeveritare dhe financiare (gjë që u pa me rastin e Greqisë dhe Italisë, etj).

Rritja e madhësisë së ekonomisë në hije (dhe për pasojë rritja korresponduese e evazionit tatimor) mund të shihet si një kundërveprim gjithnjë e më shumë i qytetarëve për përshkallëzimin e shkapërderdhjes së shtetit në shpenzimin e të ardhurave tatimore dhe kjo prirje mund të paraqitet si një lloj “demokratizimi” i kundërshtimit të gjatë, për të mos paguar tatime; më saktë duhet që politikanët kurajozë të ecin përpara për këto sfida për të vendosur masa shumë të nevojshme për të luftuar influencën e rritur të ekonomisë në hije. Në dritën e këtyre vlerësimeve, duket se shtrëngimi i kontrolleve dhe sanksioneve për të kontrolluar veprimtaritë e paligjshme është një sukses vetëm i një natyre të kufizuar dhe një gjë e tillë është e vërtetë për arsye se një shtrëngim i tillë do të inkurajonte përpjekjet e tyre të mundimshme për të gjetur mënyra të reja për t’iu shmangur legjislacionit tatimor.

Përveç rënies së të ardhurave tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, rritja e veprimtarive në ekonominë në hije, nxjerr në dritë, gjithashtu, probleme të tjera dhe një prej tyre është statistika ekonomike që keq paraqet gjendjen aktuale të ekonomisë dhe, që hap pas hapi, rezulton në mbivlerësimin e të dhënave në lidhje me rritjen ekonomike dhe punësimin; kështu politikat fiskale që nxisin shmangien dhe evazionin tatimor, të çojnë në rrugë të shtrembër, si rezultat i informacionit të gabuar dhe problemi që mbetet është nëse ndëshkimet më të ashpra dhe kufizimet më të forta mund ta zvogëlojnë me të vërtetë veprimtarinë në ekonominë në hije. Është e dukshme se ekzistenca e ekonomisë në hije përfaqëson një sfidë të rëndë ekonomike dhe politiko-shoqërore dhe suksesi do të arrihej vetëm atëherë kur investigimi i shkaqeve – rrënjë të ekonomisë në hije, vërteton se janë: barra e rritur tatimore si dhe rregullat dhe praktikatat e gjëra të legjislacionit tatimor. Burimi: Vasquez (2001)

3.3. Sistemi Tatimor në Kroaci

Në kuadër të hulumtimeve për praktikatat më të mira në rajon kemi përzgjedhur për të rishikuar edhe sistemin tatimor në Kroaci, si një vend i cili ka përvojë të gjatë në krijimin

e buxhetit të konsoliduar. Njëherësh shteti Kroat tanimë është pjesë e bashkimit evropian dhe ka kaluar sfidat dhe kriteret për bashkimin në familjen e madhe evropiane.

Në vazhdim do paraqesim zhvillimet e sistemit tatimor, llojet e tatimeve, shkallët tatimore dhe definicionet kryesore, Porezna Uprava Hrvatske (2015).

Llojet kryesore të tatimeve

1. Tatimet shtetërore
2. Tatimet e bashkisë
3. Tatimet komunale apo të qyteteve
4. Tatimet e përbashkëta
5. Tatimet dhe kompensimet nga lojërat e fatit.

Në kuadër të tatimeve shtetërore ose qendrore hyjnë

- a) Tatimi në Fitim tatimi
- b) Tatimi në anije ngarkesë sipas tonazhës c) Tatimi në vlerën e shtuar dhe
- d) Akcizat dhe tatimet e veçanta

Tatimet tjera

- Tatimit mbi të ardhurat
- Tatimi mbi titullin e korporatave
- Taksat mbi konsumin
- Tatimi në lojërat me makina
- Tatimi mbi automjetet motorike
- Tatimi në anije
- Tatimi mbi pasuri të patundshme
- Tatimi mbi trashëgimi dhe dhurata

1. Tatimi Mbi të Ardhurat Personale

Në vijim do paraqesim zhvillimet e sistemit tatimor Kroat, sipas llojeve të tatimit karakteristikat kryesore definicionet dhe shkallët tatimore sipas ligjeve në fuqi. Obligu-

esit tatimor në të ardhurat e tatueshme personale, Porezna Uprava Hrvatske (2015).

1. Një kompani dhe persona tjerë juridik dhe fizik rezident në Republikën e Kroacisë që ushtron aktivitet ekonomik në mënyrë të pavarur dhe të vazhdueshme për të fituar të ardhura ose përfitime të tjera matshme ekonomike,
2. Kompani (seli) ose njësi e biznesit të sipërmarrësve të huaj (jo-rezident),
3. Personi fizik i cili realizon të ardhura me rregulloret e tatimit mbi të ardhurat, dhe ka vendosur të paguajë tatim mbi fitimin në vend të tatimit mbi të ardhurat,
4. Personi fizik i cili realizon të ardhura nga një zeje aktivitetet me kusht që në periudhën tatimore paraprake, të hyrat e përgjithshme ishin më të madha sesa 2,000,000.00 HRK, ose në qoftë se të ardhurat periudhës se mëparshëm ka paguar taksë më të lartë se 400,000.00 Kuna, ose nëse ka asete fikse me vlerë më shumë se 2,000,000.00 HRK, ose në qoftë se në periudhën e kaluar tatimore ka pas më shumë se 15punëtorë,
5. Përjashtimisht, organet e pushtetit, organet e qeverive lokale (rajonale), organet e qeverisë lokale, Banka Kombëtare Kroate, agjencitë qeveritare, institucionet e njësive lokale, qeveritë (rajonale), institucionet e vetëqeverisjes lokale, institutet kombëtare, bashkësitë fetare, partitë politike, sindikatat, odat, shoqatat, shoqatat e artit, zjarrfikësve vullnetar, kulturë teknike, bordet turistike, klube sportive, shoqata sportive dhe federatave, fondacionet dhe trustet në qoftë se keni kryer veprimtari ekonomike, nëse mos tatimimi i atij aktiviteti do të çonte tek privilegjet e pajustificuara në treg,
6. Çdo sipërmarrës i cili nuk është përmendur në pikat 1 deri 5 dhe nuk është i detyruar të paguaj tatim mbi të ardhurat në përputhje me rregulloret për tatimet dhe të cilit nuk tatohen gjetkë.

Shkallët tatimore për tatimin mbi të ardhurat personale:

- Tatimi mbi të ardhurat.....20%

- Tatimi i mbajtur në burim shkalla mbi dividendët dhe aksionet e fitimit.....	12%
- Të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale	15%
auditimet për biznesin	15%
- Shërbimet e paguara për personat e huaj,.....	15%
- Tatimi mbi interes.....	20%
- Tatimi për të gjitha llojet e shërbimeve që janë të paguara për personat që kanë zyrat e tyre të regjistruara ose vendin e veprimit efektiv ,administrata, mbikëqyrjen e operacioneve, në vende të tjera se sa vendet anëtare të BE, në të cilat është shkalla e përgjithshme ose mesatare nominale e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është më e ulët se.....	12,5%

Tarifat e tatimit mbi honorarët, interesin, dividendëve dhe përqindje në fitim në marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë që Republikën e Kroacisë janë të lidhura me vende të tjera.

2.Tatimi ne të Ardhurat për Tonazhe të Anijeve

Të ardhurat për tonazhin e anijes është taksë e cila paguhet prej i 1 janar 2013, dhe e njëjta do të përcaktohet dhe paguhet në vend të tatimit mbi të ardhurat.

Sistemi tatimor për llojin e tatimit në Bazë të tonazhit të përshkruara me kodet detare i referohet periudhës dhjetor 2013 për të filluar në janar 2014 dhe zakonisht dorëzohet për aprovim gjashtë muaj më parë në Ministrinë e Çështjeve Detare, Transportit dhe Infrastrukturës Porezna Uprava Hrvatske (2015).

Në flotën e anijeve pjesëmarrëse në sistemin tatimor të anijeve të tonazhit të paktën 40% e totalit tonazhit neto e anijeve duhet të jenë anijet vendase të Kroacisë, ose disa prej vendeve anëtare të BE.

Taksapagues sipas këtyre normave do të jenë personat juridik të themeluar në Republikën e Kroacisë, ose që vendin e menaxhimit efektiv dhe menaxhimin e operacioneve e kanë në Republikën e Kroacisë, dhe nëse i plotëson kushtet e përcaktuara sipas ligjeve detare me kusht që të deklarojnë taksat e tyre mbi të ardhurat e paguara në lidhje me fiti-

min e tyre të realizuar në bazë të tonazheve të anijeve për:

- a) aktivitetet ekonomike të anijeve në pronësi të tij, anijet e dhënë me qira b) ofrimin e shërbimeve për menaxherët e anijes
- c) nga shitja e anijeve të regjistruara në sistemin e taksave në aspektin e tonazhit dhe pajisjet e tyre, shitjet e aksioneve në kompanitë e anijeve, si dhe dividendët nga aksionet apo rezervat që kanë kompanitë e anijeve tregtare në vend dhe jashtë vendit që aksionarët shumicë, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike e në bazë të tonazhit neto të

3. Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH)

Cilët janë obliguesit tatimor të cilët i nënshtrohen këtij lloji tatimi në Kroaci.

1. Çdo person i cili në mënyrë të pavarur kryen ndonjë veprimtari ekonomike, pavarësisht qëllimit dhe rezultati i këtij aktiviteti ekonomik përfshinë çdo aktivitet të prodhuesve, tregtarëve ose personave të angazhuar për shërbime, duke përfshirë aktivitetet dhe veprimtaritë individuale minerare dhe bujqësore e profesionale.

Aktiviteti ekonomik është konsideruar të jetë shfrytëzimi i pasurisë së prekshme ose të paprekshme me qëllim të realizimit të përhershëm të të ardhurave.

2000 nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut. i quajtur si Autoriteti Qendror Fiskal i Kosovës AQF nën udhëheqjen fillestare të stafit ndërkombëtar të një eksperti ndërkombëtar i punësuar nga një kontraktues i USAID-it. Nga Tetori i vitit 2001 deri në Shkurt të vitit 2003, kishte bashkë drejtues nga USAID-i dhe një vendor që ndanin rolin e drejtorit. Në vitin 2003, autoriteti për administratën tatimore u bart nga UNMIK-u te Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe kosovarët morën detyrat udhëheqëse në një institucion mjaft relevant që tani e tutje do të quhej Administrata Tatimore e Kosovës - ATK. ATK ka funksionuar si një organizatë autonome, e menaxhuar krejtësisht nga banorë të Kosovës me këshillime dhe ndihmën e organizatave donatore ndërkombëtare në radhë të parë, USAID-i, Shtylla IV e BE-së, dhe CAFAO-UNMIK e BE-së.

Të Hyrat nga Doganat

Gjithashtu një pjesë dominante e të hyrave buxhetore mbledhet në pikat kufitare nga doganat e Kosovës në rastin e importimit të mallrave nga bota e jashtme. Të hyrat nga doganat përfshijnë taksen doganore në normën 10 % akcizën në produkte ekskluzive dhe pjesën e të hyrave publike, ka të bëjë sidomos me tatimin e vlerës së shtuar i cili sipas rregullave ligjore në fuqi i paguhet shtetit me rastin e blerjes së mallrave për tu kthyer në masën pas shitjes së mallrave në vend .

Vlen të theksohet se kjo pjesë e të hyrave (TVSH në kufti) është mjaft e konsiderueshme dhe përbën diku 45% të të hyrave të përgjithshme buxhetore. Kjo metodologji e mbledhjes së tatimit është kritikuar si nga kritikët shkencor po ashtu edhe analistët e fushës ekonomike prandaj parashihet që në një të ardhme të afërt ky grumbullim i tatimit të vlerës së shtuar të bëhet si tatim i brendshëm dhe duhet të mbledhet nga Administrata tatimore dhe atë me rastin e konsumit respektivisht shitjes së mallrave. Mirëpo autoriteti kryesor i mbledhjes së tatimeve si e hyrë publike në Kosovë mbetet Administrata tatimore e Kosovës të cilës edhe i bie përgjegjësia për përmbushjen tatimore .

4.2. Tatimet në Kosovë

Gjatë historikut të shkurtër të saj, ATK-ja ka bërë përpjekje për të ndërtuar një strukturë organizative funksionale e cila në pjesën më të madhe të saj është në pajtim me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Ka një qendër përpunimi të dokumenteve të centralizuara përmes të cilës përpunohen të gjitha deklaratat. Po ashtu vitet e fundit (2014) është aplikuar deklarimi on-line përmes internetit dhe tatimpaguesit për disa nga llojet e tatimeve (*TAP dhe TMB) ku tatimpaguesit deklarojnë tatimet e tyre nga zyra apo nga shtëpia derisa pagesat bëhen në banka. Është krijuar edhe një njësi për tatimpaguesit e mëdhenj që merret me tatimpaguesit më të mëdhenj në Kosovë, që njëheris është praktika më e mirë ndërkombëtare.

Legjislacioni tatimor i Kosovës është pranuar si nga FMN-ja ashtu edhe nga Komi-

sioni Evropian si legjislacion transparent dhe në nivel të mirë ndërkombëtar. Legjislacioni i TVSH-së në masë të madhe i përmbush kërkesat e Direktivës së Gjashtë të BE-së.

ATK dhe Tatimpaguesit

Me edukimin e tatimpaguesve në terminologjinë e re të sistemit tatimor nënkuptojmë informimin e tyre dhe ofrimin e shërbimeve për tatimpaguesit në mënyrë që ata t'a kenë më lehtë dhe më afër mundësinë për pagimin e tatimeve dhe obligimeve tjera ligjore ndaj shtetit. Sfidë e veçantë dhe e vështirë ka qenë qysh në fillim ky segment i strukturës organizative tatimore kur dihet se menjëherë pas përfundimit të luftës, Kosova u gjend në një situatë pa kushte ekonomike, pa kushte teknike të operimit, pa sistem medial etj. Një problem i theksuar në këtë fushë ishte edhe ndryshimi në aspektin pozitiv të mentalitetit për pagimin e tatimeve duke u bazuar në përvojën shumë të hidhur të pagesës së tatimeve enorme me kamata e gjoba të pa përballueshme në kohën e regjimit të kaluar.

Aktivitetet e kryera në zyrat e shërbimit të tatimpaguesve, janë të rolit të informimit të tatimpaguesve lidhur me obligimet ligjore për pagimin e tatimit dhe janë të përqendruara në:

- përpilimi i raporteve të konsoliduar të zyrave të shërbimit të tatimpaguesve në terren, si dhe përgjigjet përmes korrespondencave të drejtpërdrejta përmes email adresës, pyetjeve e kontakteve të drejtpërdrejta me tatimpaguesit paraqesin punën e këtij shërbimi të veçantë ndaj tatimpaguesit.

- Shërbimi i tatimpaguesve është i formuar për të punuar në dizajnimin e formave të ndryshme tatimore (Përpilimin e formave të reja si dhe Modifikimin e formave ekzistuese), azhurnimin e web Faqes së MFE-se, dhe ATK-së. (modifikim i materialeve ekzistuese dhe vendosja e materialeve të reja, dhënien e komunikatave të ndryshme për shtyp, intervista për shtyp, dhe media elektronike, emisione informative rreth të drejtave dhe obligimeve të tatimpaguesve.

- Përpilimin dhe modifikimin e deklaratave përfundimtare të tatimeve si tatimit

në të Ardhurat e Korporatave, dhe Tatimit në të Ardhurat Personale si dhe përpilimi i deklaratave tatimore dhe udhëzimet për plotësimin e tyre për personat që kanë monopol në tregun Kosovar. Gjithashtu ky shërbim ka për obligim për të përpiluar dhe modifikuar vërtetime të ndryshme të cilët shërbejnë për dëshmi të ndryshme për tatimpaguesit .

- Përpilimin dhe modifikimet e Doracakut periodik të Shërbimit të Tatimpaguesve ku përfshihen rekomandimet e autoriteteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, mbajtja e seminareve me tatimpaguesit në nivel te zyrave regjionale me tema të ndryshme aktuale të ndryshimeve ligjore apo reformat fiskale. Seminare për mënyrën e përpilimit të llogarive përfundimtare të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave dhe Tatimit në të Ardhurat Personale. Organizohen po ashtu seminare me njësitë buxhetore të Ministrive, Drejtorive komunale, dhe njësive buxhetore të Agjencioneve të ndryshme, me tema kontributet pensionale dhe tatimit në paga. Qëllimi i organizimit të këtyre seminareve qëndron në :

- dhënia e informacioneve zyrtarëve financiarë të njësive buxhetore për rritjen e efikasitetit gjatë mbajtjes së kontributeve dhe tatimeve në burim dhe zvogëlimit të gabimeve të mundshme me rastin e procedimit të formave për pagesën e tatimeve dhe kontributeve pensionale

- Po ashtu përmes spoteve televizive praktikohet për të përkujtuar tatimpaguesit për kryerjen e obligimeve tatimore dhe janë dhënë sqarime rreth mënyrës së kryerjes së obligimeve tatimore të tyre.

- Përmes këtyre seminareve gjithashtu është shqyrtuar mundësia për krijimin e metodave më të përshtatshme informative (materiali informativ për tatimpaguesit, me theks të veçante rreth mbledhjes me forcë), Në këto takime përpiqet të realizohen takime pune me gazetarë të mediave të ndryshme dhe pjesë të shoqërisë civile për të dhënë informacione për sistemin tatimor në Kosovë, informacione të ndryshme rreth tatimeve , të drejtat dhe obligimet e tatimpaguesve.

Zhvillimi i fushatës me qëllim të njoftimit dhe përkujtimit të tatimpaguesve me afatin e pagesës së tatimeve për periudhën tatimore. Kjo kampanjë zhvillohet përmes mediave të shkruara dhe elektronike.

Shumica e informacioneve për tatimpaguesit epet përmes zyrës së shërbimit të ATK-së nëpër sportelet e bankave etj.

Objektivi themelor për fushën e edukimit është arritur pjesërisht duke informuar tatimpaguesit kontaktues dhe aktiv me legjislacionin tatimor dhe metodën më të lehtë të pagesës së tatimit .

Në të ardhmen pritet për avancimin e mëtutjeshëm për kryerjen e synimeve që ka ky departament për dhënien e shërbimeve sa më efikase për tatimpaguesit, me përkrahjen e institucioneve dhe të Departamenteve tjera relevante në fushën e tatimeve.

4.3. Legjislacioni i Sistemit Tatimor

Në Kosovë fillim i sistemit tatimor mund të konsiderohet viti 2000 si Autoritet Qendror Fiskal i Kosovës kur edhe u instalua një pjesë e demokracisë politike dhe ekonomike. Si edhe sferat tjera të shoqërisë po ashtu edhe legjislacioni tatimor administrohej me rregullore të lëshuar nga organizata ndërkombëtare të kombeve të bashkuara UNMIK-u sipas rregullores PSSP ⁴

Ligjet e para për tatimet pasojnë në vitin 2000 dhe atë për Tatimin në qarkullim pra shërbime në hotele dhe restorante.⁵ Si dhe Rregullorja e tatimit të paragjykuar me aplikim nga korriku i vitit 2000 ⁶ mandej rregullorja e tatimit në vlerën e shtuar prej korrikut të vitit 2001/19. Ligji mbi administrimin e tatimeve dhe procedurave tatimore arrin në funksion tek në vitin 2004 me rregulloren 2004/48

Një ndryshim në të mirë dhe funksional të këtij legjislacioni arrihet në fillim të vitit 2005 me reduktimin e ligjeve tatimore nga tatimi i paragjykuar në tatimin në të

4. Rregullorja e UNMIK-ut nr 1999/16 Prishtinë

5. Rregullorja e UNMIK-ut nr 2000/5 Prishtinë

6. Rregullorja e UNMIK-ut nr 2000/29 Prishtinë

ardhurat personale dhe tatimin në Korporata. Gjithashtu ndryshimi i kohëpaskohshëm i Ligjit mbi tatimin e vlerës së shtuar ka bërë që të perfeksionohet funksionimi i sistemit tatimor në Kosovë.

Në vitin 2000 është filluar me aplikimin e dy lloj tatimeve fillestare tatimin në shërbime hoteliere me një normë 10 % qarkullimin e tyre, si tatim i paguar mbi qarkullimin total të tyre dhe tatimin e ashtuquajtur të paragjykuar. Të hyrat e grumbulluara nga këto tatime në vitin 2000 ishin gati simbolike deri 5.7 mil. euro dhe atë me një staf minimal prej një stafi prej 40 vetave.

Në vitin 2001 me rritjen njëqind përqind të stafit dhe rritjen e numrit të tatimpaguesve arrihet një rritje e madhe e pjesëmarrjes së tatimeve vendore në buxhetin e Kosovës prej

42 milion euro .

Viti 2002 krijon të hyra të dyfishta nga viti i kaluar dhe arrin vlerën deri në 80.1 milionë euro me resurset njerëzore të shtuara për dyqind përqind -235 veta.

Në vitin 2003 krijohen 105 milion të hyra duke u shtuar gjithnjë e më shumë numri i tatimpaguesve të rregullt nga deklaratimet vullnetare.

Viti 2004 rrit nivelin e realizimit të të ardhurave nga tatimet në shkallë 12 % që është konform rritjes së numrit të tatimpaguesve dhe deklaratimeve ashtu që në vitin 2005 të arrihet grumbullimi i mbi 130 milionë euro-ve .

Në vitet vijuese 2006 dhe 2007 kemi rritje të të hyrave prej 30 % (168mil) respektivisht 13% (190 mil) që tregon një stabilizim të trendëve të rritjes dhe krijimit të një të hyre standarde e të qëndrueshme për buxhetin e Kosovës.

Duke qenë një staf tashmë me ndryshime të vogla në numër por duke ngritur cilësinë dhe performancën, me plotësimet në legjislacionin tatimor dhe me masat tjera fiskale arrihet që në vitet 2008 të kemi edhe me tutje rritje të kësaj kategorie të të hyrave, tatimi, në masën 18% (224mil).

Karakteristikë e vitit 2009 është zvogëlimi i vlerës së tatimit si e ardhur kryesore për buxhetin e Kosovës si rrjedhojë e masave fiskale të qeverisë e cila zvogëlon shkallët tatimore të tatimit në fitim e në të ardhura personale dhe shumën e tatimeve të mbledhura ulet në shkallën 7% (206.6mil)

Kjo tabelë tregon kronologjinë e të ardhurave nga tatimet të mbledhura nga administrata tatimore e Kosovës sipas viteve , bizneseve që kanë deklaruar stafin e angazhuar, shpenzimet etj.

Kjo njëherazi e tregon masën e përmbushjes tatimore por të pakrahasueshme me planin. Mirëpo kur të njëjtën e krahasojmë me planin e administratës për këtë, na del për shembull se vetëm në vitin 2007, të hyrat i kanë tejkaluar parashikimet për 32%. Të hyrat vjetore vazhdimisht kanë treguar një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e mëparshme, edhe në një ekonomi të një shkalle relativisht të ulët të zhvillimit.

4.4 Sistemi Tatimor Kosovar Përballë Sistemit Evropian.

Administrata tatimore ka kryer me sukses një vlerësim të përmbushjes së standardeve të BE-së e cila ka identifikuar fushat në të cilat ekzistojnë zbrazëtirat në mes praktikave të ATK-së dhe praktikës së mirë së BE-së. Po ashtu edhe ekipe ndihmëse teknike nga FMN-ja kanë kryer një shqyrtim dhe vlerësim të ATK-së. Raporti i tyre zakonisht ka dhënë një numër të rekomandimeve të caktuara për përmirësimin e praktikave të administratës tonë tatimore, për të cilat administrata përkushtohet maksimalisht t'i përmbush me sukses.

Në Kosovë politika fiskale konsiderohet më fleksibile në krahasim me vendet e BE-së duke përjashtuar masat shtetërore me shtrënguese të përfshira në sistem ndaj botës së biznesit.

Fillimisht norma tatimore për TVSH në Kosovë ishte 15% për tu ngritur tek në vitin 2009 në 16% , dhe ndryshuara në vitin 2015 në 18 %. Shkalla e tatimit në fitim dhe korporata ishte max 20% për tu zvogëluar në vitin 2009 në 10%. Shkallët tjera tatimore

janë grupuar sipas realizimit të fitimeve në tri kategori. Në vendet e rajonit kemi këto norma të tatimeve si për shembull në Bullgari normat e tatimeve indirekte sillen deri në 53% ndërsa tatimet direkte deri në 18% të të hyrave.

Në Hungari kemi shkallën e tatimit të vlerës së shtuar 25% derisa tatimet në të ardhurat përfshijnë shkallën deri 10% .

Në Rumani kemi një shkallë mjaft të lartë të tatimi i vlerës së shtuar që madje është e dyta në BE që arrin në 29% derisa shkalla e tatimit në fitim është 16%.

Në Slloveni normat tatimore për tatimin në fitim kanë një përfshirje të gjerë dhe arrin deri në normën 27% derisa tatimi i vlerës së shtuar ka shkallën 20%..

Vendet fqinje po ashtu kanë dallime në politika fiskale por megjithatë kemi një përafrim të situatave të njëjta. Në Malin e Zi p.sh kemi po ashtu tatimin në fitim sipas grupimit të fitimeve prej 0 deri në 20% derisa tatimi i vlerës së shtuar aplikohet me dy norma standarde 17% dhe 7% si dhe 0% .

Në Serbi ekziston një sistem tatimor me norma më të ulëta tatimore legale si metodë për tërheqjen e investitorëve të huaj. Norma e tatimit në të ardhurat personale arrin deri në 12% derisa tatimi në vlerën e shtuar po ashtu ka tri shkallë tatimore 18% , 8% dhe 0% duke kategorizuar mallrat dhe shërbimet sipas listës së mallrave.

Në Maqedoni normat e tatimit në të ardhurat personale po ashtu kanë filluar të zvogëlohen dhe atë në shkallët 15% deri në 24% derisa për investitorët e huaj shkalla tatimore është 0% Përqindja e tatimit në vlerën e shtuar është 18% dhe ajo preferenciale 5%. Për Kosovën është karakteristikë se ka aplikuar rregullat dhe ligjet më të avancuara sipas rregullores së BE-së dhe të njëjtat është duke i aplikuar me vendosmëri.

4.5. Synimet e Sistemit Tatimor në Kosovë

Politika fiskale në sistemin tatimor të Kosovës është e orientuar për hartimin e rregullave tatimore të cilat mundësojnë më me lehtësi mbushjen e buxhetit të Kosovës duke shpenzuar një kosto sa më të vogël. Mirëpo një ndër synimet permanente të admin-

istrimit tatimor është ruajtja e kredibilitetit të saj në raport me tatimpaguesin dhe publikun si faktori themelor.

Këto synime janë të vazhdueshme mirëpo edhe ndryshojnë varësisht prej periudhave dhe ndryshimeve të faktorëve tjerë të sistemit. Në vazhdim do paraqesim disa nga synimet aktuale të sistemit tatimor në Kosovë:

1. Të formojë dhe mirëmbajë një imazh pozitiv për të mirën e Kosovës
2. Të respektohet nga klientët tanë dhe të njihet nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare
3. Angazhimi në punë me personel, profesionist dhe energjik që do të garantojnë një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimin e shërbimeve në raport me klientët, përmes të cilës do të bëhet burimi kryesor i të ardhurave për Kosovën.

Qëllimi dhe Misioni

Edhe misioni i administratës tatimore të Kosovës është mjaft domethënës dhe lidhet me vetë qëllimin e formimit të këtij institucioni i cili është ndër institucionet financiare ekzekutive dhe apolitike në shtetin e ri të Kosovës. Ky institucion gjithashtu ka misionin për të cilin është formuar, duke reformuar pikat kyqe të qëllimeve sipas trendëve dhe kërkesave agregate .

Ndër misionet aktuale të administratës tatimore janë:

- Norma e përmbushjes vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore;
- shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve; dhe
- zbatimit të drejtë dhe të njëllojshëm si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të ardhura për buxhetin e qeverisë në një mënyrë efikase dhe me kosto të ulët.

4.6. Kuptimi dhe Rëndësia Ekonomike e Tatimit.

Tatimet dhe kontributet paraqesin të hyra shumë të rëndësishme publike të shtetit, të cilat mblidhen nga të ardhurat apo pjesa e pasurisë të qytetarëve dhe personave juridikë të cilët obligohen t'i paguajnë ato. Të gjithë qytetarët e një vendi kanë përgjegjësi morale dhe ligjore për pagimin e tatimeve në dobi të interesit të përgjithshëm. Përgjegjësia ligjore e shtetasve siç është theksuar edhe më herët, buron nga akti më i lartë juridik i një vendi. Obligimin ligjor të pagimit të tatimeve e përcakton kushtetuta e vendit. Ndërsa ajo morale konsiston në faktin se nëpërmjet kësaj qytetarët i kontribuojnë shoqërisë dhe përmirësimit të jetës së tyre. Vendi dhe roli i tatimeve prej fillimit të aplikimit të tyre e deri me sot u janë nënshtruar shumë ndryshimeve, sepse me anë të tatimeve janë manifestuar transformimet që janë bërë në sistemin shoqëror- ekonomik dhe politik në një vend⁷ Jelçiq (1985)

Veprimtaria financiare dhe funksionimi normal i shtetit varet kryekëput nga buxheti i shtetit. Ky buxhet kryesisht përbëhet nga tatimet dhe kontributet tjera të cilat mblidhen në forma të ndryshme.

Shteti me anë të buxhetit realizon nevojat publike të shoqërisë, mundëson që sektorët e tij që kanë të bëjnë më edukim-arsimim, pastaj shëndetësi, sistem të drejtësisë, mbrojtje dhe ushtri, administratë publike, si dhe politika tjera sociale t'i përmbushë dhe t'i garantojë shtetasve të vet një jetë më të mirë dhe të sigurt.

Pyetjes të paguhen tatimet apo jo, iu është dhënë përgjigje e qëndrueshme që në formimin e shteteve të para duke pasur parasysh domosdoshmërinë e mbështetjes financiare për vetë ekzistencën e shtetit dhe mirëqenien e shoqërisë. Nga kjo mund të thuhet që tatimet përbëjnë „*Condito Sine Qua Non*”(kusht pa të cilin nuk mundet) të funksionojë një shtet.

Nga kjo thënie e urtë mund të kuptojmë që shteti nga tatimpaguesit duhet të mbledh

7. Dr.Bozhidar Jelçiq, *Shkenca mbi financat Zagreb.*

tatime , duke mos i rënduar ata në ushtrimin e veprimtarive ekonomike dhe fitimin për të cilën ato funksionojnë.

Tatimet janë bërë pjesë e rëndësishme e debateve politike, ekonomike dhe sociale. Zgjerimi i barrës tatimore, rritja e numrit të tatimpagueseve, reformat qeveritare sa i përket politikave tatimore, forcimi i përpjekjeve të organeve tatimore-Administratës Tatimore për luftimin e shmangies nga tatimet, si dhe rritja e edukatës fiskale tek tatimpaguesit kanë ndikuar jashtëzakonisht shumë në rritjen e debatit në lidhje me sistemin tatimor në të gjitha vendet e botës. Sot tatimet janë objekt diskutimi nga të gjithë, duke u nisur nga qytetarët, mediat, qeveria, forumet shkencore, dhe subjekte tjera të cilat kanë mendime të ndryshme sa i përket funksionimit të sistemit tatimor. Flitet për tatime të larta apo të ultë, pastaj flitet për zbatim/moszbatim adekuat të ligjit, për shmangie nga tatimi dhe evazion tatimor, për korrupsion dhe tema tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimet.

Të gjithë subjektet fizike-juridike-(tatimpaguesit), kanë të drejtën e tyre që të dinë se nga po shpenzohen paratë e tyre, të inkasuar në formë të tatimeve. Slogani amerikan,, nuk ka tatime pa pasqyrim të drejtë, Bajra (2012) do të thotë që shteti duhet që të arsyetojë arkëtimin e tatimeve nëpërmjet realizimit të objektivave, duke bërë që shpenzimet e parasë publike nga tatimet e mbledhura të jenë efikase dhe transparente për të ndikuar në përmirësimin e jetës së qytetarit.

Zbatimi i masave shtypëse tatimore dhe një politikë agresive tatimore, e shoqëruar me pakënaqësinë në shërbimet publike të ofruara nga ana e shtetit, duket që ka rritur rezistencën ndaj tatimeve dhe përhapjen e evazionit tatimor Odd-Helge (2006). Andaj nga kjo rezultojë që shteti administrimin e tatimeve duhet ta bëjë duke respektuar parimet e analizuara më lart e të cilët janë: Parimi i barazisë, Parimi i efikasitetit, Parimi i thjeshtësisë, dhe Parimi i transparencës. Për tu arritur mbledhja e tatimeve dhe në këtë mënyrë të sigurohen fondet e nevojshme për funksionimin e të gjitha shërbimeve dhe të mirave publike për qytetarët.

4.7. Llojet e Tatimit

1. Tatimi i Paragjykuar

Lloji i tatimit të paragjykuar është zbatuar në fazën fillestare të sistemit tatimor në Kosovë, administruar nga autoriteti qendror fiskal i Kosovës (AQF) në periudhën e menjëhershme të pasluftës viti 2000 krahas me tatimin në hotele dhe restorante si tatim në qarkullim për shërbimet me pije dhe ushqim.

Termi i tatimit të paragjykuar është emërtuar në mungesë të një fjalori adekuat për të zëvendësuar tatimin paushall i aplikuar në Kosovë në periudhën e regjimit socialist. Ky tatim i përkohshëm obligon bizneset që të paguajnë shumë të tatimit konform me të ardhurat e tyre në shkallë fikse dhe proporcionale. Po ashtu një kriter që ndryshon vlerën apo normën tatimore është edhe përcaktimi territorial në të cilin vepron biznesi. Kjo ka domethënie se varësisht se biznesi është në vendet me urbane apo jashtë do ketë një tatim më të lartë apo më të ulët në normën fikse të tatimit. Ky përcaktim bëhet për lokacione të ndryshme dhe varet nga niveli i të ardhurave bruto deri në kufirin 15000 Marka Gjermane (DM) , ndërsa për vlerën mbi këtë limit kemi tatim plus në vlerën prej 3% Ja edhe struktura dhe forma e funksionimit të këtij tatimi:

	Lok.A	Lok. B	Lok. C
2.1.Biznese, shërbime, Profesione, Zanatlinj	400	300	200
2.2.Aktivitete zbavitëse	400	300	200
2.3.Transport	250	200	150
2.4.Tregtarët lëvizës dhe ato më të ardhura deri 2500 DM/3mujo	75	75	75

Bizneset me xhiro 3 mujore më të lartë se DM 15,000

2.5.Të hyrat bruto për 3 mujorin

2.6. Kufiri ndarës = 15,000 DM për tremujor

2.7 Nëse të hyrat bruto për tremujor janë më të mëdha se

15000 DM atëherë $(2.5-2.6) \times 3\% =$ tatimi për xhiron mbi

15,000DM në 3 mujor

Burimi: Udhëzimi administrativ UNMIK 03/2000

Shembull: Marrim rastin e një restoranti në Prishtinë me të dhënat e mëposhtme:

- Xhiro 3 mujore: 45,000 DM

-Tatimi në Shërbime: $45,000 \times 10\% = 4,500$ DM

-Zbresim Tatimin në Shërbime nga xhiro 3 mujore: $45\,000 - 4\,500 = 40,500$ DM

-Baza e tatueshme me 3% tatim: $40,500 - 15,000 = 25,500$ DM

-Tatimi i paragjykuar për xhiron mbi 15,000DM: $25,500\text{DM} \times 3\% = 765$ DM

2. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Tatimi mbi të ardhurat personale filloi të zbatohet në Kosovë që nga viti 2005 dhe zëvendësoi tatimin e paragjykuar për bizneset e mesme dhe të mëdha përveç bizneseve me status të personave juridik dhe korporatave. Tatimi në të ardhurat personale është tatim direkt dhe përcaktohet mbi bazë të të ardhurave të krijuara nga bizneset në periudhën njëvjeçare për t'u paguar në këste paraprake tremujore gjatë vitit.

Objekti i këtij tatimi janë burimi i të ardhurave për personat, banorë të Republikës së Kosovës në vend dhe jashtë vendit të cilët përfitojnë nga të ardhurat e tyre. Personat jo banorë të Kosovës janë objekt i tatimit për të ardhurat që përfitohen në Kosovë.

Të ardhurat e tatueshme nënkuptohen rezultati i fituar i të ardhurave bruto të zbritura me kostot dhe shpenzimet e lejuara sipas ligjeve në fuqi. Normat tatimore janë të përkallëzuara varësisht prej të ardhurave, megjithatë të gjitha të ardhurat neto mbi 5400

Euro për vite do të tatohen me normën 20 % e ndryshuar në 10 % nga viti 2009. Shkallët tjera tatimore janë :

Të ardhurat e tatueshme deri 960 Euro në vit tatohen me zero përqind (0%)

Të ardhurat e tatueshme prej 961 deri me 3000 Euro 4 % (deri në vitin 2009 ishin 5 %) Të ardhurat e tatueshme prej 3001 deri me 5400 Euro 8 % (deri në vitin 2009 ishin 10 %)

Të ardhurat e tatueshme mbi 5400 Euro, tatimi në të ardhurat personale është 10 % ishte 20%) Fillimisht ky tatim ishte aplikuar vetëm në të ardhurat nga paga derisa

prej vitit 2005 ky tatim është i aplikuar për të gjitha të ardhurat e personave me aktivitet ekonomik që plotësojnë kushte sipas ligjeve në fuqi për këtë lloj tatimi si Aktivitetet afariste, qiratë, interesin, dividendet, lojërat e fatit dhe fitimet kapitale.

Në kategorinë e pagave hyjnë të gjitha të ardhurat e një punonjësi të pranuar nga punëdhënësi gjatë vitit kalendarik, mëditjet, premitë e sigurimit të shprehura në vlerë monetare dhe materiale.

Vlera e të ardhurave të tatueshme bruto paraqet pranimet bruto të pranuar nga personat ose entitetet në periudhën kalendarike njëvjeçare apo të përpjesëtuara në katër tremujor gjatë vitit. Në formën e shkallëzuar të normës tatimore do të paguajnë të gjithë personat me të ardhura deri 50 mijë euro të cilët edhe nuk kanë obligime ligjore për përpilimin e pasqyrave financiare. Të ardhurat mbi këtë limit janë objekt i tatuarjes reale që do të thotë se Pasqyrat financiare dhe e ardhura e tatueshme përlllogaritet në bazë reale të standardeve të kontabilitetit duke zbritur nga të ardhurat bruto koston e mallrave të shitura (KMSH) shpenzimet operative dhe shpenzimet e interesave bankare eventuale. Me tej nga këto të ardhura sipas këtij lloj tatimi do të tatohen edhe të ardhurat neto nga Qiraja, pasuria jo-materiale, patentat, të drejtat autoriale, të drejtat ekskluzive licencat etj. Të ardhurat nga interesi për huadhëniet, fletë-obligacionet dhe letrat me vlerë nga borxhi publik.

Funksionimi në Tatimin në të Ardhura Personale (TAP)

Tatimi në të Ardhura Personale aplikohet në të gjitha të ardhurat që merr një individ e që janë të tatueshme në bazë të Ligjit për Tatimin në të Ardhura Personale. Tatimpaguesit që i nënshtrohen këtij ligji janë personat fizik rezident dhe jo rezident, ndërmarrjet personale afariste, ortakëritë dhe shoqëritë, të cilët pranojnë apo krijojnë të ardhura bruto nga çfarëdo burimi, duke përfshirë pagën, veprimtarinë afariste, qiranë, fitoren në lotari, interesat, dividendët, fitimet kapitale (pas 1 janarit 2010), shfrytëzimin e pasurisë së paprekshme, pensionet, si dhe çdo të ardhur tjetër që rrit vlerën neto të tatimpaguesit. Periudha e tatueshme për Tatimin në të Ardhura Personale është viti kalendarik.

- Objekti i tatimit

Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme nga një burim në Kosovë dhe të ardhurat e tatueshme nga një burimi i huaj të ardhurash.

Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo-rezident janë të ardhurat e tatueshme nga një burim në Kosovë .

Personat rezident dhe jo-rezident dallohen për nga vendbanimi dhe koha e vendqëndrimit, respektivisht ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, në Republikën e Kosovës, që për nevoja tatimore një person është rezident nëse ka qëndrim në Kosovë mbi 183 ditë.

Tabela nr.5

Shkallët tatimore për TAP

Të ardhurat mujore (€)	Norma	Të ardhurat vjetore (€)	Norma
deri 80	0%	deri 960	0%
81 - 250	4%	961 - 3.000	4% e shumës mbi €960
251 - 450	8%	3.001-5.400	€81,6 + 8% e shumës mbi €3.000
mbi 450	10%	mbi 5.400	€273,6+10% e shumës mbi 5.400

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste deri në €50.000 prej të cilëve nuk kërkohet dhe që nuk zgjedhin t'i mbajnë librat dhe regjistrimet sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës, duhet të paguajnë:

- tre për qind (3%) të të ardhurave bruto për tremujor nga tregtia, transporti, bujqësia, si dhe aktivitetet e ngjashme komerciale, por jo më pak se €37,50 për tremujor,

- nëntë për qind (9%) të të ardhurave bruto për tremujor nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme, por jo më pak se €37,50 për tremujor, - tatimpaguesit pa qarkullim për tremujor duhet të paraqesin një deklaratë 'pa obligime tatimore' për atë tremujor.

- Të ardhurat bruto

Me përjashtim të të ardhurave që lirohen sipas ligjit, të ardhurat bruto nënkuptojnë

të gjitha të ardhurat e fituara ose të akumuluar nga çfarëdo burimi, duke përfshirë: pagën, qiranë, aktivitetin afarist, përdorimin e pasurisë së paprekshme, interesin, dividendin, fitimet kapitale, lotaritë dhe lojërat tjera të fatit, pensionet e paguara nga një punëdhënës i përparshëm, apo në përputhje me Ligjin për pensionet në Kosovë dhe çdo e ardhur tjetër që rrit vlerën neto të tatimpaguesit.

- Të ardhurat nga paga

Në të ardhurat bruto nga paga përfshihen:

- pagat e paguara nga ose në emër të një punëdhënësi për punën të cilën e kryen punonjësi sipas udhëheqjes së drejtorit ose punëdhënësit,
- bonuse, komisione dhe forma tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi pagën,
- të ardhurat nga puna e përkohshme të cilën e kryen punonjësi,
- të ardhurat nga punësimi i mundshëm, siç është nënshkrimi i një bonusi të pagës,
- premitë e sigurimit shëndetësor dhe të jetës që një punëdhënës paguan për punonjësin,
- falja e huas apo obligimit që punonjësi ka ndaj punëdhënësit,
- pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi, dhe
- përveç nëse është e specifikuar ndryshe me ligj, përfitimet në mall (in-kind) të dhëna nga një punëdhënës punonjësit, që tejkalojnë shumën minimale të specifikuar me akt nënligjor të lëshuar nga Ministri i Financave.

Në të ardhurat bruto nga pagat nuk përfshihen:

- kompensimi i shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit deri në shumat e përcaktuara me akt nënligjor të lëshuar nga Ministri i Financave,
- dëmshpërblimi për aksidentet në punë,
- përfitimet në mall (in-kind) nga punëdhënësi për punonjësin e huaj për t'ia lehtësuar jetesën në Kosovë, siç është banimi dhe shkollimi,

- përfitimet në mall (in-kind) në forma të shujtave të ofruara nga punëdhënësi për punëtorin duke përjashtuar kompensimin në para, etj.

Tatimpaguesit që pranojnë apo që realizojnë të ardhura prej vetëm një burimi si paga e cila ka qenë subjekt i mbajtjes në burim, nuk janë të detyruar të dorëzojnë deklaratë tatimore vjetore.

- Të ardhurat nga paga e dytë

Sipas Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatimin në të Ardhura Personale, punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të barabartë me 10% të pagave për secilën periudhë tatimore.

- Pagesa e tatimit

Secili punëdhënës është përgjegjës për mbajtjen në burim të tatimit në të ardhurat bruto nga pagat e punonjësve të tij gjatë çdo periudhe të pagave. Pagesat e tatimeve të mbajtura në burim duhet të bëhen në një bankë komerciale të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës në llogarinë e caktuar brenda 15 ditëve pas ditës së fundit të muajit kalendarik.

Tatimpaguesit me të ardhura nga aktiviteti ekonomik (me përjashtim të atyre me të ardhura vjetore deri në €50,000 dhe që nuk kanë zgjedhur vullnetarisht të tatohen në të ardhura reale), duhet të përgatisin dhe dorëzojnë një deklaratë tatimore vjetore më 31 mars ose para 31 marsit të vitit që pason periudhën tatimore

Tatimi mbi të Ardhura e Korporatave

Ndryshe nga tatimi në të ardhurat personale i ngarkuar dhe i obligueshëm për bizneset individuale dhe personat fizikë, tatimi në të ardhurat e Korporatave është po ashtu tatim në fitim por i ngarkuar për personat me status juridik dhe korporatat e mëdha. Tatimi në fitim i Korporatave zëvendëson tatimin në fitim i aplikueshëm në Kosovë që nga viti

2002. Ky lloj tatimi zbatohet mbi fitimin e subjekteve ekonomike, ndërmarrjeve, kompanive me status juridik dhe nivelin e të ardhurave sipas ligjeve aktuale në fuqi në

Kosovë.

Norma tatimore e tatimit mbi të ardhurat e Korporatave është 10 %.

Kushte nën të cilat një biznes do të jetë subjekt i tatimit mbi të ardhurat e Korporatave janë:

- a) Nëse personi i tatueshëm realizon të hyra vjetore mbi 100 mijë euro nga shitjet e mallrave apo shërbimeve apo
- b) Vlera e aseteve të këtij biznesi kalon mbi 50 mijë euro.

Tatimi mbi të ardhurat e Korporatës aplikohet në të ardhurat e realizuara të korporatës, derisa për tatimin në fitim është zbatuar vetëm në fitimin neto të korporatave të mëdha. Korporata si person juridik ka një status që është i ndarë dhe i ndryshëm nga anëtarët, pronarët apo aksionarët në korporatë.

Një Korporate mund të jetë e organizuar me kapital të ndarë me numër të caktuar të aksionarëve, numër të specifikuar të aksioneve dhe vlera të njëjta nominale të tyre.

Sipas rregullit aksionarët dhe pronarët tjerë të korporatës nuk përgjigjen me pasurinë tjetër individuale përveç me atë pasuri që kanë investuar në Korporatë.

Tatimi mbi të ardhurat e Korporatave filloi të zbatohet në Kosovë që nga viti 2005 për të pësuar ndryshimet themelore në vitin 2010 me ndryshimet në ligjet e pas pavarësisë. Ligji Nr. 03/L-162 përcakton rregullat dhe normat e aplikimit të Tatimit në të ardhurat e korporatave në Kosovë, përcjellë nga udhëzimet e ndryshme administrative.

Pagesa e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është obligative me deklaratën vjetore të paraqitjes së të ardhurave të përgjithshme, derisa këstet e këtij lloji tatimi mund të paguhen edhe për çdo tremujor deri me datën 15 të muajit pasues.

Kategoria e tatimpaguesve, nën limitin e kushteve për të qenë objekt i tatuarjes për qëllime të këtij tatimi (korporatave të vogla) janë të obliguar të paguajnë sipas kësaj skeme:

1. Tatimpaguesit të cilët kanë bruto të ardhura nën shumën 50 mijë euro dhe ata

të cilët nuk bëjnë zgjedhjen vullnetare për pagesën në baza reale të të ardhurave janë të obliguar të paguajnë.

2. Tre për qind (3%) të të ardhurave bruto nga shitjet e tërësishme të tyre nga veprimtaritë e tregtisë, prodhimit, bujqësisë, transportit apo të ngjajshme apo minimum 37.50 Euro për çdo tremujor.

3. Pesë për qind (5%) nga të ardhurat bruto prej kryerjes së shërbimeve, veprimtaritë profesionale, zëjtare ato zbavitëse etj, por jo më pak se 37.50 Euro për çdo tremujor.

4. Të ardhurat neto nga qiraja janë të obliguar të paguajnë 10 % të të ardhurave neto të qirasë për çdo tremujor.

Rregullat në Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK)

- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave aplikohet në të ardhurat e tatueshme të korporatave. Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore prej €50,000 apo më pak taten në masën 3% apo 9% në të ardhurat e tyre bruto për tremujor, varësisht nga natyra e aktivitetit ekonomik.

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore mbi €50,000 taten 10% në të ardhurat e tyre të tatueshme dhe janë të detyruar të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Këto të fundit janë kryesisht të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

- Të ardhura të tatueshme për një periudhë tatimore nënkupton ndryshimin në mes të të ardhurave bruto të pranuar apo të rrjedhura (akruara) gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve dhe lejimeve të lejueshme në lidhje me të ardhurat bruto të tilla.
- Për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, periudhë tatimore është viti kalendarik.
- Tatimpagues, në bazë të Ligjit për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, janë:
 - një korporatë ose një ndërmarrje tjetër afariste që mban statusin e personit juridik sipas

ligjit të aplikueshëm në Kosovë,

- një shoqëri tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike,
- një organizatë e regjistruar si organizatë jo-qeveritare sipas Legjislacionit mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Organizatave Joqeveritare në Kosovë, dhe
- një person jo-rezident me njësi të përhershme në Kosovë, që i nënshtrohet tatimit të Kosovës vetëm në të ardhurat që i atribuohen aktivitetit ekonomik në Kosovë

- Objekti i tatimit

Objekt i tatimit për tatimpaguesit rezident janë të ardhurat e tatueshme nga një burim të ardhurash në Kosovë dhe të ardhurat e tatueshme nga një burim i huaj të ardhurash. Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo-rezident janë të ardhurat e tatueshme nga një burim në Kosovë.

Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej €50,000 apo më pak mund të zgjedhin të mbajnë librat dhe regjistrimet (e detyrueshme për tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mbi €50,000) detyrimet administrative dhe të pagesave janë të njëjta si për tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mbi €50,000.

Kompanitë e sigurimit (që bëjnë sigurimin ose ri-sigurimin e jetës, pronës, risqeve tjera) paguajnë 5% tatim në primet bruto të periudhës tatimore (në vend të Tatimit në të Ardhura të Korporatave).

- Shkalla tatimore

Për periudhat tatimore duke filluar nga data 1 janar 2009, norma e Tatimit mbi të Ardhura të Korporatave është 10% e të ardhurave të tatueshme. Para kësaj date, norma e tatimit ishte 20% e të ardhurave të tatueshme.

- Të ardhurat e liruar

Të ardhurat në vijim janë të liruar nga Tatimi në të Ardhura të Korporatave:

- të ardhurat e organizatave të regjistruara sipas legjislacionit mbi regjistrimin dhe funksionimin e organizatave jo-qeveritare që kanë fituar dhe mbajtur

statusin e përfitimit publik me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik,

- të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve ndërkombëtare financiare qeveritare të autorizuar që veprojnë në Kosovë,
- dividendë e marrë nga një tatimpagues rezident dhe jo-rezident prej një kompanie rezidente që ka paguar tatimin në të ardhura të korporatave në Kosovë,
- të ardhurat e Religjioneve të pranuar të Kosovës për ushtrimin e aktivitetit ekonomik të veçantë për vet mbështetjen e tyre,
- të ardhurat e kontraktorëve primarë ose nën-kontraktorëve, përveç personave vendorë, që janë krijuar nga kontratat për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara (duke përfshirë UNMIK-un), agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-it dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore me kusht që ata drejtpërdrejt të jenë të angazhuar në projekte dhe programe të organizatave të cekura më lartë,
- të ardhurat e kontraktorëve primarë ose nën-kontraktorëve, përveç personave vendorë, që janë krijuar nga kontratat me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë, Bashkimin Evropian, Agjencitë e Specializuara të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në mbështetje të projekteve dhe programeve për Kosovën.

- Humbja

Shuma e humbjes së biznesit mund të bartet deri në 7 periudha tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

- Kosto e përfaqësimit

Kostot e përfaqësimit lejohen si shpenzime deri në një maksimum prej 2% të të ardhurave bruto.

Tatimi Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Tatimi në Vlerën e shtuar filloi të zbatohet në Kosovë prej vitit 2001 me rregulloren e UNMIK-ut nr 2001/11 për të përjetuar ndryshimet në vitin 2002.

Vendosja e Tatimit të Vlerës së shtuar në Kosovën e pasluftës ishte një sukses i madh për sistemin fiskal dhe të ardhurat publike, për arsye se i njëjti përveq si tatim i mbledhshëm në brendi të vendit arkëtohet edhe në mallrat nga importi që përbën një vlerë të konsiderueshme të buxhetit të Kosovës.

Me konsolidimin e pavarësisë së Kosovës rregullat e Tatimit të vlerës së shtuar u perfeksionuan dhe në vitin 2009 u bënë ndryshime të mëdha cilësore me ligjin Nr. 03/L-146 i cili filloi të zbatohet që nga fillimi i vitit 2010.

Tatim mbi vlerën e shtuar është tatim indirekt i cili zbatohet si tatim në konsum ndaj mallrave dhe shërbimeve në mënyrë proporcionale me çmimet e tyre.

TVSH-ja llogaritet sipas shkallës tatimore të përcaktuar me ligj dhe ngarkohet në çmim, në çdo aktivitet të prodhuesve, tregtarëve ose personave.

Me aktivitet ekonomik nënkuptojmë çdo aktivitet të prodhimit, tregtisë ose personave që furnizojnë mallra dhe shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, si dhe aktivitetet e profesioneve. Shfrytëzimi në baza të vazhdueshme i pasurive të prekshme ose të paprekshme me qëllim të sigurimit të të ardhurave në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik.

Objekti i tatimit në vlerën e shtuar është furnizimi me mallra dhe shërbime për qëllime fitimi të cilat i bënë personi i tatueshëm brenda një vendi. Sipas kësaj të gjithë personat që bëjnë shitje të mallrave dhe ofrimin e shërbimeve janë të obliguar që të përlogarisin, kalkulojnë TVSH në çmimet shitëse (tatimi i përlllogaritur) i cili në fund të periudhës do të transferohet në llogarinë e buxhetit të shtetit.

Nga se rrjedh fjala Tatimi i Vlerës së shtuar nënkuptojmë, se një shoqëri tregtare (biznes) në shumicën e rasteve në momentin kur vepron si shitës, i njëjti domos-

doshmërisht është një blerës i atyre mallrave apo ka krijuar shpenzime operative për ofrimin e shërbimeve. Gjatë kësaj ecurie patjetër që ky biznes do ketë blerë mallra, qoftë nga prodhimi tregtia apo edhe nga importi, dhe për të njëjtat ka paguar në blerje TVSH.

Kjo situatë na qartëson me tej se ky lloj tatimi do t'i paguhet shtetit vetëm në Vlerën e shtuar të çmimit, respektivisht marzhës së kalkuluar.

Shembull :

Kompania X në muajin Janar ka blerë mallra në vlerë të tatueshme prej 5000.00 Euro, Norma e TVSH-së në Kosovë aktualisht është 18 % që nënkupton se TVSH-ja në mallin e blerë është 900.00 Euro, gjithsejtë faturimi 5900.00 Euro .

Kompania e njëjtë ka shitur në tërësi mallin në muajin Janar dhe ka përlllogaritur marzhën 10 % që nënkupton se ka realizuar 590.00 Euro fitim shtesë dhe ka shitur mallin në çmim 6490.00 Euro. Tatimi i përlllogaritur për TVSH do jetë 989.73 Euro. Nëse shikojmë në faturën hyrëse shohim se ky biznes veç ka paguar në blerje 590 Euro prandaj obligimi për pagesë ndaj buxhetit të shtetit do jetë vetëm diferenca ndërmjet Tatimit të Përlllogaritur (989.73) dhe tatimit të zbritshëm (590.00 Euro) që është 399.73 Euro.

Tatimi i vlerës së shtuar pra është tatimi i përlllogaritur në vlerën shitëse të produkteve dhe shërbimeve, megjithatë sipas rregullave aktuale në Kosovë ky tatim mbledhet në blerje si mundësi e kthimit të këtij në thyerje me tatimin e përlllogaritur.

Tatimin e vlerës së shtuar e paguajnë personi i tatueshëm që nënkuptohet si personi i cili sipas ligjeve në fuqi është i obliguar të regjistrohet në këtë lloj tatimi (bizneset të cilat kanë xhiro vjetore mbi 30 000 Euro apo bizneset që vullnetarisht janë regjistruar për TVSH) dhe ushtrojnë veprimtarinë afariste në mënyrë të pavarur.

Do të përjashtohen nga pagesa e Tatimit të vlerës së shtuar personat tjerë të cilët kanë marrëdhënie pune me ndonjë punëdhënës tjetër, autoritetet mbi aktivitetet qeverisëse të nivelit qendror dhe lokal që kanë të bëjnë me mbledhjen e taksave, tatimeve dhe kontributeve tjera, si dhe autoritetet e organizatave ndërkombëtare të instaluar në Kosovë

për qëllime humanitare dhe logjistike.

Tatimi i Vlerës së Shtuar përlllogaritet në çmimin e mallrave apo shërbimeve të furnizuara. Furnizimi i mallrave nënkupton

- a) të drejtën e transferit për të disponuar me pasurinë materiale si pronarë, (në kompensim të një pagese me para, me urdhër apo ne emër të një autoriteti publik dhe rregullat sipas ligjeve në fuqi),
- b) dërgimi apo dorëzimi i mallrave apo kryerja e shërbimit, c) transferi i mallrave sipas kontratës së nënshkruar.
- d) dorëzimi i përfundimit të punëve sipas kontratës dhe
- e) furnizimi i mallrave të paprekshme (rryma , uji , gazi etj.

Përveç mallrave të përfshira në llojin e Tatimit të Vlerës së Shtuar, me dispozita të veçanta përjashtohen disa nga mallrat dhe shërbimet, si furnizimi i mallrave për nevojave-tanake të biznesit, investimet në objektet e biznesit, shpenzimet ekskluzivisht për nevojat e pronarit, shfrytëzimi i sasisë të mallrave për mostra, dhurata, e tjera të ngjajshme.

Po ashtu transferi i biznesit apo pjesët e caktuara janë të përjashtuara nga kualifi-kimi si furnizimi i mallrave për qëllime të TVSH-së.

Vendi i furnizimit po ashtu është më rëndësi në llojin e tatimit të vlerës së shtuar sepse ndërlidhet me atë se kush është obligues tatimor në këtë rast. Vend i furnizimit është vendi ku janë :

- a) Shitur mallrat apo janë kryer shërbimet.
- b) Furnizimi i mallrave me transport nënkupton transportimi i mallrave deri në vendin e blerësit të mallrave ose akomodimi i shërbimeve.
- c) Vendi i furnizimit për shërbime është vendi ku biznesi e ka themeluar biznesin (selia e biznesit) ose vendi ku janë kryer shërbimet.

Përveç furnizimeve në brendi të shtetit, bizneset shumicën e mallrave i blejnë nga shtetet e tjera përmes tregtisë ndërkombëtare. Ky tregtim quhet ndryshe import i mallrave.

Vendi i importit të mallrave për qëllim të tatimit të vlerës së shtuar do të konsiderohet vendi ku janë vendosur mallrat me rastin e importit, respektivisht pika doganore ku hyjnë mallrat.

Detyrimi për pagesë së TVSH-së .

Momenti i lindjes së detyrimit tatimor është i lidhur drejtpërdrejtë me furnizimin (shitjes) dhe deklarohet dhe paguhet në këto momente:

1. TVSH bëhet e obligueshme në momentin e furnizimit me mallra dhe shërbime (rregull i përgjithshëm).
2. Momenti i importit të mallrave në kufi.
3. Në momentin e përlogaritjes së pasqyrave të njëpasnjëshme apo pagesave pa-suese.
4. Pagesat në emër të furnizuesit para se të jetë dërguar malli (avansi)

Vlera a tatueshme e mallrave dhe shërbimeve përfshin çdo gjë që përbën kundërvlerë, konsideratë që merret ose do të merret, duke përfshirë edhe subvencionet e lidhura drejtpërdrejtë me çmimin e furnizimit. Konsiderata nënkupton kompenzimin në para ose në formë tjetër të mallrave e vlerësuar sipas vlerës së tregut.

Lirimet nga Tatimi i Vlerës së shtuar:

- a) Furnizimi i shërbimeve për qëllime mjekësore dhe spitalore b) Furnizimi me organe njerëzore, gjak dhe qumësht të nënës
- c) Furnizimi me shërbime dentare dhe proteza që lidhet me shërbimet dentare
- d) Furnizimi nga grupet e pavarura të profesionistëve në ushtrimin e veprimtarisë që është e liruar nga TVSH-ja.
- e) Furnizimet ngushtë të lidhura me punën e mirëqenies sociale.
- f) Furnizimet që lidhen me punën e mbrojtjes dhe edukimit të fëmijëve.
- g) Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve për qëllime religjioze, sportive kulturore etj. Dhe lirimet tjera sipas ligjeve specifike periodike.

Zbritjet e TVSH-së

TVSH bëhet e zbritshme nëse paraprakisht ka ndodhur një transaksion i mallrave apo shërbimeve për të cilat është paguar TVSH-ja, dhe me kusht që mallrat e blera do të shfrytëzohen për qëllime të shitjes së mëtutjeshme si kategori e shitjeve të tatueshme.

Shuma e TVSH-së së zbritshëm do jetë e pranueshme po që se transaksioni është përcjell me dokumente përkatëse sipas standardeve, faturë apo deklaratë doganore të regjistruar.

E drejta për zbritje do të lind në kohën kur tatimi i zbritshëm bëhet i ngarkueshëm.

Rimbursimi i TVSH-së

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë një person i tatueshëm (biznes) do të ketë fatura me vlera të blerjes së mallrave dhe fatura furnizimi (shitjeje) që rezulton me TVSH të zbritshme dhe TVSH të llogaritur. Diferenca e krijuar në një periudhë tatimore (muajore) ndërmjet TVSH-së së zbritshme dhe përllogaritur, në momentin kur kjo e para është më e madhe quhet “Kreditim” dhe nënkupton mundësinë e kthimit të kësaj shume nga autoritetet tatimore.

Varësisht prej rregullave dhe ligjeve në fuqi kjo shumë i mundësohet tatimpaguesit që të kthehet në llogarinë e tij në një afat të përcaktuar me ligj. Kjo formë e kthimit të TVSH-së së kredituar ndryshe quhet si “Rimbursim”

Tatimin e paguar tepër tatimpaguesi mund t’a bartë edhe në periudhat tatimore në vazhdim të ushtrimit të veprimtarisë për të kompenzuar TVSH-në e llogaritur në furnizimet vijuese.

Aktualisht aplikohen shkallë të ndryshme tatimore. Në Bashkimin Evropian, shtetet anëtare, kanë bërë përpjekje për harmonizimin e sistemit të TVSH-së kryesisht nëpërmjet Direktivave të Këshillit të Evropës. Megjithatë, shkallët tatimore lëvizin nga 15% deri në 25% (Fjalori Tatimor Ndërkombëtar, Byroja Ndërkombëtare të

Dokumentacionit Fiskal (www.ibfd.org),

Tatimi në Vlerën e shtuar deri sot është zbatuar në 120 shtete të botës dhe Kosova është ndër shtetet e fundit që ka aplikuar tatimin e njëjtë. Është karakteristikë se ky lloj tatimi aplikohet më së shumti në Bashkimin Evropian, Azi dhe Amerikën Latine. Në bashkimin Evropian është harmonizuar zbatimi i tatimit të vlerës së shtuar përmes Direktivës së gjashtë të Bashkimit Evropian.

Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian aplikojnë një shkallë të tatimit të vlerës së shtuar TVSH-së, derisa vendet në tranzicion edhe Kosova aplikojnë dy shkallë tatimore.

Dispozitat në Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Kosovë

- Norma e TVSH-së është 18 % dhe 8 % për produktet e konsumit ditor e vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendshme të tatueshme me përjashtim të atyre të liruar dhe atyre të trajtuara si eksporte.

- Bizneset me qarkullim mbi €30,000 në 12 muajt e fundit janë të detyruara të regjistrohen për TVSH. Bizneset me qarkullim nën këtë shumë mund të regjistrohen vullnetarisht për TVSH. Bizneset me qarkullim nën €30,000 në 12 muajt e fundit të cilat importojnë ose eksportojnë duhet të regjistrohen për TVSH si Importues apo Eksportues, mirëpo nuk kërkohet të deklarojnë për TVSH. Për importuesit të cilët importojnë asete kapitale, pagesa e TVSH-së mund të shtohet për pagesë për gjashtë muaj me pëlqimin e autoritetit tatimor. Në përputhje me parimet e BE-së dhe të TVSH-së, eksportet tatohen me normë zero për qind (0%).

TVSH-ja në blerje nga importi mblidhet në kufijtë shtetëror të Kosovës. Blerësi apo bartësi i transaksionit ngarkohet me TVSH-në në bazë të vlerës doganore të përcaktuar sipas faturës së mallit apo përcaktimit të vlerës nga autoritete doganore dhe në çdo tatim tjetër të importit (taksa doganore dhe akciza, nëse janë të aplikueshme) pavarësisht origjinës së tyre.

TVSH-ja aplikohet në importe dhe në çdo furnizim të mallrave dhe shërbimeve, me

përfshirje të atyre të cilat sipas ligjit konsiderohen si furnizime të liruara.

Sipas Ligjit Nr. 03/-146 për TVSH, disa furnizime janë të liruara nga TVSH-ja, mbi disa nuk do të paguhet TVSH dhe disa furnizime janë të liruara nga TVSH-ja pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshëm.

- Furnizime tjera të liruara nga TVSH-ja janë:

- eksportet,

- furnizimi i mallrave dhe shërbimeve në lidhje me transportimin ndërkombëtar,

- furnizimi i mallrave ose shërbimeve nën aranzhimin diplomatik dhe konsullor,

- furnizimi i mallrave ose shërbimeve për organet ndërkombëtare dhe ndër-qeveri-

tare të njohura si të tilla nga autoritetet publike të Kosovës,

- furnizimi i mallrave apo shërbimeve për NATO-n dhe KFOR-in ,

- furnizimi i arit për Bankën Qendrore,

- ujitja e tokave bujqësore,

- furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e donacioneve (periudha kalimtare),

- furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të bëra për Kombet e Bashkuara ose ndonjë nga agjencitë e saj, Banka Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare.

- Gjatë importimit, Tatimi mbi vlerën e shtuar nuk do të paguhet për:

- importimin e sendeve personale të udhëtarit të lejuara sipas dispozitave doganore në fuqi,

- importin e mallrave turistike të lejuara nga dogana sipas dispozitave në fuqi të Doganës,

- importet ose furnizimet e financuara nga donacionet e bëra përmes ministrive apo departamenteve qeveritare, organizatave qeveritare dhe ato joqeveritare me status të përfitimit publik si ndihmat për projektet humanitare dhe të rindërtimit në Kosovë

- importet ose hyrjet të cilat i kanë bërë përfaqësuesit diplomatikë ose janë bërë për ta apo për zyrat e ndërlidhjes,
- importet apo hyrjet brenda, të cilat i kanë bërë Kombet e Bashkuara ose janë bërë për to apo për cilindo nga organet e saj, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare,
- importet apo hyrja e barnave brenda, shërbimet mjekësore, produktet farmaceutike, instrumentet mjekësore apo kirurgjike dhe pajisjet.
- Furnizime të përjashtuara, apo furnizime të liruara nga TVSH-ja pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshëm, janë:
 - furnizimi i shërbimeve mjekësore, i barnave, i produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparaturave mjekësore dhe kirurgjike,
 - furnizimet e shërbimeve të edukimit,
 - furnizimet e shërbimeve financiare,
 - transferimi i titullit të pronësisë, qiraja e tokës dhe e shtëpive të banimit,
 - furnizimi të cilin e kryen personi i cili importon apo fut mallra, qarkullimi i të cilit nuk e tejkalon limitin e caktuar,
 - sigurimi i lejeve ose licencave bashkë me pagesën nga organet komunale ose publike etj.
- Aplikimi i normës së sheshtë të TVSH-së për prodhuesit bujqësor

Bazuar në udhëzimin administrativ nr. 05/2013 për aplikimin e normës së sheshtë të TVSH-së për prodhuesit bujqësor, që nga data 11 shtator 2013, norma e sheshtë për prodhuesit bujqësor është 16%. Kjo normë është e aplikueshme në:

- produkte primare bujqësore të përgjithshme,
- bimët zbukuruese, aromatike, mjekuese, të natyrës dhe të serave,
- prodhimin e kërpudhave dhe frutave të malit,

- prodhimin e fidanëve (kultivimin e pemëve dhe perimeve të reja për shitje) dhe farërave,
- qumësht dhe nën-produktet e qumështit.

Kontributet

Ne pjesën e te hyrave publike hynë edhe kontributet e ndryshme të personave fizik e juridik dhe shoqërisë në përgjithësi.

Rëndësia dhe karakteri i kontributeve si kategori fiskale, ndryshon si për nga shtetet po ashtu edhe nga trajtimi i tyre. Kontributet si edhe tatimet kanë elemente të ngjashme me instrumentet tjera fiskale. Edhe kontributet krijojnë të ardhura publike dhe paguhen për një qëllim të caktuar. Dallimi qëndron në atë se kontributet i paguajnë personat e caktuar, për destinim të caktuar dhe efektet e tyre janë vazhdimisht të matshme.

Kontributet janë obligime dhe pagesa nga vetë personat përfitues dhe kontributi i punëdhënësit derisa tatimet kishin karakter gjithëpërfshirës dhe përdorshin për qëllime të shoqërisë së gjerë dhe shtetit.

Në Republikën e Kosovës funksionojnë vetëm kontributet pensionale të cilat sigurohen nga kursimet individuale të personave.

Mbledhja e kontributeve pensionale bëhet në Trustin e kursimeve pensionale dhe e njëjta bëhet nga administrata tatimore e Kosovës si agjencion i autorizuar.

Aktivitetet e mbledhjes së kontributeve pensionale në Kosovë filluan prej vitit 2001 për t'u rregulluar më vonë mbi bazën e ligjit Nr. 2005/20 mbi kontributet pensionale në Kosovë ku precizohen rregullat e aktiviteteve për inkasimin e kontributeve për financimin pensional dhe kursimeve pensionale.

Sipas kësaj dispozite ligjore të gjithë të punësuarit do të paguajnë nga paga e tyre mujore dhe në të njëjtën kohe punëdhënësit do të paguajnë shumën e barabartë për punëtorët e tyre në emër të kontributit pensional.

Punëdhënësit janë të obliguar të paguajnë shumën prej pesë përqind 5% nga paga

bruto mujore e punonjësit dhe po ashtu punonjësit janë të obliguar të paguajnë pesë për qind 5% nga paga e tyre mujore.

Kontributet pensionale paguhen nga punonjësit që nga mosha tetëmbëdhjetë vjeçare dhe përfundojnë së paguari në moshën 65 vjeçare.

Punëtorët dhe ndërmarrësit mund të paguajnë edhe kontribute shtese apo vullnetare mbi shumen e parapare ligjore por në nivelin e kufizuar ligjor në shumen plotësuese deri 10 % të pagës si edhe punëdhënësit që mund të kontribuojnë vullnetarisht deri në shumen 15 % për punëtorët e tyre.

Personat e vetëpunësuar apo ndërmarrësit duke paguar tatimin mbi të ardhurat personale mund të paguajnë shumen minimale deri në 10% apo shumen maksimale deri 30% të shumes neto të të ardhurave.

Ndërmarrësit e vegjël të cilët paguajnë tatimin në të ardhurat personale sipas tatimit të paragjykuar janë të obliguar të paguajnë shumën minimale në 1/3 e shumes së tatimit dhe shumen maksimale deri në 2400 euro në vite.

Fondi pensional i kontributeve

Fondi i kontributeve pensionale administrohet nga Trusti i kursimeve pensionale të Kosovës. TKP Trusti i kursimeve pensionale është i formuar prej viti 2001 nga organi legjislativ e Kuvendit të Kosovës dhe ka për detyrë menaxhimin e mjeteve të mbledhura nga personat fizik dhe juridik të punësuar në vend. Mjetet e trustit mbahen në llogaritë personale të kontribuesve dhe kanë një transparence periodike për të gjithë punonjësit. Ky fond pensional është formuar dhe funksionon në bazë të ligjit të veçantë Nr 2005/20 për pensionet në Kosovë i cili parasheh dispozitat dhe kompetencat e këtij fondi për menaxhimin e mjeteve të grumbulluara.

Menaxhmenti i trustit pensional në kuadër të kompetencave ligjore ka organizuar sistemin investiv të mjeteve të fondit pensional që nënkupton angazhimin e mjeteve në tregun e këmbimit valutor.

Sistemi i fondit pensional për kontribute pretendon të jetë një sistem modern me norma relativisht të ulëta dhe përbëhet prej tri shtyllave;

1. Pensioni bazë për moshën e vjetër mbi 65 vjeç i cili merret drejtpërdrejt nga buxheti i Kosovës, administruar nga Ministria e Mirëqenies Sociale
2. Pensioni i shtyllës së dytë i cili paguhet nga kontributet e vetë punonjësit dhe punëdhënësit nga pagat e fituara.
3. Pensionet e fituara nga pagesat vullnetare, të paguara enkas për këtë qëllim.

Në vendet fqinje të Ballkanit sistemi i pensioneve organizohet në dy sisteme. Në sistemin e investimeve dhe sistemi i transfereve. Disa nga vendet si Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi aplikojnë sistemin e transfereve të pensioneve ndërsa shtetet si Kroacia e Bullgaria që nga viti 2000 aplikojnë sistemin inventiv të skemës pensionale.

Përndryshe skema pensionale sipas sistemi e bazuar në transfere quhet “Sistemi pensional i bazuar në transfer apo (PAYG – Pay As You Go) është program që financohet nga tatimet ose kontributet e mbledhura nga punonjësit dhe financojnë pensionistët dhe sistemi apo skema e pensioneve bazuar në investime.

Në Kosovë ekziston dhe aplikohet sistemi pensional investiv i mjeteve i cili ka konceptin e vendosjes së mjeteve në llogari individuale deri në moshën e pensionit. Mjetet e grumbulluara përgjatë kohës së qëndrimit të tyre në fond investohen në tregjet e kapitalit me qëllim të rritjes së tyre përmes interesit.

Aktualisht, një pjesë e madhe e mjeteve të kontributeve pensionale të fondit është angazhuar (investuar) në tregje të jashtme të kapitalit qoftë në formë të aksioneve apo në mjete të bonove të thesarit etj.

4.8. Të Ardhurat Lokale – Komunale

Në funksion të decentralizimit të sistemit tatimor në Kosovë, komunat si njësi kushtetuese e organizimit kontribuojnë në mbledhjen e të hyrave vetanake përmes

tatimit në pronë, taksave komunale, tarifat, qiratë në pasurinë e paluajtshme, të hyrat nga shitja e aseteve, ndërmarrjet plotësisht publike, gjobat etj.

Në vazhdimësi niveli lokal i qeverisjes – komunat kanë kërkesa për shpenzime publike me shume se sa që realizojnë të hyra vetanake.

Niveli i planifikimit dhe realizimit të këtyre të hyrave është bazë për marrjen e granteve nga qeveria qendrore. Një element tjetër i përqindjes së granteve është edhe numri i banorëve nëpër komuna.

Të hyrat lokale po ashtu ndahen në të hyra direkte dhe indirekte

Në të hyrat direkte përfshihen këto kategori të taksave:

Sipas Ligjit për Financa të Qeverisjes Lokale, Nr 03/L – 49 Ligji parashihen këto lloje të të hyrave direkte :

a)Taksat:

b)Tarifë: një shumë fikse e paguar për marrjen e dokumenti ose shërbimi profesion-

al. c)Tarifat e tjera komunale Komunat mund të rregullojnë dhe vendosin ngarkesa për aktivitetet tjera sipas vendimeve komunale apo ligjit.

d) Gjopa - pagesë që kërkohen për shkeljen e një ligji, rregulle ose rregulloreje të komunës.

e) Ngarkesat: Ngarkesat rregullative për ruajtjen dhe zhvillimin e Infrastrukturës. f)

Bashkë pagesat si pjesëmarrje nga arsimi dhe shëndetësia, kultura etj.

Vendos një grafik nga Trendet e të hyrave vetjake në Kosovë USAID Të hyra indirekte lokale janë :

i.Të hyrat nga gjobat në trafik

ii.Të ardhurat për gjobat e trafikut nga gjykata iii.Të ardhurat nga mbrojtja e pyjeve

Një pjesë tjetër e të ardhurave publike janë edhe nga Kuvendet komunale, të cilat janë të rregulluara me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave 2000/45 ku kuvendet komunale autorizohen që të nxjerrin buxhetin komunal i cili duhet të përmbajë planin

për aktivitete dhe menaxhim ekonomik brenda vitit fiskal, duke përfshirë të gjitha parashikimet e të ardhurave, mshpenzimet kapitale dhe të përgjithshme të komunës.⁸

Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike parasheh që komunat të kenë pushtet mbi proceset buxhetore në Komunë nëpërmjet Departamentit të Thesarit dhe Departamentit të Buxhetit sipas ecutive dhe procedurave analoge me ato që vlejnë për nivelin qendror. Menaxhimi i buxheteve komunale do të jetë më i efektshëm dhe më transparent përmes aplikimit të standardeve unike të evidencës kontabël, të raportimit dhe llogaridhënies sidomos përfshirja e njësive lokale – komunave në Free balance. Është e nevojshme që edhe Komunat të pajisen me certifikata të menaxhimit të financave publike që emërohen si “certifikate për menaxhimin me tarifa dhe ngarkesa “ që shumica e komunave në Kosovë i kanë të siguruar.

Kryesisht janë dy burime për formimin e buxheteve komunale:

- të hyrat vetjake dhe
- grandit që vjen nga buxheti i Kosovës

Deri në shtator të vitit 2003 të hyrat vetjake të Komunave ishin shumë të pakta madje ishin nën nivelin e parashikuar. Nga 27.8 milion të parashikuara, komunat kishin realizuar 16.32, ose 58.7% të tyre. Në të njëjtën kohë komunat shpenzuan 56.2% nga mjetet e planifikuara (duke përfshirë edhe grandet nga buxheti qendror). Të hyrat vetjake të komunave në vitin 2014 në krahasim me vitin 2015 u rritën për 9 %, kurse

në vitin 2015 llogariten se do të jenë rreth 15 % më të larta. Në vitin

2015, pritet që komunat nga të hyrat vetjake do të grumbullojnë rreth 50 milionë euro, që shënon rritje prej rreth 10 % në krahasim me vlerësimet për këtë vit. Pjesëmarrja e të hyrave vetjake në të hyrat e përgjithshme të komunave në vitin 2013 ishte 25%, në vitin 2014 26.5%, në vitin 2015 (gjashtëmujori parë 19.5% dhe në vitin 2016 pritet të jetë rreth 16.8%. është planifikuar një stimulim për mbledhjen e taksave komunale ashtu që

8. Riinvest, “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile “|Prishtinë

një pjesë e grandit të përgjithshëm është strukturuar si stimulim për të shpejtuar zhvillimin e tatimit komunal në pronë. Secila komunë do të marrë €1,000 në grandin bashkërendues, për çdo €1,000 që ajo grumbullon nga tatimi në pronë, deri në planin e llogaritur për secilën komunë.⁹

4.9. Tatimi në Pronë

Një ndër burimet kryesore të të hyrave vetanake të komunave në Kosovë është tatimi në pronë.

Tatimi në pronë nënkupton vendosjen e një shume të caktuar për pagesë në emër të pasurisë së paluajtshme, toka, ndërtesa, objekte afariste apo shtëpi banimi në bazë të një vlerësimi paraprak të vlerës së paluajtshmërisë apo paragjykimi me vlerën e tregut.

Tatimi në pronë është një ndër llojet e tatimit që është aplikuar që në kohërat më të vjetra dhe i njëjti ekziston edhe sot në shumë vende, madje të zhvilluara.

Qëllimi sekondar i mbledhjes së këtij tatimi nga shteti është tendenca për përdorimin sa më efektiv të kësaj pasurie.

Tatimi në pronë në Kosovë filloi të aplikohet prej vitit 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2003/29). Në Kosovë aktualisht funksionojnë 37 komuna si pushtete vetëqeverisëse lokale.

Qëllimi kryesor i komunës në mbledhjen e këtij tatimi është krijimi i kushteve në infrastrukturë dhe për përmirësimin e jetës së banorëve me ofrimin e shërbimeve cilësore komunale, shëndetësore dhe arsim.

Vlera e pasurisë së patundshme në m² përcaktohet në shumicën e rasteve nga vlera e tregut e paluajtshmërisë dhe në disa raste nga komisionet profesionale përkatëse të komunave.

Metoda e vlerësimit të paluajtshmërisë dhe pronës tjetër bazohet në analiza profesionale të kontratave të shitblerjes, hipotekës, dhe vlerësimin e ekspertëve.

9. Riinvest "Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile "Prishtinë

Me qëllim të përcaktimit me efikas të vlerës së tatimit në pronë, objektet të cilat ngarkohen me këtë tatim janë kategorizuar si:

- Pronat Rezidenciale,
- Pronat Komerciale,
- Pronat Bujqësore,
- Pronat industriale
- Pronat e braktisura.

a) Pronat rezidenciale - shfrytëzohen për nevoja individuale për qëllime të banimit.

Këto kategori përfshijnë objektet si , banesat, shtëpitë garazhet apo ndonjë objekt tjetër përcjellës banimi.

b) Pronat afariste - janë prona të shfrytëzuara për aktivitete të ndryshme ekonomike apo aktivitete tjera për afarizëm.

c) Pronat komerciale - përfshijnë objektet ku bëhen shitjet me pakicë, me shumicë, zyrat dhe parkingjet.

d) Pronat industriale - prona të shfrytëzuara për depot e produkteve të ndryshme, grumbullimin e mallrave, përfshirë fabrikat dhe njësitë e tyre.

e) Pronat bujqësore – agrare që nënkuptohen ato ndërtesa të shfrytëzuara për veprimtarinë ekskluzivisht bujqësore

f) Pronat e braktisura dhe objektet e e pa përfunduara.

Mjetet e grumbulluara nga tatimi në pronë derdhen në llogarinë e komunës përkatëse dhe përfshihen në buxhetin e përgjithshëm komunal.

Shuma e tatimit në pronë për secilin tatimpagues, caktohet nga secila komunë në bazë të rregullores së komunës për planifikimet buxhetore sipas zonave kadastrale dhe pozitës gjeografike të palujtshmërisë.

Tabela nr.6

Formimi i vlerës së tregut të palujtshmerisë për m² për tatimin në pronë

Pishinat	Fushat Sportive	Pronat e pabanuara	Pronat Bujqësorë	Objektet industriale	Pronat komunal	Garazhet dhe Bodrume	Rezidençë.	Shëpëria dhe banesa	Zona		
Banes	Shtëpi	Banese	Shtëpi								
I	450	400	450	400	200	700	350	150	160	100	100
II	350	350	350	350	150	500	300	150	140	100	100
III	300	300	300	300	100	350	250	150	120	100	100
IV	200	200	200	200	0	250	200	150	80	0	0
V	0	100	0	100	0	150	150	150	40	0	0

Burim - Punim nga autori

Normat tatimore për tatimin në Pronë përcaktohen nga kuvendet e komunave me vendime të posaçme. Komunitat janë përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e mjeteve të tatimit në pronë duke përfshirë edhe shpenzimet e këtyre mjeteve në destinimin e duhur. Përqindja e mbledhjes së tatimit në pronë ndikon në masë të konsiderueshme në alokimin e granteve qeveritare për nevojat shtesë për buxhetin e komunës.

Normat tatimore caktohen në bazë vjetore dhe janë të kategorizuara sipas pozitës gjeografike të pronës etazheve dhe hapësirës. Si p. sh.

- Pronat Rezidenciale, 0.20%

Normat tatimore për tatimin në Pronë përcaktohen nga kuvendet e komunave me vendime të posaçme. Komunitat janë përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e mjeteve të tatimit në pronë duke përfshirë edhe shpenzimet e këtyre mjeteve në destinimin e duhur. Përqindja e mbledhjes së tatimit në pronë ndikon në masë të konsiderueshme në alokimin e granteve qeveritare për nevojat shtesë për buxhetin e komunës.

Normat tatimore caktohen në bazë vjetore dhe janë të kategorizuara sipas pozitës gjeografike të pronës etazheve dhe hapësirës. Si p. sh.

- Pronat Rezidenciale, 0.20%

- Pronat Komerçiale, 0.18%
- Pronat Bujqësore, 0.09 %
- Pronat industriale 0.17 %
- Pronat e braktisura 0.05 % Shembull:

Personi fizik “Agimi” posedon një banesë në qendër të Pejës. Për të njëjtën banesë Komuna e Pejës ka konstatuar se ka një sipërfaqe prej 75 m². Sipas kontratës së blerjes çmimi i banesës është i shprehur në vlerë të “dinarit jugosllav” i cili sot nuk ekziston dhe nuk ka vlerë këmbimi. Komisioni komunal ka analizuar rastin dhe ka vlerësuar se vlera e tregut në këtë zone dhe etazh për m² është 500 Euro. Koeficienti tatimor bazë për këtë zonë është 0.20. Atëherë përlllogaritja është e lehtë:

Banesë - Pejë Zona - Parë Sipërfaqja - 75 m²

Vlera e tregut 500 Euro

$75\text{m}^2 * 500 \text{ Euro} = 22\,500 \text{ Euro} * 0.20 \% = 45 \text{ Euro}$ Tatimi në Pronë

4.10. Taksat si Instrumente Fiskale

Taksat Komunale – lokale

Taksat janë të hyra tjera fiskale të cilat grumbullohen prej personave fizikë dhe juridike nga njësit lokale bashkime apo komunat dhe organet e saj si kundër shpërblim për ofrimin e shërbimeve administrative apo shtetërorë.

Taksat përcaktohen paraprakisht në buxhetin e njësisë lokale dhe aprovohet nga organi më i lartë komunal, asambleja komunale.

Taksat si instrumente fiskale menaxhohen nga organet komunale dhe mblidhen në emër të pushtetit qendror me destinim për të mbuluar kërkesat për shpenzime në komunë. Taksat komunale përfshijnë në shumicën e rasteve; taksën mbi pasurinë e paluajtshme, taksat në firmë (biznes), taksat e regjistrimit, licencimit etj.

Dallojmë dy tipare të taksave fiskale :

Taksat që mblidhen në kundërvlerë të shërbimit të ofruar nga organi komunal

shtetëror (taksë e përcaktuar më parë) dhe Takst që paguhen sipas kërkesës së personit fizik ose juridik me rastin e kryerjes së shërbimeve nga organi përkatës.

Njëherazi këto dy elemente që karakterizojnë taksat, bëjnë që taksat të dallohen nga tatimet.

Siç shihet, taksat paguhen për shërbime të organeve komunale jo materiale dhe i takojnë në varësi të organit (qendror apo lokal) që i aplikon. Në përgjithësi në Kosovë taksat fiskale mbliidhen nga kuvendet komunale të cilët janë përgjegjës për administrimin, menaxhimin e të hyrave dhe të dalave për këto taksa.

Zakonisht taksat përdoren për investime në infrastrukturë dhe eventualisht për investime kapitale në nivelin lokal.

Për grumbullimin e taksave kemi këto burime :

taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet sipas rregullave dhe gjobat e autorizuara;

qiratë në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;

të ardhurat nga shitja e pasurive komunale;

të hyrat nga ndërmarrjet të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;

bashkë pagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore;

të ardhurat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;

interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;

grandet ose donacionet nga qeveritë e huaja, grandet dhe burimet e tjera financiare të nevojshme për ushtrimin e kompetencave komunale,

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-049 Per Financat e Pushtetit Lokal

Në bazë të këtij ligji, të gjitha taksat komunale dhe tatimi në pronë u mundësojnë

komunave si njësi administrative të kenë pavarësi financiare. Në përputhje me politikat ekonomike në Kosovë dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe të qeverisë, komunat e Kosovës kanë të drejtë të kenë burime financiare shtesë me të cilat mund të menaxhojnë lirshëm mjetet e grumbulluara gjatë ushtrimit të kompetencave në përputhje me ligjet e zbatueshme të vendit.

Komunat si njësi e pushtetit lokal edhe në nivel të agjencive tjera buxhetore të nivelit qendror, kanë autonomi t'i bëjnë politikat fiskale mbi taksat, tarifat, llojet dhe format e tyre.

4.11. Zhvillimet Fiskale në Kosovë

Në Kosovë historiku i mjeteve buxhetore është i shkurtër dhe karakterizohet që nga pas lufta e vitit 1999. Në fillim buxheti i Kosovës emërtohej si buxhet i konsoliduar të cilët përveç financimit nga burimet e brendshme, një pjesë të konsiderueshme plotësohej nga donacionet e institucioneve ndërkombëtare. Megjithatë që nga viti 2003 Buxheti i Kosovës është mbuluar nga vetëfinancimi i qytetarëve të Kosovës përmes tatimeve, taksave doganore dhe të ardhurave tjera fiskale. Administrimi i buxhetit bëhet nga ministria e Financave derisa realizohet nga dy institucionet të cilat janë të autorizuar të bëjnë mbledhjen e mjeteve, Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës(ATK)

Përveç këtyre të hyrave në buxhet përfshihen edhe vlera tjera nga akcizat, taksat dhe pagesat e ndryshme të cilat me detajisht mund të shihen në pasqyrimet shumëvjeçare;

Tabela nr.7

Dinamika e formimit të të ardhurave nga dogana 2005 -2014 (000 euro)

Përshkrimi	2005	2006	2008	2009	2011	2013	2014
Akciza e jashtme-kufi	130,911	115,268	129,395	132,498	150,695	286,992	304,075,
Akciza e brendshme	33,403	-	-	-	-	14,057	11,362
Taksa dog.imp,cig,et	71,936	46,587	61,988	70,817	56,223	120,128	126,323
Taksa dogan.në importe		77,695	81,208	93,350	98,312	104,100	
Tatimi(TVSH)në kufi	195,239	210,782	255,039	304,760	327,662	412,280	423,935
Taksa të ndrysh doganat	2,393	846	1,513	-	0	168	
Te hyrat nga dënimet		1,491	558	647	810	1,055	
Shifra mallrave	0	146	742	407	434	1,258	617
Tatimet tjera doganore		4,639	-	-	340	1,258	1,297
Banderolat		-	650	380	324	388	478
Kontroli jasht dogan.		-	2.555	805	325	1,277	1,232
Fast-Dogana		-	107	174	90	48	5
HYRAT-DOGANAT	434,381	457,454	533,755	604,979	635,214	700,657	870,978
Kthimet	-1,061	-2,164	-783	-1,068	-3189	-2,408	
Neto Të hyrat	434,381	456,393	531,591	604,196	634,146	837,269	868,570

Burimi: Raporti Financiar i buxheteve 2014

Të hyrat e mbledhura në brendi të vendit, tatimi në fitim tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në fitim i korporatave si kategori kryesore e tatimeve të përcjella me tatimet tjera aktuale në periudhat e mëhershme si tatimi i paragjykuar dhe tatimi në fitim

Tabela nr.8

Ecuria e tatimeve dhe e llojeve të tatimit vendor për periudhën 2005-2014

Përshkrimi	2005	2006	2008	2009	2011	2013	2014
Tatimi i paragjykuar	6716	2,272	997	284	2,794	1,328	157
Tatimi në fitim	12,667	9,380	3,441	4,425	8,407	583	15
Tatimi për korporata	-	31,273	53,728	51,946	55,355	64,982	54,947
Tatimi Ardhurat person	36,189	29,106	33,968	44,232	39,227	43,524	67,419
Tatimi mbi-TVSH	46,353	47,772	58,783	59,023	75,825	95,008	135,787
Tatimi për bizn. individ.		15,011	16,034	18,752	20,566	25,467	30,945
Tat.Int.divqir.lic.loj.fat		5,789	1,966	3,217	2,906	1,533	10,432
Tatimi në fitim shtesë		21,274	16,612	6,474	0	-	2,073
Tatimet pa specifikuara		5,500	6,317	734	1,388	1,880	42
TËHYRAT-ATK-ja	129,039	167,377	191,845	221,234	206,469	222,158	1,878
Kthimet		-3,298	-9,303	-21,324	-24,810	-27,017	-31,108
NetoTë hyrat		164,078	182,542	200,834	181,659	194,218	272,587

Burimi: Raportet vjetore të ATK-së

4.12. Regjimi Tatimor në Kosovë deri në Dhjetor 2014

Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përshtatshëm me atë të BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direkte dhe indirekte (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Dogana, Akciza, etj.).

Kosova deri më tani ka të nënshkruara tetë marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë të cilat edhe janë duke u zbatuar. Janë duke u negociuar edhe gjashtë kërkesa tjera me shtetet evropiane lidhur me lidhjen e marrëveshjeve të njëjta.

Nga viti 2013 është organizuar biseda me kompani të huaja ndër të tjera edhe me Delloite për ndërmjetësimin në fushën e Marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë me shtete tjera shtesë.

Kosova për momentin ka marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë me Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Turqinë. Slloveninë, Hungarinë dhe Çekinë janë nënshkruar por ende nuk janë në fuqi. Marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë me shumë shtete tjera janë duke u negociuar.

Detyrimet Doganore

- Taksa doganore është 0% - 10%
- shumica e lëndëve të para janë të liruara,
- shumica e pajisjeve për prodhimin janë të liruara - Rregullorja 2007/31,
- disa nga materialet e papërpunuara bujqësore (të tilla si farat, etj.) dhe pajisjet janë të liruara nga Dogana dhe TVSH-ja.

Të tjera

Paguesit e interesit, dividendës, honorarit, lotarisë dhe lojërave të fatit janë të detyruar të mbajnë në burim 10% mbi pagesën e secilit prej këtyre burimeve të të ardhurave, përveç nëse paguesi është individ i cili nuk është i angazhuar në veprimtari ekonomike.

Një individ i cili ka të ardhura vetëm nga interesi, dividendi, honorari, apo lotaritë dhe lojërat e fatit nuk është i detyruar të dorëzojë një deklaratë tatimore vjetore në administratën tatimore.

Akciza

Akcizat aplikohen në disa mallra vendase ose të importuara të tilla si cigare, pije alkoolike, ujë dhe pije të tjera freskuese, naftë, etj. Ligji mund të lirojë mallra të caktuara.

Tabela nr.9

Kodi i Akcizës – DK

<i>Kodi tarifar</i>	<i>Karburantet</i>	
2711	Gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera azotike	€0.1/ l
	Vajrat dhe prodhimet e tjera të distilimit të katranit të thëngjillit në temperatura të larta	€0.325/l
2710 11 (nr. i ri 2710 12) dhe 2710 19	Vajrat e petroleumit dhe vajrat e përfituara nga mineralet bituminoze	€0.325/l
2710 1931 deri 2710 1949 (nr. i ri 27101948)	Vajra të gazit (naftë)	€0.36/ l
27101131 (nr. i ri 27101231) deri 27101190 (	Alkooli për motorë	€0.385/l
2901, 2902€	Hidrokarbure ciklike dhe aciklike	€0.36/ l
3811	Të tjera të cilat përdoren për qëllime të njëjta si vajrat minerale	€0.36/ l
3814	Tretësit kompozite organik dhe holluesit	€0.36/ l
3817	Alkilbenzenët dhe alkilnaftalenët e përzier	€0.36/ l

Burimi : Korniza afatmesme e shpenzimeve

Që nga data 1 tetor 2013 norma e akcizës që aplikohet për duhanin është €30 për njësi (ishte €27 për njësi). *Duke filluar nga data 1 janar 2014 kjo normë do të jetë €32 për njësi.*

Tabela nr.10

Akciza në duhan, pije dhe vetura – DK

Duhani	€32/ njësi standarde			
Pijet Alkoolike				
Birra	€500/ hl			
Vera	€500/ hl			
Uji natyral mineral dhe i pa-gazuar	€0.045/ kg			
Veturat	Përdorimi	deri	2000cc (€)	2001-3000cc(€)
(vite)				mbi 3001cc (€)
0	0		500	500
8	500		500	1000
9	700		700	1500
10	800		900	1800
11	900		1100	2100
12	1000		1300	2400
13	1100		1500	2700
Goma të përdorura	€5/ copë			
Poça elektrik	€0.3/ copë			
Qese plastike	€3/ kg			

*Burimi : Korniza afatmesme e shpenzimeve**Ekonomia joformale në Kosovë*

Për ekonominë joformale ka qasje të ndryshme akademike lidhur me definicionin, shkaqet dhe pasojat e saj, madje në shumicën e rasteve edhe kundërthënëse. Definicionin më të saktë për ekonominë joformale e ka dhënë Organizata ndërkombëtare e punës ILO (1993) se “njësi të vëllimit të vogël që prodhojnë dhe shpërndajnë të mira e shërbime që përbëhen gjerësisht nga prodhuesit e pavarur, të

vetëpunësuar në zonat rurale dhe urbane të vendeve në zhvillim. ILO – Local employment in the informal economy, International Office, Gjeneve (2001)

Niveli i ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal në Kosovë vazhdon të jetë i lartë.

Ky nivel i ekonomisë së hirtë shpesh herë është vetë deklaruar në raportet periodike dhe prononcimet nga qeveria dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës.

Angazhimet e vazhdueshme të qeverive për synimet rutinë: Rritja ekonomike;

Qeverisja e mirë; dhe

Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social.

Parandalimi i ekonomisë joformale, duke përfshirë edhe korrupsionin dhe format tjera të ekonomisë së zezë, janë pjesë themelore e prioritetëve të politikave të qeverisë në mandatet qeveritare të këtyre dhe përfshihen në rangun e parë dhe dytë të prioritetëve. Republikës së Kosovës i nevojitet një sistem financiar i besueshëm dhe një ekonomi tregu e qëndrueshme dhe funksionale. Për këtë arsye është e rëndësishme që të gjenden metoda efektive për të parandaluar ekonominë joformale duke pasur parasysh edhe rrethanat politike, ekonomike, infrastrukturore të funksionimit të shtetit. Sipas shumë parametrave ekonomia informale në Kosovë arrin deri në 40% në shkallë vendi .

Për luftimin e informalitetit dhe evazionit fiskal shteti duhet ndërmarrë masa të shumta duke koordinuar faktorët relevantë dhe duke kompletuar resurset për këtë qëllim, por edhe duke përcaktuar prioritetet ekonomike të vendit.

Kosova ka përcaktuar prioritetet e politikave qeveritare. Republika e Kosovës aktualisht ballafaqohet me shumë sfida ekonomike“

Ajo ka shkallën më të lartë të papunësisë dhe varfërisë në rajon. Në harkun kohor të disa viteve të fundit, rritja mesatare e produktit vendor bruto ka qenë nën mesataren rajonale.

Shqetësim ka qenë dhe është papunësia e madhe, e vlerësuar të jetë diku rreth 30-40%, me rreth 40% të fuqisë punëtore të pakualifikuar.

Kostoja e fuqisë punëtore pretendohet të jetë e lartë për shkak të produktivitetit të ulët të punës dhe burimeve alternative të të ardhurave të cilat janë të larta.

Të ardhurat për frymë konsiderohen të jenë më të ulëtat në rajon dhe si rrjedhojë kjo shoqërohet me shkallë të lartë të varfërisë.

Autorë dhe publikime të ndryshëm kanë përlogaritur se ekonomia joformale e Kosovës vlerësohet të jetë në mes të 39% - 50%, duke përdorë tregues sikurse janë numri i të punësuarve në ekonominë formale dhe joformale, numri i ndërmarrjeve të cilat punojnë në lëmin formal dhe joformal si dhe shifrat krahasuese të shteteve tjera.

Vlerësimi i shkallës së ekonomisë joformale të Kosovës nuk është i lehtë. Problemi nuk është tek mungesa e të dhënave përkatëse, por tek përputhshmëria e të dhënave në mes të burimeve të ndryshme sikurse është Enti Statistikor i Kosovës dhe burimet tjera vendore dhe ndërkombëtare. Smajli, R (2011)

Sidoqoftë, ekonomia joformale, me pasojat e saj për sa i përket evazionit tatimor, çrregullimit të tregut të punës dhe konkurrencës së padrejtë, është një çështje e rëndësishme në Republikën e Kosovës, sikurse është edhe në ekonomitë tjera në tranzicion. Në fund të fundit, parandalimi i ekonomisë joformale është një sfidë ndërkombëtare sepse ajo dobëson infrastrukturën e shoqërisë; prandaj, e tërë shoqëria duhet të informohet për shtrirjen dhe ndikimin e saj.

Është vështirë të ndryshohen qëndrimet pa pasur njohuri adekuate për nivelin i informalitetit, dhe pa kuptuar këtë fenomen është shumë e vështirë që të ushtrohen masat e nevojshme për t'iu qasur këtij problemi shoqëror. Si pasojë, edukimi i palëve përkatëse për këtë problem shoqëror është gjëja më e rëndësishme në luftën kundër ekonomisë së hirtë dhe të zezë.

Parandalimi i ekonomisë joformale, korrupsionit dhe formave tjera të ekonomisë së zezë dhe të hirtë, janë pjesë themelore e prioriteteve të politikave qeveritare. Kjo do të thotë se qeveria duhet të ndërmarrë masa të prera për të zvogëluar ndikimin e këtij problemi shoqëror në mënyrë që të:

- Përmirësojë klimën për biznese dhe investime;
- Joshë dhe inkurajojë investimet private kombëtare dhe ndërkombëtare

- Sigurojë përfshirjen e sektorit privat në procesin reformues;
- Zvogëlojë çrregullimin e tregut të fuqisë punëtore dhe konkurrencën e padrejtë;
- Zhvillojë një sektor të fuqishëm sipërmarrës dhe ndërtojë një ekonomi tregu me funksionim të mirë;
- Sigurojë zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e strukturave bazë të shoqërisë siç janë arsimi, kujdesi shëndetësor, rendi publik/siguria, rrjeti i transportit dhe siguria sociale; dhe
- Luftojë korrupsionin dhe krimet e tjera serioze të organizuara që lidhen direkt me ekonominë joformale.

Tatimet e dyfishta dhe marrëveshjet e Kosovës për eliminimin e tyre

Tatimet e dyfishta paraqiten në rastet kur personat dhe bizneset punojnë jashtë vendit të tyre amë dhe krijojnë të ardhura të cilat mund të jenë objekt i tatimit në të dy shtetet. Kur një rezident i Kosovës ka investuar dhe punon në një shtet tjetër, i njëjti ka obligime që të paguajë tatime edhe në emër të ardhurave të krijuara jashtë Kosovës. Megjithatë, çdo shtet ka dispozitat ligjore me të cilat të ardhurat e krijuara në atë vend tatimohen në bazë ligjore. Në mënyrë që tatimpaguesit, personat mos të paguajnë tatime të dyfishta shtetet dhe qeveritë nënshkruajnë marrëveshje ndërshtetërore për eliminimin e pagesës së dyfishtë të tatimeve. Këto marrëveshje behën në baze të miqësisë dhe bashkëpunimit reciprok në mes shteteve të rajonit dhe me gjerë.

Marrëveshjet obligojnë dhe nënkuptohen se në bazë të dokumenteve tatimore “Çertifikatave mbi pagesën e tatimit” të lëshuar nga shteti, të pranuar nga personat jo-rezident të lirohen nga pagesat e dyfishta në shtetet e tyre.

Republika e Kosovës deri me tani ka marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë me disa shtete dhe është në rrugë të mbarë për nënshkrimin e shumë marrëveshjeve tjera për këtë qëllim.

Një marrëveshje ekzistuese që në bazë të ish sistemit juridik Jugosllav, anëtare e së cilës ishte Kosova para viteve '90, ka shërbyer që Kosova të funksionojë në këtë fushë,

deri në pavarësimin e plotë të saj.

Kjo marrëveshje ekziston që nga viti 1982 nënshkruar me Britaninë e madhe, 1987 me Finlandën, 1983 me Gjermaninë e Holandën, për të pasuar marrëveshjet që Kosova ka bërë pas pavarësisë në vitin 2012 me Belgjikën e Turqinë , 2013 me Maqedoninë, 2014 me Hungarinë dhe 2015 me Slloveninë dhe Shqipërinë .

Dy nga këto marrëveshje janë ratifikuar nga Republika e Kosovës me Britaninë e madhe në korrik të vitit 2015 dhe Turqinë në nëntor 2012.

Tabela nr.11

Lista e marrëveshjeve për eliminim të tatimeve të dyfishta - Kosovë 2015

Shteti	Në fuqi që nga	Komente shtesë
Belgjika	13.04.2012	
Britania e madhe	SFR Jugosllavia: përaf. 01.04.1982 RKS: 06.09.2010	Për dokumentin përkatës tek kolona Shteti/DTA, referojuni versionit në gj. angleze dhe serbe
Finlanda	SFR Jugosllavia: përaf. 1987 RKS: 08.09.2011	Shih traktatin Finlandez seritë 60/1987
Gjermania	SFR Jugosllavia: 26.05.1983 RKS: 02.04.2010	Për dokumentin në gj. serbe tek kolona MTA, referojuni versionit në gj. Serbe
Holanda	SFR Jugosllavia: 06.02.1983	Aplikimi i njëanshëm nga Kosova dhe Holanda
		Dok. i aplikimit HL.
Hungaria	12.03.2014	E aplikueshme prej 1.1.2015
Maqedonia	11.04.2013	E aplikueshme prej 1.1.2014
Sllovenia	18.06.2015	E zbatueshme nga 1.1.2015
Shqipëria	11.03.2015	
		E aplikueshme nga 01.01.2016

Burimi: www.atk-ks.org

4.13. Përmbledhja për kapitullin


Në këtë kapitull kemi hulumtuar dhe analizuar me thellë sistemin tatimor në Kosovë. Janë shtjelluar formimi i institucioneve fiskale në periudhën e pasluftës, sistemit tatimorë, vështirësitë që kanë përcjellë formimin e autoritetit tatimor dhe reformën tatimorë. Baza e themelimit të sistemit tatimor daton që nga viti 2000, themeluar nga administrata e Kombeve të Bashkuara, për tu pavarësuar më vonë në vitin 2008 nga institucionet pavarura të Republikës së Kosovës. Janë marrë të dhëna mbi kategoritë tjera për të hyrat publike në buxhetin e Kosovës dhe strukturën e tyre. Të hyrat tjera publike si ato nga dogana, taksat komunale, tatimi në pronë dhe të hyrat tjera të cilat krijojnë buxhetin janë analizuar që nga definicioni i tyre deri tek niveli i përmbushjeve. Janë identifikuar tatimet e drejtpërdrejta dhe ato indirekte, pjesëmarrja e tyre në strukturën e përgjithshme në të hyrat dhe llojet e tatimeve në nivelin qendror dhe lokal. Roli dhe rëndësia e tatimeve në të hyrat publike, rezultatet, sfidat e administrimit të tatimeve dhe problemet me të cilat, në periudha të ndryshme është ballafaquar sistemi tatimor. Janë përshkruar të gjitha rregullat dhe ligjet të cilat rregullojnë funksionimin e sistemit tatimor, dispozitat e funksionimit dhe të metat e sistemit. Shkallët tatimore të Tatimit të Vlerës së Shtuar, TAP, TK, TMB dhe kontributeve pensionale. Duke hulumtuar sistemin tatimor evropian dhe atë rajonal është krijuar mundësia e rangimit të sistemit tatimor në nivel ndërkombëtarë, që karakterizohet me rregulla e ligje të harmonizuar por jo edhe me praktika të mira të administrimit.

Gjithashtu janë bërë hulumtime dhe nxjerrë informatat mbi bashkëpunimin ndërkombëtarë të Kosovës dhe marrëveshjet e nënshkruara nga Administrata Tatimore Kosovës me shtete tjera për eliminimin e pagesës së dyfishtë të tatimit.

Kapitulli V - Trendet e të Hyrave Tatimore në Kosovë

5.1. Pjesëmarrja e Tatimeve në PBB dhe Buxhetin e Kosovës

Republika e Kosovës si shtet i ri në Evropë ka kaluar nëpër sfida të vështira në konsolidimin e saj financiar dhe buxhetor. E përkrahur nga faktori ndërkombëtar, institucionet financiare ndërkombëtare, Kosova arriti që të ndërtojë një stabilitet relativ fiskal edhe pas krizës globale financiare. Rritja reale ekonomike ka rezultuar të jetë mbi mesatare për shkak të investimeve dhe konsumit të lartë në periudhën e pasluftës. Rritja mesatare reale për periudhën 2005 deri 2014 ishte 5.2 % (FMN, 2012) e cila realisht tejkalon mesataren në Evropën Juglindore (EJL) 3.2 % Banka Botërore, 2013). Ndryshimet e rritjes reale të ekonomisë nëpër vite për periudhën 2004 deri 2013 në grafikun në vijim.



Grafiku nr.2 - Ecuria e rritjes reale të ekonomisë në periudha 2004-2014
Burimi: ASK, Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare

Produkti i Brendshëm Bruto nominal i Kosovës nuk arriti të ngrihej në nivelin e vendeve fqinje.

PBB nominal në Kosovë arriti në 4.7 miliardë Euro, krahasuar me vendet e rajonit e cila sillet p. sh. në Maqedoni 7.4. Trendi i PBB u ngadalësua prej 7% në vitin 2008 në

3% në vitin 2009.

Produkti i brendshëm bruto ne vitet 2005-2007 u rrite vetëm per 3.9 % dhe 11.01% derisa ne shume absolute, në vitin 2008 ishte 3.9 Miliardë Euro dhe kishte rritje graduale prej 10.82 në vitin 2010 mandej 5.07 % në vitin 2012 dhe së fundi në vitin

2014 në raport me një vit më parë kishte rritje në shkallën 4.42%. dhe arrin vlerën 5.56 Miliard Euro.


Tabela nr.12

Trendi i PBB në periudhën 2005-2014

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
BPV me										
çmime	3,003	3,120	3,460	3,883	4,070	4,402	4,815	5,059	5,327	5,567
aktuale										

Burimi : Raporti i Bankës Botërore

Megjithatë një element tjetër me rëndësi në rritjen ekonomike dhe mirëqenien e popullatës është produkti brendshem bruto për kokë banori i cili në Kosovë ende mbetet larg mesatares së vendeve të rajonit.




Grafiku nr.3 - Lëvizja e PBB nëpër vite.

Burimi: ASK. 2006-2014 përpunuar nga autori

Ky tregues na paraqet nivelin e të ardhurave të përgjithshme të një vendi ndaj qytetarëve të vet, raportin e zhvillimit ekonomik dhe numrin e popullatës etj

Trendi i lëvizjes së këtij treguesi ishte po ashtu i ngadaltë prej 2,258 Euro në vitin 2008 në 3,084 Euro në vitin 2014 që në total na jep një rritje prej 37 % por mesatarja e rritjes nëpër vite është vetëm 4.63 %

Produkti bruto për kokë banori është rritur ndjeshëm në dhjetëvjetëshin e fundit deri 25 %, pasuar nga rritja e pagave në sektorin publik të cilat shënuan rritje deri 60 %



Grafiku nr.4 - PBB për kokë banori 2008 - 2014

Burimi: Banka Botërore (Indikatorët e Zhvillimit Botëror)

Kushtet për zhvillimin ekonomik dhe biznesit po përmirësohen prej viti në vit edhe pse ende paraqet probleme në fushat e financimit të biznesit dhe kushtet e pavolitshme në kreditim.

Sipas raportit të Bankës Botërore, që nga viti 2013, në indeksin e të bërit biznes, Kosova është radhitur në vendin e 98-të nga 185 vende të botës. (Raporti i Bankës Botërore 2014)

Në rrugëtimin e krijimit të sistemit të mirëfilltë tatimor vendi kaloi nëpër reforma të cilat nuk ishin gjithnjë efikase. Sistemi tatimor është një sektor ndër më të rëndësishmit

në shtyllën e qeverisë, në funksion të krijimit të buxhetit shtetëror.

Megjithatë, rruga e reformave dhe krijimi i një sistemi efikas tatimor është mjaft i vështirë dhe jo i thjeshtë, posaçërisht kur Kosova është në hapat fillestarë të integritetit në rrethin global.

Funksionimi i sistemit tatimor është me ndikim të madh jo vetëm si krijues i të hyrave publike qeveritare, por edhe si faktor ndikues në fuqinë ekonomike të bizneseve, kur dihet se një pjesë e fitimeve të tyre ndahet për të paguar tatimet për shtetin. Kjo njëherazi ndikon edhe në vendimmarrjen e bizneseve në planet afatshkurtra.

Ndikimi i tatimeve prek edhe konsumatorët dhe qytetarët në dy drejtime:

- Rritja e çmimeve të artikujve për vlerën e tatimeve dhe
- Nxitja e konsumatorëve(qytetarëve) për të punuar dhe fituar më shumë në emër të kompensimit të kësaj pjese të shpenzimeve ekstra për shtetin.

Qëllimi bazë i mbledhjes së tatimeve është mbulimi i shpenzimeve të cilat qeveria do t'i bëjë në emër të funksionit të shtetit, infrastrukturën si bazë për zhvillim dhe ngritjen e mirëqenies sociale. Prandaj edhe reformat fiskale e tatimore duhet orientuar në drejtim përshtatjes së tyre me interesat e ekonomisë së tregut.

Të ardhurat publike mbledhen kryesisht prej burimeve vendore përmes administratës tatimore të Kosovës dhe taksat doganore përmes Doganës së Kosovës.

Të hyrat tatimore inkasohen nga disa lloje të tatimeve të cilat i kemi përmendur në kapitujt me herët si tatimi i paragjykuar dhe tatimi në fitim të aplikueshëm prej vitit

2000 deri në vitin 2004 për t'u zëvendësuar me tatimin në të ardhurat personale e

Tatimin në korporatë dhe tatimi në vlerën e shtuar të zbatueshëm prej vitit 2005.

Numri i ndërmarrjeve dhe tatimpaguesve është rritur shumë në vitet e para të pasluftës, derisa në pesë vjetorin e fundit ky numër vjen duke u zvogëluar për shkak të vështirësive në bërjen biznes dhe kushteve të tregut në Kosovë.

Kategorizimi i ndërmarrjeve, bëhet sipas standardeve ndërkombëtare duke marrë

parasysh numrin e punëtorëve , vlerën e aseteve dhe nivelin e shitjeve apo xhiros nëpër vite.

Sipas xhiros vjetore (qarkullimit) të bizneseve aktive dhe pjesëmarrjes së tyre në krijimin e Produktit të brendshëm Bruto PBB, në tabelën në vazhdim do shohim strukturën e kësaj përbërje.

Tabela nr.13

Qarkullimi vjetor sipas madhësisë së Ndërmarrjes dhe Pjesës së PBB-së

Madhësia e Ndërmarrjes	Numri i Ndërmarrjeve	Qarkullimi (€)	Pjesa e BPV-së (%)
Mikro	14,968	656,885,164.33	16.79
Të Vogla	1210	667,585,914.82	17.07
Të Mesme	185	369,455,655.16	9.44
Të Mëdha	58	528,558,359.84	13.51
Gjithsej	16,421	2,222,485,094.15	56.81

Burimi: Autori

Nga tabela shohim se një numër i vogël i ndërmarrjeve të mëdha 58 marrin pjesë me 56.81 % në krijimin e PBB-së derisa ndërmarrjet e mesme dhe të vogla me 17.07% dhe 9.44 % të PBB. Një përqindje të konsiderueshme prej 16.79 % të produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në vend përbëjnë ndërmarrjet mikro.


Bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të paraqitura në tabelën e mësipërme, totali i qarkullimit të NVM-ve në vitin 2010 ishte 1.693 milionë euro ose 43.3 % e PBB-së. Qarkullimi total i të gjitha bizneseve duke përfshirë edhe bizneset e mëdha ishte 2,222 milionë apo 56.81% e PBB-së.

Të ardhurat tatimore sipas viteve janë rritur në mënyrë progresive në vitet 2000-2005 derisa në dhjetëvjetëshin e fundit 2005-2014 ka pasur një rritje më të vogël të tati-

meve nga viti në vit. Rritja në vitin 2007 ka qenë 30 % , për të pasuar me rritjen prej 12.5 % në vitin 2007. Rritje më të ulëta ka pasur në vitet 2012 për vetëm 9 % , në vitin 2013 rritja ishte 7.9 % në krahasim me vitin 2012 dhe në vitin e fundit 2014 kishte një ulje e të hyrave për 0.60%

Një rënie e tillë kishte ndodhur edhe në vitin 2009 në raport me vitin 2008 për shkallën prej 1.75% si rezultat i reformave në zvogëlimin e shkallës tatimore për Tatimin në fitim dhe tatimin në fitim për korporata prej 20% në 10%.

Në vijim po paraqesim lëvizjen e të ardhurave tatimore në Kosovë për periudhën 2005- 2014.



Grafiku nr.5 - Ecuria e tatimeve vendore në vitet 2005-2014 në euro
Burimi: Raportet e Buxhetit të Kosovës 2005-2014 përmbledhur nga autori.

Duke analizuar kërkimet për vërtetimin e hipotezës së punimit tonë, dhe variablat ndërlidhëse nga të dhënat dytësore, deklaratimet vullnetare në pagesën e tatimit të tyre si dhe disponimin e tatimpaguesve për tu përgjigjur obligimeve ligjore ndaj shtetit, shihet se ekziston gatishmëri për pagesën e tatimeve. Me vetë faktin se brenda viti 2014 kemi mbi një milion deklarata të vet deklaruar të tatimpaguesve tregon një vetëdijësim dhe gatishmëri për pagesën e tatimeve ndaj buxhetit të Kosovës.


Megjithëse në aspektin sasior ky numër nuk paraqet një rezultat cilësor të kënaqshëm sepse një tatimpagues mesatarisht paraqet mbi 30 deklarata brenda një viti. Këtë korrelacion të deklarimeve vullnetare e zbeh vlera e tatimit shtesë me kontrolle dhe gjobat e shqiptuara ndaj bizneseve, që gjatë një viti ishin mbi nëntë mijë apo më saktë

9,059 gjoba, apo kalkuluar më detajisht, kundrejt 63,016 bizneseve të vizituara janë ndëshkuar mesatarisht 14.38 % e bizneseve. Numri i kontrolleve me vlerësime tatimore ka qenë 892 përkundër planit prej 1,189 apo mos realizim të planit për 25 % , kane efekte me 44 milion euro tatim shtesë për vitin 2013 ose me 14.43% të të ardhurave të përgjithshme. Efekti nga vizitat dhe analizat financiare të cilat janë realisht kontrolle por me emërtime të modifikuara është 43 milionë euro apo 14 % tjetër tatim shtesë për tatimpaguesit duke ju atribuuar deklarimit vullnetar. Së bashku kjo përqindje arrin në shkallën 29 % të arkëtimeve nga tatimet është produkt i vlerësimeve nga zyrtaret tatimorë .

Ekziston një dukuri e faktuar se tatimi shtesë me kontroll paguhet më shumë vështirësi, derisa pagesat nga deklarimet kane një realizim më të madh të përmbushjes tatimore.

Kjo dukuri paraqitet për tri arsye; vlerësimi jo real i tatimit shtesë, ndëshkimeve të larta dhe mosgatishmërinë e tatimpaguesve për pagesa të tatimeve me ndëshkime.

Në grafikonin vijues, paraqesim lëvizjen e të ardhurave të rregullta tatimore dhe të ardhurave pasuar me kontroll dhe vizita të zyrtarëve tatimorë.



Grafiku nr.6 - Të hyrat nga tatimet në krahasim me tatimin shtesë nga kontrolli
Burimi: Raporti i punës në ATK 2014

Po ashtu numri i ankesave ndaj vendimeve të zyrtarëve tatimor që brenda viti 2013 ishte 433, që tregon për nivelin e pakënaqësive dhe besimit ndaj vlerësimeve që bën administrata e tatimeve ndaj tatimpaguesve. Sipas kësaj, pjese e konsiderueshme e vlerësimeve të administratës tatimore janë kundërshtuar nga tatimpaguesit apo krahasuar me numrin kontrolleve të kryera 892 bie se 48.55 % të tatimpaguesve kanë ushtruar kundërshtim apo çdo i dyti vlerësim nga ATK është kundërshtuar.

Përmbushja tatimor tatimore ka pasur oscilime të mëdha, pasi që në vitet e para kemi pas një rritje më të madhe të ardhurave tatimore, mbi 95 % nga viti 2005 deri në vitin 2007, për të vazhduar me rritje.

Përmbushja tatimore është term i cili nënkupton nivelin e realizimit apo mos realizimit të planeve dhe projeksioneve të shtetit e qeverisë në lëmin e tatimeve dhe taksave të tjera. Përmbushja nënkupton edhe nivelin e kryerjes së obligimeve tatimore të qytetarëve sipas legjislacionit në fuqi të një shteti.

Kjo do të thotë se ka një mori faktorësh të cilët ndikojnë në nivelin e përmbushjes tatimore apo mospërmbushjes së saj. Pjesa e detyrimeve tatimore si burim nga të

ardhurat e realizuara të obliguesve tatimorë që nuk mund të mblidhet, konsiderohen si detyrime të pashlyera por edhe si evazion fiskal.

Ndonëse obligimet tatimore të papaguara dhe ekonomia informale dëmton buxhetin e

Kosovës, këto janë pjese e rëndësishme e ekonomisë dhe e produktit vendor bruto.

Mos pagesa e detyrimeve tatimore krijon pabarazi ndërmjet bizneseve dhe qytetarëve sepse përderisa njëra pjesë shpenzon për kryerjen e obligimeve tatimore, të tjerët do të përfitojnë nga ky mashtrim tatimor.

Përveç vlerave bruto të të hyrave tatimore ato specifikohen edhe sipas llojeve të tatimit të cilat i kemi cekur në kapitujt më lartë. Historiku i tatimeve ka treguar se në vitet 2001 deri në vitin 2005 sistemi tatimor ka funksionuar me tatimin e paragjykuar dhe tatimin në fitim si tatim direkt dhe Tatimin e Vlerës së Shtuar TVSH, si tatim indirekt i aplikueshëm prej vitit 2001. Të hyrat nga këto lloje të tatimeve kanë qenë simbolike në krahasim me të hyrat nga dogana që përbënin në atë kohe pjesën kryesore të buxhetit. Në vitin 2005 pjesëmarrja e tatimeve të brendshme ishte vetëm 21% të buxhetit të Kosovës.

Pjesa më relevante e të hyrës tatimore përbëhej nga TVSH-ja në masën 45% dhe tatimi në paga prej 35%. Kjo strukturë e llojeve të tatimit ndryshon pas vitit 2005 me reformën thjeshtë tatimore duke zëvendësuar tatimin e paragjykuar dhe tatimin në fitim me tatimin në të ardhurat personale dhe tatimin në fitimin e korporatës. Dinamika e të hyrave tatimore ngritet posaçërisht në vitin 2008 dhe 2012 me kryesimin e tatimit të vlerës së shtuar.

Tabela nr.14

Trendi i të hyrave tatimore sipas llojeve të tatimit për periudhën 2005-2014

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Tatimi i paragjykuar	6,716,350	2,272,000	997,120	1,328,496	2,722,463	443,427	875,347	406,839	70,831	157,832
Tatimi në fitim	12,667,450	9,380,000	36,370,241	4,425,845	7,731,182	466,612	1,805,885	117,480	163,273	15,513
Tatimi mbi vlerën e shtuar	46,353,600	47,772,000	58,783,640	59,023,406	83,198,697	113,046,863	122,327,310	131,394,869	149,184,989	136,939,023
Tatimi në paga-mbajturi në burim	36,189,314	29,106,000	16,034,300	43,524,149	36,356,966	33,710,926	56,075,975	60,752,691	61,962,028	67,857,126
Tatimi për biznese individuale	x	15011000	33,968,700	18,751,632	24,680,746	25,762,265	23,689,318	26,202,558	28,309,705	32,922,697
Interes, Qira, drejta pronësore, etj	x	5789000	1,966,600	1,793,402	15,715,532	11,741,417	1,385,580	1,648,728	1,650,280	104,999,342
Tatimi në korporata	x	20016960	53,728,154	64,982,380	36,275,987	36,414,344	54,963,748	63,372,768	64,110,827	55,303,459
Gjithsej	101,926,714	167,377,000	201,848,755	222,158,897	206,683,582	221,587,864	261,123,163	283,898,932	305,451,932	398,194,992


Burimi: Raporti i punës së ATK-së 2006-2014 – përpunuar nga autori

Të ardhurat tatimore e përbejnë kryesisht tatimi në vlerën e shtuar, tatimi në të ardhurat individuale dhe tatimi në korporata. Tatimi në vlerën e shtuar si tatim në konsum mbledhet në bazë të shitjes dhe konsumit vendor, megjithatë i njëjti mbledhet edhe me rastin i importimit të mallrave përmes doganës. Kjo shumë e mbledhur e tatimit është e zbritshme për pjesën e paguar gjatë blerjeve me rastin e rekapitullimit të shitblerjeve mujore. Në vitin 2011 ky lloj tatimi përbënte 47 % të shumës së tërësishme të tatimeve derisa në vitin 2012 46.4 % dhe në vitin 2014 49 %

Tabela nr.15

Niveli i të hyrave për tri llojet kryesore të tatimeve 2005 - 2014


	2005	2007	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Tatimi mbi vleren e shtuar	46,353,600	58,783,000	83,198,697	113,046,863	122,327,310	131,394,869	149,184,989	136,939,023
Tatimi per biznese individuale	19,383,800	33,968,540	24,680,746	25,762,265	23,689,318	26,202,558	28,309,705	32,922,697
Tatimi ne korporata	X	53,728,125	36,275,987	36,414,344	54,963,748	63,372,768	64,110,827	55,303,459

Burimi : Punuar nga autori

Grafiku nr.7 - Pjesëmarrja e tri tatimeve kryesore në të hyrat tatimore vitet 2005-2014

Burimi: Llogaritë financiare të Kosovës – Buxheti

Trendi i të ardhurave nga tatimet si dhe kontributet pensionale për periudhën trevjeçar 2011 deri 2013, në të cilën shihet se kemi rritje minimale prej viti në vit deri në 8%, që nuk ishte karakteristike për dhjetëvjetëshin e fundit, tregojnë se të ardhurat janë rritur prej 10 deri 30 %. Në vazhdim po japim strukturën e mbledhjes së tatimeve dhe kontributeve nga administrata tatimore e Kosovës në vitin vijues 2014, për të parë aktualisht performancën e sistemit tatimor dhe realizimet e përmblshme.



Grafiku nr.8 - Struktura e të hyrave nga tatimet dhe pensionet në vitin 2014

Burimi (autori në bazë të tabelave më lartë)

Administrimi i tatimeve është e organizuar sipas ndarjes territoriale nëpër nëntë regjione në Kosovë. Njësia e tatimpaguesve të mëdhenj , tri regjione në Prishtinë, Prizren, Pejë ,Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj.

Të ardhurat e realizuara sipas regjioneve në Kosovë i atribuohen zyrës qendrore dhe kanë karakter të tatimeve qendrore . Rol dominues në krijimin dhe mbledhjen e të hyrave që në të shumtën e rasteve rezulton nga deklarimi i tatimpaguesve në njësinë e tatimpaguesve të mëdhenj që për shembull në vitin 2013 përbën pjesëmarrjen me 60.77% apo regjionit më pak inkasime Gjakova që ka pjesëmarrje me vetëm 1.44 %

Tabela nr.16

Të hyrat e realizuara për tri vitet e fundit dhe pjesëmarrja e secilit regjion në krijimin e të hyrave tatimore

Regjioni	Të hyrat sipas viteve			
	2011 1	2012 2	2013 3	2014 4
NJTM	160,701,695	175,976,737	185,620,941	172,821,297
Prishtinë 1	53,175,428	38,880,836	43,310,796	49,496,551
Prishtinë 2	11,331,930	12,143,160	13,641,608	14,651,325
Prishtinë 3	-	19,846,765	21,720,889	22,377,773
Gjilan	5,325,273	5,314,725	6,111,354	6,411,361
Ferizaj	6,286,035	5,902,901	6,683,880	7,616,891
Prizreni	9,403,157	11,050,468	12,330,189	12,918,556
Gjakovë	3,539,389	3,786,905	4,406,803	4,180,898
Pejë	6,694,811	6,499,944	6,543,024	7,793,916
Mitrovicë	4,665,445	4,496,491	5,082,447	5,426,422
Totali	261,123,163	283,898,932	305,451,932	303,694,991

Burimi : Raporti vjetor i ATK-së 2011-2014

Krijimi i të ardhurave tatimore që nënkupton gjithë aktivitetin e punonjësve të administratës tatimore përcillet me shpenzime të nevojshme për funksionimin e kësaj nomenklature të shtetit. Ndër parimet e kësaj administrate është që tatimet të mbledhen në mënyrë sa më eficiente dhe më pak shpenzime . Kjo nënkupton koston e krijuar gjatë edukimit të tatimpaguesve, kontrollit të vlerësimit dhe mbledhjen e tatimeve në Republikën e Kosovës. Krahas këtyre shpenzimeve janë edhe rezultatet apo efektet e përmbushjeve buxhetore. Ecuria e këtyre shpenzimeve është variabile dhe varet prej disa faktorëve e rol dominues kanë pagat e punonjësve mallrat e shërbimet. Kostoja e vlerave përlllog-


aritet duke përpjesëtuar shumën e të hyrave të inkasuara me shpenzimet e krijuara për mbledhjen e tyre.

Tabela nr.17

Kostoja e mbledhjes së tatimeve

Viti (tatimet+ kontributet pensionale Shpenzimet e ATK)	Kostoja e vlerave të trajtuara		Vlerat e trajtuara nga ATK (tatimet+kontributet pensionale + TVSH e kredituar e paguar në importe)		Kostoja e vlerave të trajtuara
	për çdo 100 €/njësi				për çdo 100€/njësi
1	2	3	4=3/2*100	5	6=3/5*100
2009	289,437,637	6,300,127	2.18	597,439,917	1.05
2010	315,807,443	6,533,986	2.07	657,255,565	0.99
2011	369,150,865	6,722,757	1.82	765,564,133	0.88
2012	393,151,926	7,426,107	1.89	792,823,825	0.94
2013	425,262,541	7,616,788	1.79	820,405,756	0.93
2014	434,272,560	8,076,754	<u>1.86</u>	836,654,991	0.97

Burimi : www.atk-ks.org




Grafiku nr.9 - Raporti i Ankesave ndaj kontrollit

Burimi: Raporti i punës së ATK-së 2014

Rastet tjera të ndjekjeve penale për shmangie nga tatimi që nuk janë me numër të konsiderueshëm përbënë fakte tjera që forcojnë gjasën për vërtetimin hipotezës së dytë.

Niveli i ekonomisë informale në masë 35% të produktit të brendshëm bruto dhe evazionit fiskal që sipas të dhënave arrin në masë deri 30%, është një tregues tjetër i mos efikasitetit të qeverisë për mbledhjen e tatimeve dhe rritjen e buxhetit të shtetit. Masat e politikës fiskale nuk janë përmirësuar në nivelin e dëshirueshëm për shtimin e pagesës së tatimeve edhe pse kishte disa lehtësime në shkallët tatimore dhe lirimin nga pagesa e TVSH-së për një pjesë të gjysmë produkteve dhe makinerisë në pesë vjetarin e fundit (2014).


Në tre vitet e fundit nuk ka pasur ndonjë masë esenciale të politikave fiskale. Qeveria ka përcaktuar plane të ulëta buxhetore për të siguruar një realizim buxheti të thjeshtë edhe pse shpenzimet e buxhetit ishin të rritura për investime kapitale, që kishte për pasojë kriza asociale në shumë sektorë. Zhvillimi ekonomik me theks të posaçëm, investimet në prodhim dhe bujqësi ishin tejet të ulëta që ndikoi dukshëm në nivelin e rritur të pa punëve.



Grafiku nr.10 - Shpenzimet publike në buxhetin e RK

Burimi: Autori

Buxheti i shtetit i përqendruar në shpenzimet kapitale dhe konsum-paga, mallra e shërbime ndikoi që edhe tatimpaguesit të humbin besimin në pagesën e obligimeve ligjore. Ky mos disponim vjen edhe për shkak të pengesave tjera që biznesin e përcjellin gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe para regjistrimit të tyre si 1. kontratat e dështuara, 2. kushtet e financimit të biznesit, 3. Taksat e larta, 4 niveli i subvencioneve, 5 korrupsioni, 6 mosfunksionimi i gjyqësorit, 7 shpenzimet e larta në kamatat bankare dhe kushtet e pafavorshme të kreditimit etj.



Grafiku nr.11 - Niveli i pengesave të bërit biznes 2010-2013

Burimi(Autori në bazë të shënimeve nga materiali Klima e biznesit në Kosovë)

Niveli i mbledhjes së borxheve dhe borxhet e grumbulluara të tatimeve në vlerë prej mbi 350 milionë euro shpreh një mos efikasitet tjetër të sistemit tatimor. Vlerë e konsiderueshme e këtyre borxheve janë parashkruar sipas ligjeve në fuqi dhe pasojë e menaxhimit jo të mirë të ATK-së dhe të njëjtat kanë mbetur pa u shlyer. ATK vazhdon të ketë kosto të lartë të menaxhimit dhe administrimit të tatimeve.

Të dhënat për deklaratimet vullnetare na japin një fije shprese për vërtetimin e hipotezës sonë mbi disponimin dhe vullnetin e tatimpaguesve për kryerjen e obligimeve

të tyre tatimore, për faktin se mbi nëntëdhjetë mijë deklarata vullnetare në vitin 2013 janë përpunuar në serverin e tatimeve, që tregon gatishmërinë e tatimpaguesve të regjistruar për pagesën e tatimeve. Mirëpo analiza që kemi bërë duke krahasuar vlerën e këtyre deklarimeve, pagesën e tatimeve dhe vlerësimet shtesë nga kontrolli, na vërteton hipotezën tonë se ka nevojë për reformim të sistemit tatimor dhe pikërisht atë në domenin e përcaktuar në punimin tim doktoral, qasjen e re ndaj tatimpaguesit.

Kjo mënyrë e menaxhimit me tatimet dhe kostot e krijuara për funksionim tregojnë se në sistemin tatimor të Kosovës ka nevojë për reformë tatimore dhe politikën fiskale në përgjithësi. Ky ndryshim duhet të jetë profesional dhe përmbajtjesor si në metodën e qasjes ndaj tatimpaguesve po ashtu edhe në ofertën e politikës fiskale në Republikën e Kosovës.

Këto të dhëna na ndihmojnë dhe shpijnë drejt vërtetimit të hipotezës së dytë se një reformimi të sistemit fiskal, drejt menaxhimit më të mirë, i cili do të inkurajojë tatimpaguesit dhe do të rrisë të hyrat tatimore në buxhetin e Kosovës.

Kosto e vlerave të trajtuara për 100 €/njësi

5.2. Operativa dhe Kontrolllet

Kontrollet e realizuara në vitin 2013, prej të cilave buron tatimi shtesë, kanë efektin e tyre përmbajtjesor në të hyrën tatimore, duke i krahasuar me deklarimet vullnetare të tatimpaguesve që njëherë tregon dallimin në mes të deklarimeve vullnetare dhe vlerësimeve të administratës tatimore. Kjo mund të ishte edhe një prej parametrave të evazionit fiskal në kuptim të ngushtë. Tabela në vazhdim tregon numrin e kontrolleve të planifikuara gjatë vitit 2013 realizimi i tyre tatimi shtesë, dhe krahasimet e planit. Administrimi i tatimeve me gjithë vetëdijen e një pjese të tatimpaguesve kërkon angazhim dhe përpjekje të vazhdueshme të personelit të qeverisë, respektivisht administratës së tatimeve. Pjesë e veçantë e të vërtetuarit të deklarimeve të tatimpaguesve dhe mos deklaruesve do jetë procesi i kontrollit tatimor, i cili me punën operacioneve, në

të shumtën e rasteve në terren, do të ballafaqohet me vlera shtesë të shitjeve dhe shpenzime të paarsyeshme në regjistrimet e bizneseve. Në bazë të këtyre të gjeturave, zyrtarët tatimorë do të përcaktojnë vlera të reja të tatimeve të shoqëruara me ndëshkime përkatëse ligjore.

Tabela nr.18

Ecuria e kontrolleve dhe krahasimi në mes viteve 2012/2014

Regjioni	Numri kontrolleve 2013 (plani)	Realizimi -numri kontrolleve 2013	Realizimi-numri kontrolleve 2012	Krahasimi realizim/plan	Tatimi shtesë 2013	Tatimi shtesë 2012	Krahasimi 2013/2012
1	2	3	4	5=3/2	7	8	9=7/8
NJTM	92	89	81	96.74%	14,676,809	13,436,487	109.23%
Prishtinë 1	147	96	75	65.31%	4,509,488	2,966,662	152.01%
Prishtinë 2	113	68	39	60.18%	4,698,952	1,835,679	255.98%
Prishtinë 3	130	97	63	74.62%	6,302,796	1,842,541	342.07%
Gjilan	130	93	104	71.54%	5,386,012	4,038,689	133.36%
Ferizaj	126	79	118	62.70%	1,763,550	1,645,413	107.18%
Prizren	182	192	225	105.49%	2,625,323	2,652,755	98.97%
Gjakovë	43	27	32	62.79%	1,591,585	1,755,212	90.68%
Pejë	126	105	96	83.33%	1,931,572	910,717	212.09%
Mitrovicë	100	46	57	46.00%	511,942	553,443	92.50%
Gjithsej	1,189	892	890	75.02%	43,998,031	31,637,600	139.07%

Burimi : Raporti vjetor i ATK 2014

Me detajisht kontrollet e realizuara në vitin 2014 dhe plani i realizuar në normë inspektori dhe efektet sipas regjioneve, rezultatet nga kontrolli tatimet shtesë dhe ndëshkimet përcjellëse, pjesëmarrja në total , numrin e kontrolleve sipas regjioneve dhe mesatarja e kontrolleve për kokë inspektori.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet se regjioni NJTM ka realizime më të mëdha në proces të kontrollit, dhe kjo për shkak se kjo njësi administrative menaxhon bizneset e mëdha në Republikën e Kosovës. Megjithatë në kuadër të regjioneve tjera si Prishtinë 3

me 103.5% dhe regjioni Pejë me 113.3% kanë pasur realizimet më të kënaqshme të planit.

Në regjionet tjera shihen rezultate të mira por edhe ngecje të dukshme të disa regjioneve.

Ngecjet më të mëdha në realizimin e planit vjetor p.sh ishin tek regjioni Mitrovicë, vetëm 75% si regjion me vështirësi për shtrirjen e kontrollit në të gjitha bizneset.

Tabela nr.19

Rezultatet nga kontrolli i zyrtarëve tatimor në teren

Regjioni	Kontrollet e planifikuar a 2014	Inspektor ë tatimor	Plani për Inspekto r	Kontrolle t e realizuara 2014	Mesatarja e kontrollav e për	Krahasimi realizim/pla n 2014
1	2	3	4=2/3	5	6=5/3	7=5/2
DTM	93	34	2.7	97	2.9	104.4%
Prishtinë	124	30	4.1	123	4.1	99.2%
Prishtinë	105	27	3.9	109	4.0	103.8%
Prishtinë	128	31	4.1	135	4.4	105.5%
Gjilan	113	32	3.5	98	3.1	86.7%
Ferizaj	98	29	3.4	90	3.1	91.8%
Prizren	154	42	3.7	183	4.4	118.8%
Gjakovë	37	9	4.1	37	4.1	100.0%
Pejë	105	31	3.4	119	3.8	113.3%
Mitrovic	86	26	3.3	65	2.5	75.6%
Gjithsej	1,043	291	3.6	1,056	3.6	101.3%

Burimi : Raporti vjetor i ATK-së 2013 - 2014

5.3. Aktivitetet Përmbushëse të Administratës Tatimore

Aktivitetet tjera përmbushëse operative janë vizitat spontane për rregullsinë e librave dhe regjistrimeve, gjendjen e stoqeve, mallit pa prejardhje prej të cilave rrjedh tatimi shtesë dhe në shumicën e rasteve edhe gjoba mandatorë të cilat për vitin e fundit 2013 kanë pasur këtë rezultat. Numri më i madh i gjobave është shqiptuar në regjionin e Prizrenit 2285 , derisa numër me i vogël në Gjakove vetëm 301 syresh, që kanë një hapësirë të vogël gjeografike, por me diferencë në numër të bizneseve.

Tabela nr.20

Numri i vizitave, gjobave dhe efekteve në tatim shtesë

Regionet	Totali i vizitave	Nr. i gjobave mandator	Vlera e gjobave mandator	Vlera e mallit pa prejardhje	Ndëshkimi për mallin pa prejardh. 25 %	Mungesa në stoqe	Qarkullimi shtesë	Tatimi shtesë	Ujja e kreditimit	Zvogëlim i humbjes	Rezultate nga vizitat
NJTM	1,831	261	236,725	268,854	67,213	2,532,610	16,252,211	2,084,139	1,382,659	1,323,515	4,790,313
Prishtinë 1	8,936	1,169	310,325	155,493	38,873	4,729,188	52,723,730	1,828,005	2,033,073	2,476,536	6,337,613
Prishtinë 2	6,621	673	174,525	62,594	15,648	2,291,972	43,494,813	2,690,458	741,714	2,916,874	6,349,046
Prishtinë 3	8,167	1,110	278,800	63,127	15,782	654,387	28,033,158	2,026,218	911,101	2,853,481	5,790,799
Gjilan	5,941	697	179,175	142,656	35,664	2,406,974	10,047,040	782,560	635,701	1,506,731	2,924,992
Ferizaj	6,886	771	188,900	43,445	10,861	3,831,374	15,977,727	627,434	1,046,398	1,573,373	3,247,205
Prizren	10,409	2,285	479,550	243,378	60,845	4,764,195	24,955,023	1,452,186	1,602,522	4,885,097	7,939,805
Gjakovë	2,817	301	95,875	137,440	34,360	2,183,693	6,531,242	392,799	235,356	721,029	1,349,184
Pejë	7,120	1,148	219,750	117,763	29,441	2,494,354	16,781,705	973,393	834,569	1,721,432	3,529,394
Mitrovicë	4,288	644	114,550	140,219	35,055	1,336,982	9,229,536	810,785	348,006	328,665	1,487,456
Totali	63,016	9,059	2,278,175	1,374,968	343,743	27,225,729	224,026,183	13,667,976	9,771,098	20,306,733	43,745,807

Burimi : Raporti vjetor i ATK 2014

Tabela nr.21

Gjobat në vitin 2013 dhe 2012 në specifikime të veçanta

Regjioni	Nr. i gjobave mandatarë 2013	Vlera e gjobave mandatorët 2013	Nr. i gjobave mandatarë 2012	Vlera e gjobave mandatorë 2012	Indeksi 2013/2012	Numri i gjobave për mallin pa prejardhje 2013	Vlera gjobave për mallin pa prejardhje 2013	Numri i gjobave për mallin pa prejardhje 2012	Vlera gjobave për mallin pa prejardhje 2012	Indeksi 2013/2012
1	2	3	4	5	6=2/4	7	8	9	10	11=7/9
NJTM	261	236,725	197	191,051	132.49%	20	67,213	20	126,257	100.00%
Prishtinë 1	1,169	310,325	1,172	347,167	99.74%	80	38,873	167	94,051	47.90%
Prishtinë 2	673	174,525	643	190,162	104.67%	39	15,648	49	50,959	79.59%
Prishtinë 3	1,110	278,800	951	247,695	116.72%	36	15,782	74	28,597	48.65%
Gjilan	697	179,175	670	200,570	104.03%	89	35,664	89	50,050	100.00%
Ferizaj	771	188,900	749	223,640	102.94%	36	10,861	43	30,862	83.72%
Prizren	2,285	479,550	1,677	406,000	136.26%	170	60,845	144	78,801	118.06%
Gjakovë	301	95,875	396	135,500	76.01%	51	34,360	43	15,575	118.60%
Pejë	1,148	219,750	805	222,248	142.61%	80	29,441	245	62,633	32.65%
Mitrovicë	644	114,550	531	140,377	121.28%	155	35,055	127	43,936	122.05%
Gjithsej	9,059	2,278,175	7,791	2,304,412	116.28%	756	343,743	1,001	581,726	75.52%

Burimi : Raporti vjetor i ATK-së 2014

Gjatë vitit 2014 janë realizuar 60,142 vizita përmbushëse, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2013 janë realizuar 63,016 vizita përmbushëse.

Numri i gjobave mandatare të lëshuara është 8,605 gjoba, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2013 kanë qenë 9,059 gjoba, d.m.th. në këtë vit kemi më pak në numër për 5.01 %.

Vlera e gjobave mandatare është 1,965,400 euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 2,287,175 euro, apo shprehur në përqindje 11.7% më pak.

Numri i gjobave për mallrat pa origjinë është 975 gjoba, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2013 janë lëshuar 756 gjoba apo 28.97 % më shumë.

Vlera e gjobave për mallrat pa origjinë është 357,202 euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte 343,743 euro, apo 3.99% më shumë.

Nga këto vizita, si rezultat i parregullsive është konstatuar qarkullim shtesë në vlerë prej 206.9 mil. euro, ndërsa në vitin 2013 ishte konstatuar 224.2 mil. euro, apo 7.64 % më pak, dhe si rezultat i këtij qarkullimi shtesë, për këtë periudhë kemi:

Tatim shtesë, 12.7 mil. euro

Ulje kreditimi në TVSh, 8.8 mil. euro

Zvogëlim humbje 18.2 mil. Euro

5.4. Aktivitetet Edukative dhe Administrative

ATK posedon sektorin e Shërbimit dhe Edukimit për tatimpagues me rol që t'i krijojë dhe zhvillojë politikat dhe procedurat lidhur me shërbimet e tatimpaguesve, ofrimin e shërbimeve për tatimpagues. Duke u përpjekur për të siguruar shërbime cilësore, profesionale, transparente dhe me kohë, ofrimin e formave dhe praktikave më të mira sipas ligjeve tatimore të aplikuara. Po ashtu funksion i veçantë është ofrimi i përkrahjes përmes krijimit të mundësive më të lehta të komunikimit dhe ofrimin e zgjidhjeve për problemet që mund të paraqiten.

Zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2014 ishin të fokusuar në këto fusha kyçe: Ristrukturimi i Divizionit të Procesimit, Zhvillimet në Qendrën e Thirrjeve, Menaxhimi i radhës së tatimpaguesve, EDI – deklarimi elektronik i tatimeve, Menaxhimi i aktiviteteve përmes modulit VKME, Organizimi i seminareve me tatimpagues, Lëshimi i vërtetimit elektronik për personat fizikë dhe shërbime të reja elektronike sic është zgjerimi i funksioneve të projektit EDI, edhe për tatimet tjera tremujore (IL, QL, IS, QS), Pranimi i kërkesave të tatimpaguesve për të hyrë në marrëveshje për pagesën e borxheve të prapambetura etj.

Tabela nr.22
Punë tjera administrative me tatimpaguesit

Lloji i shërbimit	NTM	Prishtina	Gjilan	Ferizaj	Prizreni	Gjakova	Peja	Mitrovica	Totali
Kërkesa	5,173	27,256	6,208	6,792	20,203	7,096	7,785	6,754	87,267
Njoftime	335	1,814	26	185	393	338	21	81	3,193
Protokollime/ Dorëzime	88	10,302	3,171	944	6,702	2,361	4,303	1,151	29,022
Kontribute pensionale	3	1,361	4,554	1,192	8,553	3,400	3,660	3,560	26,283
Punë të tjera	1,558	43,532	13,092	6,920	20,337	9,885	5,624	4,820	105,768
Këshilla ligjore	33	5,015	305	1,391	1,085	656	428	1,402	10,315
Certifikatat e krijuara	5	2,491	424	436	1,008	223	360	445	5,392
Vizita	0	0	144	239	5	0	0	141	529
TOTALI	7,195	91,771	27,924	18,099	58,286	23,959	22,181	18,354	267,770

Burimi : Raporti vjetor i ATK-së 2013

5.5. Fiskalizimi

Një segment tjetër i ndërtimit të sistemit fiskal në Kosovë përbën edhe procesin e fiskalizimit të destinuar për bizneset e shitjeve me pakicë, i cili ka filluar prej vitit 2006. Projektionet fillestare të këtij procesi kanë qenë larg realizimeve në kohën e duhur në terren. Numri i bizneseve në shitjet me pakicë përlllogaritej deri njëzetë e pesë mijë biznese, numër ky që edhe pas pesë viteve nuk është përmbushur. Tregues tjetër i realizimit të këtyre objektivave është se janë fiskalizuar shumica prej bizneseve të vogla derisa pikat e shitjes të bizneseve të mëdha kanë dështuar të pajisen me arka fiskale.

Tabela nr.23

Fiskalizimi në Kosovë deri në vitin 2014

Regjionet	Plani i fiskalizimit	Fiskalizimi	% e realizimit në raport	Gjobat e lëshuara	Vlera e gjobave	Vizitat e kryera
1	2	3	4=3/2	5	6	7
DTM	188	6	3.2%	49	31,625	246
Prishtinë 1	1557	439	28.2%	176	26,375	837
Prishtinë 2	752	223	29.7%	87	16,750	845
Prishtinë 3	967	236	24.4%	135	27,250	760
Gjilan	1057	212	20.1%	32	8,875	325
Ferizaj	1157	121	10.5%	28	5,250	404
Prizren	1771	314	17.7%	57	13,000	542
Gjakovë	623	95	15.2%	3	500	79
Pejë	715	293	41.0%	102	15,750	482
Mitrovicë	817	152	18.6%	61	8,500	457
Gjithsej	9,604	2,091	21.8%	730	153,875	4,977

Burimi : Raporti vjetor i ATK-së 2014


5.6. Borxhi Tatimor

Tabela nr.24

Borxhet dhe niveli i inkasimeve sipas regjioneve

Regjioni	Plani 2013	Inkasime2013	Struktura	Krahasimi me planin	Inkasime 2012	Struktura 2012	Krahasimi 2013/ 2012
1	2	3	4=3/Σ	5=3/2	6	7=6/ Σ	8=3/6
NJTM	8,916,590	18,376,282	42.36%	206.09%	16,795,739	45.42%	109.41%
Prishtinë 1	12,361,965	4,438,975	10.23%	35.91%	3,866,969	10.46%	114.79%
Prishtinë 2	5,587,695	3,056,004	7.04%	54.69%	2,491,881	6.74%	122.64%
Prishtinë 3	6,217,405	5,405,764	12.46%	86.95%	3283335	8.88%	164.64%
Gjilan	3,778,980	1,490,479	3.44%	39.44%	1,662,668	4.50%	89.64%
Ferizaj	4,993,985	2,157,017	4.97%	43.19%	1,956,070	5.29%	110.27%
Prizren	6,901,653	3,688,218	8.50%	53.44%	2,575,746	6.96%	143.19%
Gjakovë	2,809,174	1,465,870	3.38%	52.18%	1,200,605	3.25%	122.09%
Pejë	5,008,007	2,007,076	4.63%	40.08%	2,055,917	5.56%	97.62%
Mitrovicë	3,954,242	1,299,999	3.00%	32.88%	1,093,034	2.96%	118.93%
Gjithsej	60,529,696	43,385,684	100%	71.68%	36,981,964	5.29%	117.32%

Burimi : Raporti vjetor i ATK-së 2013



Grafiku nr.12 - Vlera e borxheve sipas regjioneve 2014

5.7. Rimbursimi dhe Kreditimi i TVSH-së

Tatimi i vlerës së shtuar si tatim indirekt është i paraparë të paguhet në konsum apo në shitje dhe si i tillë përkufizohet si tatim i përlogaritur për t'iu paguar shtetit për çdo muaj. Tatimpaguesit e këtij lloj tatimi janë të obliguar të paguajnë 16 % në shumën e shitjeve. Mirëpo duke qenë se këta tatimpagues paguajnë këtë lloj tatimi në vlerat e blerjes,

sipas sistemit tatimor në Kosovë, këto vlera janë të zbritshme në tërë shumën e tatimit të vlerës së shtuar të paguar në blerje. Në shumë prej këtyre rasteve raportet e tatimit të zbritshëm dhe tatimit të llogaritur (për pagim) janë në favor të tatimpaguesit, prandaj edhe na lind pozicioni i tatimpaguesit si kreditor në buxhetin e shtetit. Ky lloj kreditimi (tatimi i paguar me shumë se sa obligimi për pagesë) në bazë mujore mund të kthehet nga shteti në formë rimbursimi.

Tabela nr.25

Numri i kërkesave dhe aprovimeve për Rimbursim të tatimeve

Regjioni	Numri i kërkesave të aprovuara	Shuma e aprovuar	Obligimet në ATK	Shuma e transferuar në llogarinë e /p
NJTM	49	25,769,974	1,425,264	24,344,711
Prishtinë 1	37	1,501,314	219,767	1,281,547
Prishtinë 2	8	2,236,938	215,241	2,021,697
Prishtinë 3	77	1,851,492	300,098	1,551,394
Gjilan	14	570,711	204,194	366,517
Ferizaj	11	233,349	43,243	190,106
Prizren	36	1,136,649	187,552	949,097
Pejë	11	118,803	34,778	84,025
Gjakovë	10	263,591	98,967	164,624
Mitrovicë	24	508,505	101,102	407,403
Gjithsej	277	34,191,326	2,830,205	31,361,121

Burimi: atk-ks.org

5.8. Ankesat

Sistemi Tatimor i Kosovës në tërësinë e vet ballafaqohet me të gjitha dukuritë e sipër përmendura që manifestohet me deklarime tatimore, vlerësime, kontrole, gjoba, e të tjera. Këto dukuri përcillen edhe me pakënaqësitë e shumta të tatimpaguesve dhe bizneseve të tjera, të cilat shprehen përmes ankimeve në shkallë të ndryshme të drejtësisë. Numri i ankesave ndaj vendimeve të autoriteteve tatimore njëherazi tregon edhe nivelin e përsosmërisë së sistemit tatimor. Numri i këtyre ankesave nuk është i vogël dhe përcillet me procedim të tyre deri në instancat me të larta gjyqësore. Gjatë vitit 2013, në kuadër të ankesave të paraqitura, janë paraqitur gjithsej 420 ankesa, të bartura nga viti i kaluar 13 raste, prej të cilave 407 ankesa janë shqyrtuar. Nga ankesat e shqyrtuara 7 raste janë pozitive, 77 raste janë negative, 44 raste janë pjesërisht, 9 raste skadim afati, 13 raste janë

ri kontroll dhe 12 raste të tjera janë pezulluar.

Gjithashtu, në kuadër të totalit të ankesave të shqyrtuara janë përfshirë edhe 245 raste të gjobave, ku prej tyre 18 raste janë vendosur pozitive për tatimpaguesit, 162 janë vendosur negative për tatimpaguesit, 16 raste janë vendosur pjesërisht, 26 raste me skadim afati dhe 23 raste ankesa të tjera.

Tabela nr.26

Numri i ankesave dhe përgjigjeve prej departamentit të ankesave

Numri i ankesave	Te shqyrtuara	Ne shqyrtim	Vendimet e marra					Ankesat ne gjoba					
			Pozitive	Negative	Pjesërisht	Skadim afati	Ri kontroll	Pezulluar	Pozitive	Negative	Pjesërisht	Skadim afati	Te tjera
433	407	26	7	77	44	9	13	12	18	162	16	26	23
%	94x	6%	2%	19%	11%	2%	3%	3%	4%	40%	4%	6%	6%

Burimi : Raporti i ATK-së

5.9. Përmbledhja për kapitullin

Ky kapitull na jep informacione të mjaftueshme lidhur me trendët e treguesve makroekonomikë në Kosovë për periudhë dhjetëvjeçare, që nga produkti i brendshëm bruto, rritja ekonomike, ecuritë e buxhetit vendor dhe qëllimin themelor të studimit të të ardhurave tatimore.

Të dhënat e siguruara nga raporte origjinale të institucioneve relevante si agjensioni i statistikave të Kosovës, administrata tatimore e Kosovës, qeveria dhe institucionet ndërkombëtare BB dhe FMN na shërbejnë shumë mirë si të dhëna dytësore në hulumtimin tim.

Në këtë analizë për të trajtuar reformat tatimore të shteteve të zgjedhura ballkanike kemi përdorur të dhënat statistikore të FMN- së, Bankës Botërore, Mitra, Pradeep & Nicholas Stern, Tax Systems in Transition, World Bank Policy Research Working Paper 2947, January 2003,

Përmes këtyre të dhënave mësojmë qartë informacionin dhe performancën e punës së qeverisë dhe sistemit tatimor për një periudhë të gjatë dhe raportin e të ardhurave

tatimore me buxhetin e përgjithshëm vendor. Për më tepër, ky kapitull na jep informacionin mbi planet dhe realizimin e të ardhurave tatimore në tri vitet e fundit në Kosovë dhe krahasimin me rajonin. Informacionet e ofruara do shërbejnë për testimin e variables së varur dhe konkluzionet përfundimtare të punimit.

Kapitulli VI - Analiza dhe Përshkrimi i Rezultateve

Me synim për të njohur së afërmi organizimin, funksionimin dhe konsideratat publike ndaj sistemit dhe reformës së tatimeve në Kosovë, kam bërë hulumtime nga tereni dhe janë siguruar informata tjera nga publikime dhe raporte të institucioneve relevante në Kosovë e më gjerë.

Metoda e përdorur për mbledhjen e të dhënave në terren është mbështetur në pyetësorët dhe zhvillimin e intervistave.

Në përpjekje për testimin e variablave për vërtetimin e hipotezës kryesore se stimuli i tatimpaguesve dhe pjesëmarrja e tatimpaguesve në reformën tatimore do rrisë të ardhurën buxhetore të kategorisë së tatimeve, si metodë e re e përdorur për inkurajimin e tatimpaguesve në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve kemi përdorur dy lloje të dhënash:

- Të dhënat e ecurisë së të ardhurave tatimore nga institucionet përkatëse në dhjetëvjeçarin e fundit, por pa u kufizuar (të dhënat dytësore) dhe
- metoda e anketimit, me anë të pyetësorëve si të dhëna primare me kampion të shtresëzuar

Të dhënat dytësore janë marrë nga burime të rëndësishme të institucioneve për menaxhimin dhe mbledhjen e tatimeve, administratës tatimore të Kosovës – ATK, Doganë, Agjensionin e statistikave të Kosovës, BQK, FMN, BB e tjera. Këto burime pasqyrojnë gjendjen reale të permbushjes për tatimet nëpër vite dhe njëherësh tregojnë se niveli i realizimit të tatimeve sipas projeksioneve të administratës është optimal, mirëpo shikuar në analizë retrospektive shihet se trendi i të hyrave po bie prej viti në vit madje edhe vetë planifikimet e ulëta të qeverisë nuk janë realizuar. Dallimet shprehen sidomos duke analizuar trendet e të hyrave tatimore në krahasim me rritjen të produktit të brendshëm bruto, raportin e tatimeve vendore me arkëtimet në kufi, informalitetin, evazionin fiskal dhe mundësitë reale të mbledhjes së tatimeve.

Gjatë punimit është përdorur metoda e perzier e mbledhjes së të dhënave, sasiore dhe cilësore, gjegjësisht janë përdorur pyetësorët për mbledhjen e të dhënave. Kjo na ka ndihmuar që të bëjmë më lehtë krahasimin e variablave të ndryshme të përdorura për të testuar hipotezat e parashtruara. Metodë tjetër e përdorur në këtë punim është metoda përshkruese.

Gjatë përpunimit kemi ndërtuar dy baza të dhënave: Baza e parë është me pyetësorët nga Zyrtarët e Administratës tatimore, gjithsej 126 dhe tatimpagues 524, ndërsa baza e dytë ka të bëjë me pyetësorët nga qytetaret që përbëjnë 503 qytetarë (pyetësor që është përdorur për të vërtetuar se si reforma tatimore ndikon në ngritjen apo uljen e mirëqenies qytetare, ndikimin e tatimit në standardin e tyre dhe zhvillimin ekonomik).

Hipoteza e punimit qëndron në atë se Stimulimi i tatimpaguesve të rregullt dhe pjesëmarrja e tyre në reformën tatimore rrit përmbushjen tatimore.

Në lidhje me studimin janë ndërtuar variablat hulumtuese:

Variabla e varur: Të ardhurat tatimore në Kosovë

Variablat e pavarura:

- Reforma tatimore
- Pjesëmarrja e tatimpaguesve në reformën tatimore
- Rimbursimi ose shpërblimi i tatimpaguesve

Zgjedhja e kampionit;

Metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave përmban në vetë analizën e të dhënave primare të mbledhura përmes pyetësorëve. “Madhësia e kampionit prej së paku 30 e më së shumti 500 konsiderohet e përshtatshme për të kryer shumicën e hulumtimeve.” Sekaran (2003).

Sipas Field (2005) ekzistojnë shumë rregulla për sa i përket vëllimit të zgjedhjes së kampionit, por si rregull i përgjithshëm duhen 10-15 përgjigje për variabël. Duke tentuar përfshirjen e pjesëmarrëseve në këtë pyetësorë mostrat janë zgjedhur sipas një kampioni

te shtresezuar (biznese, zyrtarë tatimesh dhe qytetarë) ku është kërkuar që të jetë sa më gjithëpërfshirës në mënyrë që edhe rezultatet të jenë gjithëpërfshirëse.

Pas aplikimit të pyetësorëve, dhe përshkrimit të popullatës (tatimpaguesit) sipas pikëpamjes statistikore, të dhënat janë përpunuar në programin SPSS për të nxjerrë korrelacionet, devijimin standard dhe mesataren për secilin pyetësor. Më pas, të dhënat përshkruese të pyetjeve janë mbledhur dhe do shohim se si korrelojnë me njëra-tjetrën. Më tej këto të dhëna do të shërbejnë për të ndërtuar grafikët dhe tabela të nevojshme për vizualizimin e rezultateve, se si korrelojnë të dhënat e pyetjeve me njëra – tjetrën

Afati kohor për plotësimin e pyetësorit ka qenë i paraparë 25 minuta.

Intervista ishte e planifikuar të zgjaste rreth 35-40 minuta ku janë marrë në shënim të dhënat dhe bisedat.

Duke njohur natyrën vendore, anketat janë zhvilluar me mundësi anonimiteti, kjo për arsye edhe të supozimit të marrjes të sa më shumë përgjigjeve të sakta.

Popullimi është nxjerrë nga regjistri i bizneseve të regjistruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Mënyra e përpunimit dhe prezantimit të dhënave

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar përmes EXCEL (mënyra e parë) dhe (mënyra e dytë – katërt), tabelat e kryqëzuara, përmes “paketës statistikore për shkencë shoqërore” SPSS (Statistical Package for the Social Sciences).

Interpretimi ekonometrik:

Përgjithësisht literatura, ashtu siç u diskutua edhe më lartë, ka çuar në konkluzionin se reforma tatimore, ndryshe është domosdoshmëri.

Duke u bazuar në evidencat empirike, për të testuar hipotezat e ngritura lidhur me lidhjen ndërmjet përfitueshmërisë dhe variablave që ndikojnë në të, është përdorur modeli i mëposhtëm:

$$Y_{it} = \alpha_{it} + \beta X_{it} + u_{it}$$

ku i - nr përgjatë periudhës së studimit

Y_{it} = Performanca tatimore , gjatë periudhës t

X_{it} = variablat e pavarur të performaces dhe reformës tatimore, gjatë kohës që përfaqësojnë faktorët specifikë e ato jo specifikë të marrë në studim.

Ky është ekuacioni i funksionit të regresionit që përcakton lidhjen midis variablave të marrë në studim. Ku α është termi konstant i modelit dhe β_1 është koeficienti i funksionit të regresionit, vlera për ekuacionin e regresionit për të parashikuar variancat në variablin e varur. Kjo do të thotë që nëse koeficienti β është negativ atëherë variabli parashikues ose i pavarur ndikon negativisht tek variabli i varur: një rritje me një njësi në variablin e pavarur do të ulë variablin e varur me vlerën përkatëse të koeficientit.

Nëse $X_1, X_2, X_3, X_4, X_5, X_6, X_7, \dots = 0$ atëherë $Y = \alpha$. Ndërsa ε është termi i gabimit, i cili shpreh efektin e të gjithë variablave të tjerë, përveç variablat e pavarur e të varur të marrë në shqyrtim në funksionin e regresionit.

Argumenti qendror i këtij studimi është që varianca në performancë që vëzhgohet tek ndërmarrjet tatimpaguese në Kosovë mund të shpjegohet me qëndrimin që drejtuesit e tyre mbajnë jo vetëm ndaj tatimit në përgjithësi por edhe ndaj sistemit tatimor në veçanti. Modeli dhe kuadri analitik që shoqëron këtë argument analizon kater dinamika marrëdhëniesh:

- 1) marrëdhëniet mes ndërmarrjeve tatimpaguese dhe komponentët tatimorë
- 2) marrëdhëniet mes komponentëve tatimorë
- 3) marrëdhëniet mes ndërmarrjeve, tatimeve aplikative në Kosovë, dhe sistemit tatimor, si
- 4) marrëdhëniet mes mirëqenies qytetare dhe përmbushjes tatimore (e rrjedhuar nga reforma tatimore), dhe sistemin (e ri) tatimor.

Ky studim ka në fokusin e vet performancën e ndërmarrjeve tatimpaguese nga

pikëpamja e elementeve dhe kombinacioneve, strukturës, dhe ndikimit të sistemit tatimor.

Pra duke i parë këto fenomene –dukuri në kontekstin e Kosovës synon të hedhë dritë mbi dy gjëra: njëra ka të bëjë me dinamikat që shoqërojnë performancën e tyre nga pikëpamja e shkallës dhe tjetra mbi tendencat.

Modeli i regresionit të përdorur në këtë studim është si më poshtë:

$$Y_i = \beta_0 + \beta_1 \dot{X}_{1i} + \beta_2 \dot{X}_{2i} + \beta_3 \dot{X}_{3i} + \beta_4 \dot{X}_{4i} + \beta_5 \dot{X}_{5i} + \beta_6 \dot{X}_{6i} + \epsilon_i$$

KuY = Performanca tatimore

$\dot{X}_1$ = Reforma tatimore

$\dot{X}_2$ = Stimulimi i tatimpaguesve të rregullt përmes rimbursimit si efekt i rritjes së përmbushjes tatimore

$\dot{X}_3$ = Kënaqshmëria e tatimpaguesve përballë sistemit tatimor

$\dot{X}_4$ = Përparsia e tatimpaguesve të rregullt në kushtet e furnizimeve publike dhe kreditimet financiare për tatimpaguesit e rregullt

$\dot{X}_5$ = Pjesëmarrja e tatimpaguesve në reformën tatimore

$\dot{X}_6$ = Rimbursimi ose shpërblimi i tatimpaguesve

ϵ – Termi i gabimit

Duke shtruar pyetësorët për kategoritë e përcaktuara kemi arritur të marrim përgjigje gjithnjë duke u bazuar tek skema konceptuale e studimit, po ashtu edhe me modelin ekonometrik të studimit.

Duke marrë shkas interpretimin e hipotezave, analiza e tyre është ndërtuar sipas ndarjes dhe hipotezave përkatëse.

Të dhënat nga Pyetësorët

Objektivi kryesor i Anketës është të mundësojë krahasimin e të dhënave dhe opinionin në mes tatimpaguesve, qytetarëve dhe zyrtarëve tatimorë për performancën e sistemit tatimor dhe nevojën e reformimit të këtij sistemi .

Në mbledhjen e të dhënave ne kemi aplikuar metodat të cilat i kemi konsideruar


më efikase për kushtet dhe rrethanat në vendin tonë. Anketimi pjesërisht është kryer me metodën e intervistimit të drejtpërdrejt në rastet kur kjo ka qenë e mundur, apo thënë ndryshe, kur personat përgjegjës pranë ndërmarrjeve kanë pasur mundësi për një gjë të tillë. Në raste të caktuara, kur intervista ka qenë e pamundur të realizohet drejt përdrejt, pyetëtorët u janë lënë personave përgjegjës pranë ndërmarrjeve me qëllim të plotësimit të tyre dhe pas disa ditëve ata janë marrë nga anketuesit. Te një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve tatimorë janë zbatuar mundësitë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike (e-mail).

Burimet parësore të mbledhjes së të dhënave janë mbështetja bazë e këtij punimi doktoral për të vërtetuar apo jo hipotezën e këtij punimi.

Në rrugën e hulumtimit tonë për nivelin e taksave dhe tatimeve, nevojës së reformimit të sistemit tatimor në Republikën e Kosovës dhe krijimit të një modeli të reformës së mirëfilltë, na është dashur që të përdorim edhe metodën e anketës. Pas një analize të gjatë të pikave referuese, me reflektim të tatimeve, kemi arritur në përfundim se dy drejtime kryesore na dërgojnë tek informacionet më të mira lidhur me gjendjen e sistemit tatimor të Kosovës. Këto ishin vetë zyrtarët e administratës tatimore të Kosovës, si njohës praktikë të sistemit dhe tatimpaguesve, respektivisht bizneset, të cilat jo vetëm që preken nga efekti i këtij sistemi por janë aktorë aktivë dhe të përditshëm të këtij sistemi. Për këtë qëllim kemi përpiluar pyetëtorin me disa pyetje alternative për të marrë përgjigje reale nga të anketuarit. Prandaj ky pyetësor i është drejtuar dy burimeve të informacionit:

Bizneseve (Ndërmarrjeve të mëdha, të mesme dhe të vogla vendore,) dhe zyrtarëve të administratës tatimore në nivelin e mesëm, në një shtrirje kombëtare! Përgjithësisht, përmes pyetësorit janë anketuar: nga dimensionin i bizneseve gjithsej 524 biznese prej tyre 379 ndërmarrje të mesme, 126 ndërmarrje të vogla dhe 19 ndërmarrje të mëdha, të shpërndara nëpër qendrat kryesore urbane në Kosovë dhe 126 punonjës të Administratës


Tatimore, në shtrirje: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë.



Grafiku nr.13 - Dimensioni i bizneseve

Burimi: Punim i autorit

Në mënyrë që të kemi një strukturë gjithëpërfshirëse të anketuarve gjatë anketeve janë intervistuar edhe kategoritë sipas gjinisë dhe të punësuarit në nivele të ndryshme të punësimit nëpër regjione. Rezultatet e fituara dhe raportet e tyre i shprehim përmes ANOVA-se në këtë grafik



Grafiku nr.14 – ANOVA, testi ndërmjet gjinisë dhe punësimit

Tabela nr.27

Rezultatet e ANOVA-se per Moshën, Punësimin dhe regjioneve

		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Moshë në vite	Between Groups	26,983	1	26,983	136,874	,000
	Within Groups	98,766	501	,197		
	Total	125,750	502			
Punësimi	Between Groups	17,293	1	17,293	29,020	,000
	Within Groups	298,540	501	,596		
	Total	315,833	502			
Regjioni	Between Groups	,648	1	,648	,192	,662
	Within Groups	1691,793	501	3,377		
	Total	1692,441	502			

6.1. Analizime - Pjesa e Përgjithshme

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, që ekskluzivisht janë përzgjedhur, mund të arrihet në përfundim se në Kosovë ekzistojnë shtatë (7) lloje tatimesh në nivel qendror, një në nivel lokal dhe një Kontribut i sigurimit pensional, me ngarkesë tatimore 5% punëdhënësi dhe 5% punëmarrësi.

Ndërsa në çështjen e identifikimit të burimeve kryesore për të ardhura të tatueshme nga të anketuarit kemi nxjerrë gjendjen faktike:

- Tatimet në të ardhura personale, me ngarkesë 10% ,8%,dhe 4%,
- Tatimi në fitim për Korporata, me ngarkesë tatimore 10%
- Tatimi i mbajtur në burim, me ngarkesë tatimore 0 , 4% 8% dhe 10 %
- Tatimi mbi vlerën e shtuar me ngarkesë tatimore 16%

